VITI III të Nr. 1

BULETIN

I INSTITUTIT TË SHKENCAVET

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

BOTIM I INSTITUTIT TË SHKENCAVET

TIRANË 1949

REDAKSIA

Kryeredaktor: MARK NDOJA

ALEKSANDËR XHUVANI, SOTIR ANGJELI,
ALEKS BUDA, ZIHNI SAKO

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

INSTITUTI I SHKENCAVET

TIRANË Tel. 23-43

KOMITETI QËNDROR I P. P. SH. MERR VENDIME PËR TRAJTIMIN E NJERSVE TË KULTURËS, ARTEVE, SHKENCAVE DHE SPORTEVE

Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi dhe diskutoi gjëndjen dhe trajtimin e njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve,

K O N S T A T O N:

Se puna në fushën e kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve ka qënë dëmtuar shumë rëndë nga fryma dhe metodat trockiste të futura në Partinë t' onë nga agjentët e ndërgjegjëshëm të grupit trockist Tito, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, qoftë përsa i përket aktivitetit dhe prodhimit, qoftë përsa i përket trajtimit të njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve.

Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë çmon në shkallën e merituar aktivitetin dhe punën krijonjëse të njerëzve të kulturës, artistëve, shkencëtarëve dhe sportistëve që kanë vënë forcat dhe aftësitë e tyre në shërbim të popullit dhe të Republikës.

Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë, çmon nga ana tjetër se një trajtim më i mirë dhe më i drejtë, sipas konditave të vëndit t' onë, i punëtorëve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve do të bëjë që aktiviteti dhe puna krijonjëse e tyre të rriten dhe të shkojnë plotësisht në shërbim dhe dobi të masave të gjëra të vëndit t' onë, prandaj

V E N D O S:

Që t' i propozojë Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë:

1. — Të krijohen dhe të përmirësohen konditat e punës së njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve në qëndra ku punojnë ose zhvillojnë aktivitetin e tyre;

2. — Të bëhet një ndarje e drejtë e njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve, në shtet, institucione dhe organizata të ndryshme në mënyrë që kjo, t' u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të aktivitetit dhe prodhimit të tyre;

3. — Puna e njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve të çmohet dhe të shpërblehet drejt nga ana materiale dhe morale duke i ngritur në gradën dhe rangun që meritojnë;

4. — Të bëhet një trajtim i drejtë, sipas mundësive të sotme, në jetesën e njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve.

Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë i bën thirrje njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve që të vënë të gjitha zotësitë dhe fuqitë e tyre të punës në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

shërbim të zhvillimit sa më të gjërë të kulturës në vëndin t' onë mbi bazat e marksizmë-leninizmit dhe të japin kontributin e tyre sa më të math në ndërtimin e bazave të socializmit në vëndin t' onë.

KOMITETI QËNDROR I PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË

PUNËTORËT E SHKENCËS PRANË INSTITUTIT TË SHKENCAVET NGA NJË MBLEDHJE E POSAÇME I DREJTUAN KOMITETIT QENDROR TË P. P. SH. KËTË LETËR PËRSHËNDETJE:

KOMITETIT QENDROR TË PARTIS SË PUNËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Ne, puntorë të Shkencës në Institutin e Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë, në një mbledhje të posaçme që bëmë sot, lexuam vendimin e K. Q. të P. P. SH. për trajtimin e njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve, dhe e pritëm me enthuzjazëm dhe mirënjohje të thellë. Ky vendim do të mbetet një gur themeltar në historin e shkencës dhe të kulturës së Republikës sonë.

Ne e kemi ndjerë se kjo ka qenë gjithëmonë vija e drejtë e Partisë sonë, të cilën agjentët e ndërgjegjëshëm të grupit trockist Tito, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo u munduan ta shtrëmb ro in.

Vendimet e Pleniumit të XI-të dhe vçanëri ht të Kongresit të I-rë të Partis sonë kanë qënë për punën shkencore shvëtimtare, si për gjithë jetën e popullit tonë. Pas këtyre vendime historike puna e jonë shkencore, në hapat e saja të para, me gjith vësh ësitë materjale të hasura, mori nji hov të ri.

Ne e djemë vehten të lumtur që Komiteti Qëndror i P.P.SH i çmon me kaq zemër të gjërë rezultatet e para të punës sonë. Kjo tregon se sa drejtë dhe thellë i shikon çështjet e mbëdha të popullit Partija e jonë.

Në këtë ditë të gëzuar ne i premtojmë Komitetit Qendror të Partis sonë dhe Sekretarit të saj të Përgjithëshëm Shokut ENVER HOXHA, se duke u udhëhequr nga parimet e pa vdekëshme të shkencës Marksiste Leniniste dhe sipas shembullit të shkencës ngadhnjimtare Socjaliste Sovjetike do të vemë të gjitha forcat tona për zhvillimin dhe përparimin shkencës, për mirëqenjen dhe lumturinë e popullit, forcimin e Republikës sonë dhe Paqen në Botë.

Rroftë Komiteti Qendror i Partis së Punës së Shqipërisë dhe Sekretari i saj i Përgjithëshëm Shoku ENVER HOXHA.

Rroftë Republika e jonë Popullora pare-dashese.

Tiranë, me 20-4-1949

NËNSHKRUE:

Antarët dhe bashkëpunëtorët e Institutit të shkencave

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM FRASHËRI" KORÇË

GRAMOZI
FLORA, PYJET, KULLOTAT

Ing. ILIA MITRUSHI

HYRJE

Në vitin 1917, Instituti i Shkencave, për të studijuar në vend florën e Gramozit, mundësit' e përmirësimit të kullotave dhe çeshtjen e ripyllëzimit e të sistemimit të këtij vargu malesh, nisi një ekspeditë të përbërë prej N. Lakos dhe meje. Gjatë kësaj ekspedite u mblodhën lart nga njëmijë lloje bimë të cilat na japin një pasqyrë të mirë të florës së Kolonjës në përgjithësi dhe të asaj së Gramozit veçanërisht.

Mi florën e Gramozit nuk kemi dijeni të ketë shkruar kush me qëllim që të japë një farë ideje mi pyjet e dikurshme dhe mi bimët që gjinden në kullotat e këtij mali të rëndësishme nga pikëpamja floristike. Vetëm në vitin 1936 pat botanizuar disa dit një dijetar austriak, Dr. Fr. Lemberg, por gjer më sot nuk është dëgjuar të ketë shkruar gjë mi bimët e mbledhura, kështu që për përfundimet t' ona nuk na mbetet veçse të mbështetemi mi bimët e botanizuara dhe mi vrejtimet t' ona personale të bëra gjatë eskursionit floristik në fjalë.

Nga shkrimtarët e vjetër grekë, romakë dhe bizantinë s' kemi asnjë shënim mi florën e Gramozit, me gjithë se rrëzë këtij ka kaluar, që në kohët më të lashta, një rrugë e mirë karvani. Dhe vetë dijetari i mirënjohur Grisebach që zbuloi armenin (*Pinus Peuce*) në Perister, nuk na jep njoftime mi bimët që mbijnë në këtë varg malesh. Gjithashtu as Baldacci që ka botanizuar në Leskovik, as Bourcart-i e Markgraf-i, që kanë botanizuar në Korçë nuk e përmëndin Gramozin me gjithë se ky nga pikëpamja floristike ka një farë rëndësije për shkak të pozicjonit të tij ndërmjet dy florash të ndryshme, t' asaj së Europës qëndrore dhe të florës mesdhetare.

AMBIENTI FIZIK

Orografija dhe Hidrografija. Me fjalën Gramoz (1) kuptojmë këtu, përveç Gramozit vetë, edhe malet më në veri e më në jugë të këtij, që prej Qafës së Kazanit gjer në Malin Kamenik, d. m. th. prej 40° 10' gjer në 40° 30' gjërësi dhe prej 20° 8' gjer në 20° 20' gjatësi në lindje të Greenwich-it, me drejtim N. S.

---

(1) Fjala *Gramos* duhet të rrjedhë prej emrit *gram*, në kuptim të bimës *krisje* (*Cynodon dactylon*) ose në kuptim më të gjerë të fjalës *bar*. Gramos pra don të thotë vënd i veshur me bar. Për rrënjën *gram* krah. dhe fjalët *Gramsh*, *Gremsh*, ndërsa për prapashtesën *os* krah. fjalët *Linos*, emër pylli në Shingjergj të Tiranës, *Patos* në Mallakastër, *Bagos*, kat. në Kavajë, *Mnos* (Mner), emër kullote në kat. Galush të Peqinit. (Aukt.)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" KODËR

Gramozi është një nga malet më të lartër të vëndit t'onë: lartësija mesatare e tij sillet aty rreth 1700 metrave. Shumica e majave gjinden përmbi 2000 metra nga siperfaqja e detit. Të këtilla maja janë: Maja e Gobellit (2213 m.) Maj' e Malit Mileelt (2220 m.), Qaf' e Gramozit (2168 m.); Maja e Malit Skorovotit (2245 m.), Maj' e Vallmares (2415 m.), Liqen' i Guizdovës (2416 m.), Çuka e Peçit (2522 m.), Maja e Malit Mesit (2429 m.), Qaf' e Razdollit (1977 m.), Maj' e Malit Pelës (2179 m.), Qaf' e Badhrës (1772 m.), Maj' e Malit Leshnjes (1912 m.), Qaf' e Arëzës (1616 m.), Maja e Kamenikut (2044 m.).

Me dhjetra janë përrojt e lumejt që përçajnë Gramozin nga sipër poshtë e nga lindja në perëndim. Pothuaj se shumica e tyre nuk shterrin verës; përkundrazi një pjesë e mirë e këtyre lumejve, si ay i Kozelit, i Bezhanit, Skorovotit, Kreshovës dhe Starjes, kanë ujë të mjaftuarshëm për t' u përdorur për vaditje. Mjerisht rrjeti i vadave nuk është aspak i zhvilluar sa duhet me gjithë mundësitë që ekzistojnë.

Që të gjithë lumejt kanë rrymë të rrëmbyëshme dhe sjellin shumë zhavor në fushë; sidomos Lumi i Starjes dhe ay i Rrapës janë të përmëndur për inondatat dhe shkatrrimet që shkaktojnë.

Klima. Klima e Gramozit është pjesërisht e butë dhe pjesërisht e ftohtë (1) Ne nuk kemi shënime mi temperaturën, d. m. th. mi të ftohtit e të nxehtit që bën në këto anë.

Si në gjithë vëndet e tjera të atdheut t' onë, edhe në Gramos, shirat më të shumta bienë në vjeshtë (nëndor, dhjetor) dhe në prendverë ose dimër. Me gjithë se verës nuk bije veçse pak shi, thatësira nuk ndihet, me qenë se shumëherë në Gramoz bienë mjegulla, edhe në korrik e në gusht, pastaj natën bije mjaft vesë, gjë që bimët nuk i lë të thahen krejtësisht.

Dëbora që bije me shumicë dimrit vënde-vënde qëndron gjer në fund të korrikut.

Përsa I përket erërave, ato që rrahin më tepër Gramozin janë erërat që hyjnë nga jugë-perëndimi dhe perëndimi, ndërsa juga nuk e rreh fort për shkak të drejtimit veri-jugor të tij.

Përsa u-përket rreshjeve, në bazë të vrejtimeve katërvjeçare, stacjoni meteorologjik i Ersekës jep një mesatare vjetore prej 936 m/m. Kjo mesatare del nga tabella e poshtëshënuar:

Mesatare mujore e rreshjeve për vitet 1935, 1936, 1947, 1948:

Janar	118	Prill	66	Korrik	28	Tetor	128
Shkurt	90	Maj	67	Gusht	19	Nëndor	97
Mars	54	Qershor	63	Shtator	58	Dhjetor	148

Gjeologjija. Malet e Gramozit janë pjellë e terrenarit dhe përbëhen në radhë të parë prej serpentini, pastaj prej flyshi të përzjerë aty këtu me breçe këlqerore dhe më në fund prej shkumbësi kretacik (shih skicën gjeologjike).

Për shkak të kësaj përbërje gjeologjike llojet e tokave që rrjedhin prej këtyre formacjoneve janë toka shumë e pakë të varfëra, mesatarisht të thella, pra më fort për rritje pyjesh e për kullota se sa për bujqësi.

(1) Simbas Prof. K. Rubner, Gramozi klimatikisht bën pjesë në klimën malore të temperuar (Rubner, Pflanzengeographische Grundlagen des Waldbanes Ed. i III f. 145 (hartë me ngjyra).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

I. FLORA [1])

Ishte zëmërherë kur u nisëm prej Shtike për në Bezhan, një nga fshatrat më të bukur rrëzë Gramozit. Rruga e jonë që shkon ndërmjet arash, djerrash e vendesh të rrjepura është pak a shumë monotone me gjithë se aty-këtu në ledhet e veshura me trëndafile t' egër (*Rosa canina*) murriza (*Crataegus monogyna*), kullumbri (*Prunus spinosa*), thana (*Cornus mas*) e gorica (*Pyrus amygdaliformis*) mbijnë lule të bukura si *Geranium silvaticum*, *Campanula bononiensis*, *Vinca maior* dhe *Chrysanthemum corymbosum*. Më interesante ishte flora e luadheve dhe e moçaleve, ku nëpërmjet të barit mbinin me shumicë salepe të ndryshme (*Orchis maculata*, *O. palustre*, *Orchis latifolia*), zhabina (*Ranunculus montanus*, *R. nemorosus*), *Muscari racemosum* dhe më rrallë ndonjë anemone (*Anemone apennina*).

Që me të errur kur arritëm te Mulliri i Bezhanit sipër të cilit, nga uji e lagështija që formuar një vegjetacjon bimësh perenne jashtëzakonisht i vrullëshëm me *Heracleum alpinum* në krye, *Thalictrum aquilegifolium* dhe *Adiantum Capillus Veneris*.

Kur zunë të dëgjoheshin zilet e këmborët e gjësë së gjallë që zbriste nga mali, se po afrohej nata, atëherë zumë dhe ne të ngjitemi gjer në fshat për të shkuar natën atje.

Të nesërmen, passi falënderuam shokun Caci, kryetarin e këshillit, për pritjen e mirë që na bëri në shtëpin e tij, muarëm rrugën për në Mi ec, që gjindet gjithashtu rrëzë Gramozit, jo fort larg Bezhanit. Rruga kësaj here shkon përmës një pylli me ah që ndodhet në jugë të fshatit në një pllajë të varrur për nga veriu. Ndërsa në vëndet e shveshuna lulet në përgjithësi kanë zënë të pakësohen, pse i thonë fund i korrikut, në pyllin e freskët ato gjinden edhe në lulëzim e sipër, për gëzim të gjith' atyre që shkon në përmes kësaj ahishteje të përzjerë me panja (*Acer obtusatum*), mëllëza (*Ostrya carpinifolia*), shkozë të bardhë (*Carpinus betulus*) dhe vodhëviçe (*Sorbus aria*). Përveç këtyre drurëve, në Pyllin e Vakëfit, siç thirret kjo ahishte, gjinden dhe shumë shkorra pyjore të bukura si lajthija (*Corylus avellana*), shtogu i zi (*Sambucus nigra*), drizareja (*Lonicera xylosteum*), koldeti *Lonicera alpigena*) dhe (*Cytisus nigricans*) që, me lulet e tij të verdha, i jepte ambientit një bukuri të veçantë.

Shumë të bukura për t' u parë ishin lulet ngjyrë qielli të trëndafilit (*Lilium martagon*), të *Ajuga genevensis*, të *Campanula Scheuchzeri* të cilat, së bashku me lulet e trëndafilta të *Lathyrus venetus* dhe lulet e verdha të *Coronilla coronata*, të omanit (*Imula helenium*) dhe të ndërgishtes (*Digitalis grandiflora*), i jepnin pamje me të vërtetë madhështore këtij pylli plot me humus. Gjithashtu të bukura ishin orchidet që mbijnë në drizat e këtij pylli. Ajo më e përhapura dukej t'ishte *Orchis maculata*, ndërsa *Orchis bifolia* e *Orchis pyramidalis* takoheshin më rrallë, por që të trija një gjë kishin të përbashkët: lulet e tyre ngjyrë violle të ëmbël.

(1) Bimët e përmëndura në këtë kontribut, më përjashtim të drurëve e të shkurreve të rritëshme, janë përcaktuar nga N. Lako, kustos i Herbarit të Muzeumit të Shkencave të Natyrës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

Me të vërtet t' a ka ënda të shtrihesh gjatë verës nënë hien e aheve në të admiruar ngjyrat e bukura të luleve që mbijnë për toke dhe ligjërimet e zogjve që kërcejnë nga dega në degë sipër nesh, por koha e jonë është e matur dhe nuk na lejon të qëndrojmë veçse një copherë me gjithë bukurinë e veçantë që mund të ketë ky copë pyll.

Në të dalë të pyllit shtrihen sheshe të vegjël plot me tërfile malesh *(Trifolium alpestre, T. medium)*, jonxhe t'egra *Medicago minima*), ballbreshtëza, *(Onobrychis sativa), Senecio spathulaefolius, Tragopogon maior, Holcus mollis, Aegilops ovata* e shumë barëra të tjera foragjere t' ëndëshme për gjën' e gjallë të shumët që kullot në këto anë. Kështu pak a shumë vazhdon rruga gjer në Milec, në këtë fshat të vogël ne qëndruam për të vënë bimët e mbledhura në presat t' ona portative.

Përposh Milecit, për rreth një kishe të moçme, gjindet një farë pylli i vogël i përbërë prej shkozash, qarresh, bungëbutash dhe aty-këtu e prej ndonjë krekëze *(Acer monspessulanum)*. Flora e kësaj korije, me gjithë kohën e kaluar, ishte mjaft e pasur, sidomos në *Campanula bononiensis. Vinca maior. Trifolium medium, Geranium silvaticum, Hieracium pilosella, Bellis perennis, Lathyrus venetus, Digitalis laevigata, Orchis bifolia, Ornithogalum pyrenaica, Echium vulgare,*

Për anësh këtij pylli ndodhet një përrua me pak ujë, gjatë të cilit shihen të lulëzojnë ndër të tjera: *Ranunculus acris, Euphorbia amygdaloides, Lysimachia punctata* dhe *Orchis latifolia.*

Me kalimin e këtij pylli, flora bëhet më pak interesante, pse përbëhet prej bimësh të rëndomta të zonës së dushqeve që në këtë kohë është mjaft e varfër, me përjashtim të bimëve që mbijnë nër ledhe arash dhe livadhe Shumë interesante përkundrazi paraqitet flora në grykën e Lumit të Starjes, përmbi fshat, ku, për shkak të kundrejtimit të tokës për nga veriu dhe t'ambientit të freskët, gjindet në kulmin e zhvillimit të saj. Me gjithë vështirësitë që paraqet terreni (shtrati plot gurë, tinë dhe një të rrëmbyeshëm si edhe vendi shumë i rëpirët që të detyron të shkosh më tepër me duar se me këmbë), një botanizim i kësaj gryke vlen të bëhet për shkak të florës së saj të veçantë.

Qysh në të ngjitur të saj, d.m.th. pa arrirë mirë në pyll, flora paraqitet interesante dhe e vrullëshme. Bimët e para, që të bien në sy në këtë grykë plot lagështi, përveç vërrinjve *(Alnus glutinosa)*, shelgjeve *(Salix incana* e *S. purpurea)*, arrçit *(Rhammus fallax)* dhe lajthive *Corylus avellana* që mbijnë buzë lumit, ishin edhe këputja *(Equisetum palustre)*, fierëzat e holla *(Adiantum capillus Veneris)* dhe thundra *(Tussilago farfara)*, e cila përpiqet me ose pa sukses të lidhë me rrënjët e saj të forta dherin që ujrat kërkojnë të gryejnë. Po ashtu e freskët dhe e vrullëshme paraqitet flora që mbin ndërmjet drurëve të dritësuar të pyllit të cilin e bëjnë me ngjyrat e bukura, të këndëshme për t' a parë.

Të rritëshme ishin gjeraniet pyjore *(Geranium silvaticum)*, salepet *(Orchis maculata), Epipactis latifolia, Lathyrus silvester* dhe tërfilet *(Trifolium alpestre* dhe *T. medium)* që më ngjyrën e tyre të kuqe në violisë i ipnin brëndinës pyjore një bukuri të posaçme. Flora e vendeve të shveshuna përbëhej prej *Festuca ovina, Carex laevis* dhe *Sesleria sp.* të përzjera me *Dac-*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" K O R Ç Ë

tylis glomerata Poa alpina, Plantago lanceolata dhe shumë bimë të tjera me më pakë rëndësi. Pastaj dhe kush mund t' i mbajë mënd që të gjitha këto bimë, një pjesë e mirë e të cilave, për shkak të kërthyejve e gjetheve plot lëng, nuk mundën të konservohen siç duhej.

Krejt e ndryshme ishte bimësija e faqes së malit kundrejt këtij pylli që përbëhet më tepër prej bimësh kserofile, si *Sesleria coerulans, Carduus armatus, Daphne oleoides* dhe *Astragalus angustifolius* Kaleshka, siç e thërresin fshatarët e Kolonjës, ose më mirë uritheja, siç e quajnë banorë, e Mesaplikut *Astragalus Tragacantha* për trajtën e gjëmbat e saj që i për-i ngjasin iriqit, në Malet e Gramozit duket të jetë përhapur pas shkatërrimit të pyjeve me anë të zjarrit.

Uritheja [1]) në shumë vende të ngrohta rrëzë Gramozit formon shoqërinë bimësh të posaçme që në pjesën më të madhe të tyre janë, siç u përmënd edhe më sipër, bimë kserofile si *Daphne oleoides, Alyssum balcanicum Micromeria Juliana, Teucrium chamaedrys, T. polium, Salvia verticillata Festuca ovina, Dorycnium pentaphyllum, Linaria italica, Notholaena Marantae, Cuscuta alba, Aira capillaris, Aegilops ovata* (ne shumicë).

Qielli ishte i vrënjtur kur u nisëm prej Ersekë për në Arëzë. Koha ishte e freskët nga shirat e ditëve të shkuara, e toka mbante erë; edhe një pjesë e luleve kishte filluar të ripertrihej për një copherë gjer sa toka të thahej përsëri.

Fill pas nisjes s' onë patëm një gëzim të math me gjetjen e një rrëfeshku me lule të bardha që rrallë takon të gjindet. Gjatë rrugës s' onë gjer, në Stanet e Leshnjes, që ndodhen ndërmjet pishash të zeza *(Pinus nigra)* dhe dëllinjash *(Juniperus communis)* e ahesh të rrëgjuar nga të kulloturit, bimë të veçanta, përpos atyre të rëndomtave si *Campanula glomerata, C. bononiensis, Arum maculatum, Origanum vulgare, Galium cruciata, Pteridium aquilinum, Digitalis lutea, Trifolium medium, Melittis melissophyllum, Festuca gigantea, Dactylis glomerata, Poa nemoralis, Teucrium chamaedrys, Thymus angustifolius, Veronica chamaedrys, Carpinus betulus, Quercus sessiliflora, Q. cerrus* e *Q. conferta*, nuk takuam.

Pas një shlodhje të shkurtër vazhduam rrugën t'onë për në Arëzë përmes kullotash malore të ngrëna e gjysmë të ngrëna e përmes vgjeshtash të dritësuara ku zotëronte dëllinja kokërrezë *(Juniperus communis)* e xerxelja *(Daphne oleoides)*. Gjatë rrugës shihej ndonjë murris a goricë, trëndafil i egër a kulpër e bardhë *(Clematis vitalba)*. Me qenë se kishim edhe mjaft rrugë për të bërë dhe moti vinte për shi, botanizimin e këtyre viseve e lamë për të nesërmen.

Ishte vonë kur ne, si përshkuam një kortë prej qarresh të moçëm

1) Uritheja, kjo shkorre e thepisur, që kaleshët nuk e hanë gjat prendverës dhe verës për shkak të gjëmbave të shumët, mund t'u epet si ushqim dhive e dhënve gjatë dimrit në vend të gjetheve. Por, për këtë qëllim, kaleshkat duhen prerë pa u forcuar gjëmbat e tyre, d.m.th. aty nga fillimi i qershorit. Fshatarët e Kolonjës i presin dhe më vonë, por në këtë rast ata i rrahin për t' i zbutur (thyer majat e gjëmbave). Me qenë se ky farë gjëmbi gjindet me shumicë në gjithë Shqipërinë e Jugut vlen që të bëhen studime mi përdorimin e tij si ushqim për gjën' e gjallë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIHAIL ZAVALANI" DURRËS

arrimë në Arëzë, në këtë fshat të vogël plot bukuri, të rethuar an' e mbanë me pyll.

Të nesërmen herët, me gjithë mjegullën e kohën me shi, si kaluam dhe një herë përmes korijes, zumë të ngjitemi në një zonë të veshur me pishë të zezë shumë o pakë të rralluar, të baruar për këtë shkak me një lëndinë të hollë bimësh malore si *Geranium silvaticum, Myosotis alpestris, Hypericum barbatum, Hieracium silvaticum, Galium silvaticum, Aira flexuosa* me ndonjë *Lamium longiflorum* aty këtu përfund të ndonjë pishe të re.

Zona e pishës së zezë në këto vise fillon rreth 1900 metrave mi sipërfaqen e detit dhe vazhdon për afro 400-500 metro duke formuar në këtë mënyrë një rryp të ngushtë që shtrihet si në zonën e dushqeve ashtu edhe në atë të ahut. Edhe në këto anë pisha e zezë nuk ndahet prej serpentinit, siç e thekson Markgrafi [1]). Pylli vetë, që i nënështrohet kullotës gjat gjithë kohës së vegjetacjonit, është pothuaj se pa ripërtritje; vetëm aty këtu ka mundur ndonjë grumbull pishash të rea të bëjnë përpjetë. Është për t'ardhur keq të shohësh pyje të bukur të dëmtohen nga tri-katër tufa dhensh që sillen pa ndonjë kriter nëpër pyll për të ngrënë një grusht bar. Po sikur të mos mjaftonte kjo, ja ku pishat i dëmton dhe një dhembje e rrezikëshme *(Cnethocampa pityocampa)* që u bren gjethin për një kohë të gjatë prej korriku në nëndor dhe prej marsi në prill. Më në fund vjen dhe njeriu që u vë zjarrin ose i dëmton me spatën e tij për të nxjerrë «pishë»...

Bëmë më se një orë gjer sa duallëm afër staneve t' Arëzës që ndodhen aty rreth 1450 m. mi sip. e detit, në disa sheshe të veshura me bar dhe sidomos me *Festica ovina, Poa alpina, Phleum alpinum, Lotus corniculatus, Gentiana cruciata, Plantago carinata, Linum catharticum, Dianthus liburnicus.* Përpara nesh shtriheshin Malet e Postenanit e Melesini i Leskovikut, ndërsa malet e Nemërçkës ishin të mbështjella ndërmjet resh t' errëta, që më vonë i njohëm se me sa shi ishin ngarkuar.

Aty në një shesh të pyllëzuar me do pishë të moçme na u desh të prisnim rojen për të na përcjellë në Qafën e Arëzës ku bari ishte i pashkelur, d.m.th. i pangrënë, se në kullotat e përshkuara prej nesh e kishte ngrënë gjë e gjallë.

E ëndëshme është të ecësh përmes një pylli në një paradrede gushti. Sytë nginjen së admiruari lulet e bukura, hundën e pikjnë së ndjelli ajrin e ballsamosur të tyre dhe veshët s' lodhen së dëgjuari ligjërimet e ëmbëla të zogjve.

Aty rreth një ore zgjati rruga e joně gjer sa arrimë në një shesh të pashkelur, pakë më poshtë Qafës së Arëzës (1501 m.). Në këtë shesh të rethuar me ahe dhe të përshkuar prej një përroi, ne mundëm të admirojmë lulet e bukura dhe të bëjmë një ide mi florën dhe prodhimtarin' e një sipërfaqe kullosore të pangrënë në zonën e ahut.

Bimët që zotëronin në këtë luadh kullotë ishin *Festuca gigantea Anthoxanthum aristatum, Achillea alpina, Hieracium silvaticum, Lotus corniculatus, Trifolium medium, Plantago lanceolata.* Përveç këtyre bimëve ne

1) Märkgraf: Pflanzengeographie von Albanien f. 57.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

mblodhëm dhe një mori bimësh të tjera, si *Galium silvaticum, Dianthus silvaticus, Cardamine resedifolia, Myosotis alpestris, Koeleria brevifolia.* Buzë përrojt e në vendet me lagështi *binin Orchis maculata, O. sp., Ranunculus alpestre, Juncus bufonius* (?) si dhe dy-tri lloj myshqe të ndryshme.

Zona pyjore për rreth Qafës s'Arëzës përbëhet kryesisht prej ahu *(Fagus silvatica)* me pakë bredh Maqedhonije *(Abies Borisii-regis)* si dhe me ndonjë pamje fletëgjëre *(Acer obtusatum).* Nga shkorret ato më të rëndomtat ishin *Lonicera periclymenum, L. alpigena* dhe *Daphne laureola.* Sipërfaqja e pyllit ishte e mbuluar me një shtresë gjethesh të thata, ku aty këtu shihesh in të lulëzonin *Galium silvaticum, Dianthus silvaticus, Geranium silvaticum, Myosotis silvatica* ndërsa: *Knautia silvatica, Aspidium lobatum* dhe *Pteridium aquilinum* e bënin tokën të jeshilonte.

Me qenë se kishim për t'u nisur për në Gërmënj dhe me qenë se qielli po errësohej gjithmonë e më shumë, nga frika e shiut, aty nga koh' e drekës, u nisëm për në Ishat. Gjatë rrugës mundëm të mbledhim *Thalictrum majus, Linaria supina, L. vulgaris, Nigella damascena, Scandix pecten Veneris, Orobanche rubens, Echinospermum deflexum, Cardamine resedifolia, Scutellaria alpina, Ceterach officinarum* dhe *Polypodium vulgare.*

Me gjithë këtë, shiu na zuri, sa na u desh të këmbejmë teshat, por, për hir të bimëve të shumëta që mblodhëm dhe pyjeve të bukur që përshkuam, s'na bëri zëmra të mallkojmë Shën - Pjetrin për stomnat që na zbrazi m krye.

Mbasi hëngrëm drekë dhe na u tjerën robat u nisëm për në Gërmënj. Rruga prej Arëze për në këtë Ishat të strukur ndërmjet pyjesh të gjërë pishe të zezë *(Pinus nigra)* shkon përmes vgjeshtasn e kullotash te freskëta. Flora e këtyre shesheve është pothuaj se e njëjtë me sipërfaqet kullosore të Arëzës kështu që një botanizim i tyre nuk na u duk i nevojshëm.

Më parë se të hyjsh në Gërmenj nga ana e Arëzës ndodhet një kishë e re me disa qarre të moçëm në oborrin e saj. Si u shlodhëm pak nënë hijen e këtyre qarreve vazhduam rrugën t'onë për në Ishat dhe së këtejmi, mes disa luginash të bukura të veshura me pishë e bredh *(Abies Borisii-regis),* për në Stanet e Mollëzës, ku arrijnë në të ngrysur.

Të nesërmen herët, si u përshëndetëm me baba Tomën dhe të pesë djemt, e tij, lamë luginën e Mollëzës për t'u kthyer në Stanet e Arëzës përmes Shelegurës ku sa ishte ndërtuar një sharrë me motor për të shfrytëzuar pyjet me breth e pishë që veshin shpatet e saj.

Në pyjet për rreth sharrës ne vumë re të mbijnë përmes bredhave dhe pishave: *Acer obtusatum, Prunus avium, Fagus silvatica, Ostrya carpinifolia, Sorbus aria* dhe *Salix caprea.* Në perrenin buzë sharrës mbinin *Ranunculus acris* dhe *R. polyanthemos,* ndërsa në një shesh të pa ngrënë takuam *Poa alpina, Festuca violacea, Dactylis glomerata, Briza media, Trifolium medium, T. alpinum, Lotus corniculatus, Plantago lanceolata, P. carinata, Linaria vulgaris, Silene nusconi, Betonica hirsuta, Gymnadenia conopea, Campanula macrorrhiza, Geranium molle, G. macroorhizum, G. nodosum* dhe *Veronica beccabunga.*

Si hëngrëm drekë atje nën hijen e një pisme shekullore vazhduam rrugën t' onë për në Arëzë që e ndërpremë po ne kisha e Gërmënjit për të botani-

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S. H. K. D. R

zuar shpatin e thatë sipër saj ku ne mblodhëm këto bimë: *Thymus chamaedrys, Salvia verticillata, Scabiosa stellata, Potentilla intermedia, Sedum acre, Teucrium chamaedrys.*

Me të ngrënë kuajt tagjinë, e vazhduam rrugën t'onë duke kaluar përmes Arëzës për në kalivet e Vllehëve që ndodhen nja një orë më sipër fshatit.

Ishte vonë kur ne arrimë te Stanet e Arëzës, të lodhur por me shpirt të kënaqur për udhëtimin e bukur e bimët e mbledhura. Kaqë të kënaqur nuk qenë edhe miqtë t'anë të staneve kur na panë, me gjithë se nuk u ramë më qafë për darkë. Ne e kishim dëgjuar që Vllehtë s'të presin me qejf, por që të të lënë të presish jashtë në të ftohtë, këtë nuk na e priste mëndja gjer sa e pamë vetë me sytë t'ona.

Jo fort lark staneve të Arëzës ndodhet stani i vogël i Malit të Leshnjës i përbërë prej katër kasollesh të ngrehura në një shesh të vogël buzë një përroj e pranë një gurre. Vendi i kalliveve ndodhet në zonën e pishës së zezë, ndërsa mali sipër syresh është i veshur me një pyll të ulët ahu të dëndur.

Bimësija gjat rrugës për në kalivet e Gjonçit është mjaft interesante se ndodhet pikërisht në vijën ku mbaron pisha e fillon ahu, d.m.th. në një zonë me bimë të përzjera.

Shumë e përhapur në këto vënde janë: dëllinja e zezë (*Juniperus communis*) trëndafilat e egra (*Rosa canina, R. repens*) dhe murrizat, që gjë e gjallë s' është në gjendje t'i hajë krejt. Në vënde më të mprojtura, si p. sh. në grumbuj ahesh, gjinden dhe shkorre pa mjete mprojtëse si *Cotoneaster vulgaris, Evonymus verrucosa* e *Lonicera periclymenum.* Shumë e pasur ishte flora në bimë të pa drusuara ndër të cilat ato më të rëndomtat ishin *Hieracium silvaticum, Dianthus silvaticus, Galium silvaticum, Myosotis alpestris, Geranium silvaticum, Lathyrus tuberosus; Achillea alpina, Thalictrum major, Cardamine resedifolia.*

Ndërsa për rreth kalliveve ishin të rëndomta *Hyoscyamus niger, Malva silvestris* dhe *Urtica dioica,* (1) nënë drurët e regjuar të shpërndarë mbinin *Silene angustifolia, S. nutans, Stellaria graminea, Knautia silvatica, Campanula glomerata, Vinca minor, Fragaria elatior.*

Rruga prej Kalliveve të Gjonçit për në Badhër është mjaft pitoreske dhe me pamje të bukura. Një pjesë e mirë e saj shkon përmes korijesh, pyjesh dhe lëndinash të jeshilta. Përposh saj shtrihet fusha dhe shquhen mirë shtëpitë e fshatarëve, të rjeshtuara gjatë rrugës Ersekë-Leskovik.

Ndërsa vëndi përposh rrugës është shpyllëzuar mirë kullotë, pllaja sipër saj është e veshur me një pyll të dëndur ahu. Në ledhet e arave shiheshin të mbijnë *Pirus amygdaliformis, Rosa canina, R. pyrenaica, Crataegus oxyacantha, Rubus ulmifolius, Lathyrus laphaca, L. tuberosus, Geranium silvaticum, Nigella damascena, Anchusa italica, Coronilla varia, Echium vulgare.*

Tek ishim duke zbritur për në kalivet e Badhrës gjetëm për të parën herë

(1) Fshatarët, sidomos Vllehtë, hithzën e thajnë për t'a bërë lakruar edhe në dimër, kur ka mungesë vitaminash.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

bimën *Calthia palustris* së bashku me *Lysimachia punctata* dhe *Inula dysenterica*.

Kalivet e Badhrës gjinden në grykën e Përrojt të Badhrës tek një ujë i ftohtë dhe për fund të një pylli të ulët ahu.

Gryka e Përrojt të Badhrës është në pjesën më të madhe të saj e veshur me një ahishte të dëndur që zbret deri në 1300 metra lartësi mi sipërfaqen e detit. Aty këtu nëpër ahishte gjinden *Ostrya carpinifolia, Acer obtusatum, Sorbus aria, Salix caprea, S. aurita Rosa pyrenaica, Lonicera xylosteum, Cotoneaster tormentosa* e *Ribes aloinum* si dhe një mori bimësh të padrusuara si *Veratrum album, Gentiana lutea* (me shumicë), *Cirsium montanum, Fragaria elatior, Euphorbia amygdeloides, Hypericum barbatum, Pulmonaria sp. Astrantia maior, Hypericum barbatum, Solidago virga-aurea, Aspidium lobatum, Polystichum Brauni, Actaea spicata, Saxifraga aizoon, Thymus striatus.* Por sidomos e përhapur ishte badhëra (*Asphodelus albus*) që i ka dhënë emrin kësaj lugine. Gjatë përrojt plot me ujë lulëzonin *Caltha palustris, Inula helenium, Cirsium montanum* dhe *Hypericum barbatum.*

Lugina në veri të Badhrës quhet «Gryka e Rrapësit» dhe përroj që e përçan thirret «Rrapës». Kjo luginë ndodhet në degradim e sipër sidomos faqeja e kundrejtuar për nga jugu dhe lindja, se faqeja që varret për nga veriu është e veshur në pjesën e saj të ndërmjeme me një ahishte të përzjerë me breth (*Abies Borisii-regis*) dhe në pjesën e saj të sipërme me një pyll të rrallë rrobulli të kuq (*Pinus leucodermis*).

Në këtë pyll, që thirret si dh'ay i Bezhanit dhe i Starjes «Pylli i Vakëfit», na u dha rasti të botanizojmë paradrekën e datës 7 qusht. Ky pyll që sot nuk është më i math se 130-140 hektarë dikur ka qenë shumë më i përhapur, por të prerit pa rregull në njërën anë dhe të kulloturit e pafrenuar në tjetrën anë kanë kontribuar që kjo luginë e rrëpinët të shvishet dhe të degradohet.

Përveç ahut, bredhit e rrobullit, në pyllin e Rrapësit takohej pisha e zezë (*Pinus nigra*), panja fletëgjerë (*Acer obtusatum*), shelgu i egër (*Salix caprea*), vodhëviçja (*Sorbus aria*). *Sorbus chamaemospilus. Lonicera xylosteum. Daphne mezereum. Cotoneaster tomentosa* e *Rosa pyrenaica*. Por dhe në bimë jo drusorë pylli i Rrapësit është i pasur sidomos në bimë shkëmbinjsh. Ja bimët e tjera që ne mbluadhëm në pyllin e Rrapësit: *Aquilegia vulgaris* (e rrallë), *Helianthemum vulgare, Pirola media, Polystichum Brauni, Aspidium lobatum, A. lonchitis, Ceterach officinarum, Actaea spicata, Solidago virga-aurea, Achillea ligustica, Digitalis lutea Hypericum montanum, Potentilla fragariastrum, Sedum capillata*, etj.

Gryka e Rrapësit është e mbramja luginë nga jugu ose e para nga veriu që është shumë pakë e veshur me pyll. Zona më e afërme pyjore është ajo e Kozelit në luginën e Osumit dhe ajo e Nikolicës në luginën e Devollit.

Ndërmjet Rrapësit dhe Përrojt të Razdolit gjinden kullotat e shveshura e mjaft të thyera të Pelëzës dhe të Cucullit me lëndinë të dorës së tretë, të përbërë prej kripëth dhensh, *Poa alpina, Carex laevis, Sesleria sp., Lotus corniculatus* e *Trifolium alpinum.*

Aty në kohën e drekës, si kaluam përmes disa zallishtash të përzhitura,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

arrimë në fshatin e bukur Rehovë, që me pemët e kopshtet e mbleria të tij dukej si një oazë në mes të shkretëtirës.

Rehovarët janë njerës që kanë rrahur dhenë dhe, si të tillë, dinë të presin në shtëpitë e tyre të pastra, të shtruara e të zbukuruara mirë. Që të gjithë dinë të lexojnë e të shkruajnë; dhe vetë shumë nga rehovarët dinë të shkruajnë, kështu që s' kanë nevojë t' i luten mësuesit ose priftit t' u shkruajnë ndonjë letër burrit të tyre që kanë n' Amerikë ose për djemt që kanë n' ushtri.

Pakë përmbi Rehovë, në rrugën për në Razdoll, gjindet një manastir, rreth të cilit, ndër pemë të tjera, gjinden dhe disa gështenja të mbiella nja 25-30 vjet më parë prej një murgu plak që desh te shtonte numurin e pemëve të frytëshme, por pa përfundim të mirë se klima rrëzë Gramozit dolli më e ashpër nga ç' e mendonte ay. Murgu plak ka kohë që ka vdekur por vepra e tij e eksperimentimit do të mbesë edhe për shumë vjetë gjer sa të kenë jetë gështenjat që ay pat mbiellë.

Me gjithë se ishim të lodhur, natën nuk e shkuam në Rehovë por në kasollet e Vllehvet, që ndodhen 350-400 metra më sipër fshatit. Dukej se ishte dita që Vasillaq Zharkalliu na priti mirë, se kjo ndoth rrallë ndër vllehët.

Të nesërmen me të shkrepur të diellit në malin e Radomit e në Qelqezë të Frashërit, muarëm rrugën për në Razdoll-ku arrimë pas një udhëtimi të vështirë e të gjatë.

Razdolli është një farë sheshi afër kufirit në një lartësi 1900 metrash. Lëndina e kësaj fushe të vogël, që ka karakter alpin e që përbëhet në pjesën e saj më të madhe prej *Poa alpina*, *Festuca ovina* e *Carex laevis*, është si një dyshek i butë. Për fatin e mirë t' onë pjesa në jugë të saj, që fshihet prapa një bregu ku roja e kufirit kishte ngrehur kasollet e veta, ishte e pa ngrënë.

Ne na patën folur në Ersekë për lulet e rralla të Razdollit, por që këtu do të gjenim një nga vendet me lule më të bukura te atdheut t' onë, këtë nuk e mendonim; se ç' far na panë sytë në këtë lëndinë nuk do t'a harrojmë kurrë, aqë e bukur ishte. Thua se ke një kaleidoskop ose ke një shesh me ule shumë-ngjyreshe përpara! Me qindra janë llojet e bimëve që mbijnë në këtë gropë të mprojtur nga erërat e ftohta të lindjes e të veriut. Me qindra janë dhe kombinacjonet e ngjyrave të tyre, që nga e verdha e *Lotus alpinus* dhe e *Genista virgata* gjer tek ngjyra e kaltërt me të verdhë në mes të *Myosotis silvestris*. Këtu një grumbull prej asperulash (*Asperula longiflora*, *A. cynanchia*) me lulet si në të kuq, aty një tufë *Achillea atrata* me lule të bardha; më tej një shesh plot me *Campanula glomerata*, *Coronilla varia* dhe *Hieracium Hoppeanum*; pakë më larg një tufë me *Dianthus alpinus*; në një vënd tjatër lulëzojnë *Achillea moschata*, *Alchemilla splendens* dhe *Crepis aurea*, njera më e bukur se tjatra, dhe kështu vazhdimisht.

Lart nga 100 lloje bimësh mundem të mbledhim brënda 2-3 orëve në këtë vend jashtëzakonisht të pasur në lule, por mjerisht vetëm një pjesë e tyre mundi të konservohet.

Pjesa më e madhe e këtyre bimëve janë bimë alpine si *Achillea moschata*, *Alchemilla splendens*, *Armeria alpina*, *Carex approximata*, *Dianthus glacialis*,

BIBLIOTEKA UBËRE SHKENCORE MARIN BARLETI

Hieracium sabinum, Poa alpina, Phleum alpinum, Polygala alpestris e *Ranunculus alpester* ndër të tjera. Mund të mirret me mend se me sa mallëngjim u ndamë nga kjo parajsë lulesh jashtëzakonisht të bukura.

* * *

Një vend tjetër i pa ngrënë nga gjë e gjallë është Pylli i Vakëfit i katundit Starje që ndodhet aty gjysmë orë më sipër (1500-1650 m.) se fshati, në pllajën veriore të Lumit të Starjes. Në këtë pyll të përbërë prej ahu konstatuam një tok drurësh e shkorresh si *Acer obtusatum, Salix caprea, Rhamnus alpina, Cotoneaster vulgaris, Lonicera xylosteum, L. alpigena, Rubus idaeus, Ribes alpina, Rosa canina, Daphne oleoides* e *Sorbus sp. varii.*

Në çeltirat e shumta të këtij pylli të dritësuar takoheshin dëndur *Vicia sativa, Gentiana cruciata, Polygonum alpestris, Linum nodiflorum, Chaerophyllum temulum, Bupleurum gramineum, Carex laevis Festuca ovina* e *Pteris aquilina.* Për rreth Vakëfit, që ndodhet në një shesh të vogël buzë një gremine, mbinin me shumicë hithra (*Urtica dioica*) lëpjetë t' egra (*Rumex sp.*) dhe rrodheza (*Arctium lappa*) si dhe një mori gjëmbash gomari *Carduus sp.*).

Mjerisht ky pyll është duke u dëmtuar si nga ujrat që janë duke e gryer (forma erozioni të tmerrshme), ashtu dhe nga gjë e gjallë që e kullot kohë e pa kohë dhe nga njerëzit qe e presin pa kriter.

Interesante në pikëpamje floristike është edhe kullota alpine Varibob ku ne botanizuam më 11 gusht. Lëndina e kësaj është më tepër e degraduar se ajo e Razdollit. Shumë pjesë të saja nuk kanë veçse pjesërisht dëndësinë që duhej të kishin. Lëndina, përsa u përket gramoreve dhe leguminozeve, përbëhet po prej atyre bimëve që gjinden edhe në lëndinen e Razdollit (*Carex laevis, Poa alpina, Festuca ovina. Lotus corniculatus. Trifolium alpinum*), ndërsa përsa u përket bimëve të tjera është shumë më e varfër. Të rëndomta në këtë kullotë ishin *Alchemilla splendens, Veronica alpina, Viola lutea, Scorzonera aristata* dhe *Crepis aurea.* Gjithashtu e rëndomtë ishte një farë *Geranium* me kurorë të madhe ngjyrë vere të kuqe, që fillonte të mbinte prej 1600 m. e sipër. Interesante ishte dhe një *Verbascum* me lule të bardha, që gjetëm në këtë kullotë.

Në këtë kullotë gjindet maja më e lartër e gjithë Gramozit «Guka e Peçit» (2522 m), përposh së cilës, në disa lugje, kishte edhe dëborë. Dhe me qenë se pjesa më e lartër vjen e rrëpinët, lëndina vënde-vënde ka filluar të degradohet. Të vetëmet shkorre të ritëshme që mbijnë janë dëllinjat e zeza (*Juniperus communis*).

Po të njëjtën përshtypje patëm dhe nga kullota e rrëpinët e Vallmares, që gjindet ndërmjet kullotave Voribob në jugë dhe kullotës së Skorovotit në veri. Edhe kjo është në degradim, bile në një degradim më të math, përarësye se vendi paraqitet më i thyer. Kjo kullotë është kreitësisht e shveshur, me përjashtim të ndonjë lugu të pyllëzuar me pakë ah.

Gjithashtu mjaft e degraduar është dhe kullota e Skorovotit e cila nga pikëpamja e florës s' ka ndonjë ndryshim nga Vallmarja dhe Varibobi.

Lëndina e kullotave të Milecit e të Butkës është disi më e trashë se sa ajo e kullotave në Valmares, Varibobit e Razdollit, jo për shkak të llojeve të bimëve por për tokën e tyre më të mirë. Edhe këto kullota janë pothuaj

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

se krejt të zhveshura, me përjashtim të ndonjë ahishte të vogël që ka mundur t'i shpëtojë spatës së pameshirëshme të fshatarëve e të blegtorëve nomadë.

GRAMOZI NGA PIKËPAMJA FITOKLIMATIKE DHE FITOGJEDERAFIKE

Nga bimët që panë të mbijnë në vendet e ndryshme të Gramozit jemi në gjendje të nxjerim disa përfundime në lidhje me zonat fitoklimatike si dhe me vendin që zë ky varg mal'esh nga pikëpamja e vegjetacjonit.

Të mbështetur mi bimët e mbledhura si dhe mi vezhgimet t'ona personale, ne nxierrim këto përfundime:

1) Se në Gramos përfaqësohen tri zona fitoklimatike:
   a) zona e dushqeve,
   b) zona e ahut,
   c) zona alpine;

2) Se Gramozi ngë pikëpamja e vegjetacjonit ka lidhje më të ngushta me florën e Europës qendrore se sa me atë të vëndeve mesdhetare.

ZONAT FITOKLIMATIKE NË GRAMOS

Në Gramoz, si dhe në gjithë malet e lartër në veri të tij, dallohen tri zona fitoklimatike: zona e dushqeve, zona e ahut dhe zona alpine.

Zona e dushqeve. Për shkak të trajtës orografike të Gramozit, që zë të ngrihet njiheresh përmbi rrafshnaltën e Kolonjës aty nga kurba e nivelit 1100-1200 m. nga sipërfaqja e detit, zona e dushqeve është mjaft e kufizuar në këtë vark malesh. Bimët karakteristike të kësaj zone në Gramos janë: *Quercus sessiliflora, Q. lanuginosa, Q. Cerris* dhe *Q. conferta* që formojnë korije të vogla të përzjera me shkoza të bardha (*Carpinus betulus*) me mëlleza (*Ostrya carpinifolia*) e në disa fshatra edhe me pishë të zezë (pinus nigra). Fort më rrallë takohen panja (*Acer obtusatum*) e vodhëviçeja (*Sorbus aria*), *Cytisus nigricans, Lonicera xylosucum*. Këto korije qeverisen si pyll i ulët.

Nga bimët e padrusuara takohen në këtë zonë: *Achillea tomentosa, Ajuga genevensis, Astragalus incanus, A. angustifolius, Briza media, Campanula bononiensis, Coronilla varia, Crepis Froelichiana, Digitalis lutea, Doronicum orientale, Epilobium Lamyi, Geranium nodosum, Hyoscyamus niger, Inula helenium, Lathyrus tuberosus, Salvia verticillata, Sanicula europaea, Scrizaea filipendula, Vicia Gerardi.*

Zona e ahut. Është zona më e përhapur dhe më me rëndësi e të gjithë Gramozit, se shtrihet prej 1250 gjer në 2000 metra lartësi. Në Arëzë e në Gërmënj fillon më sipër mbasi vendi këtu gjer në 1400-1500 metra, është i veshur me pishë. Në ka qënë kjo zonë dikur e veshur me rrobuj, këtë nuk mund t'a dimë, se pyjet ndërmjet zonës së ahut dhe zonës alpine, me përjashtim të Luginës së Rrapës e të Kamenikut që janë të veshur me rrobull (*Pinus leucodermis*), nuk ekzistojnë. Nga llojet drusore që takohen sot në Gramos në zonën e ahut, përveç ahut që formon pyje, gjinden të përzjera me 'të edhe bredhi (*Abies Borisii-regis*), pish'e zezë (*Pinus nigra*), rrobulli

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODRA "MARIN BARLETI"

(*Pinus leucodemnis*) si dhe, më rrallë, *Acer pseudoplatanus, Salix caprea, Sorbus aria, Daphne oleoides.*

Nga bimët jo drusore-ato më të rëndomtat janë: *Alyssum montanum, Anthemis montana Asphodelus albus, Campanula glomerata, Epilobium montanum, Geranium macrorrhizum, Gymnadenia conopea. Heracleum alpinum, Lilium martagon, Lysimachia punctata, Myosotis silvatica, Phleum alpinum, Potentilla pensylvanica, Rosa pyrenaica, Saxifraga geum, Sedum alsinaefolium, Silene quadrifida, Trifolium alpestre, Verbascum longifolium e Veronica beccabunga.*

Zona alpine. Zona alpine në Gramos është fort e ngushtë për shkak të kufizimit të lartësive përmbi 2200 metra. Nga sa mundëm të konstatojmë, lëndina që formohet në këto zona përbëhet prej *Poa alpina, Festuca ovina · Carex leavis, C. approximata, Phleum alpinum, Anthoxanthum aristatum, Alchemilla splendens, Achillea atrata, Arenaria grandiflora, Gentiana cruciata, Lotus alpinus.*

Në zonën alpine të Gramozit mbijnë një mori bimësh alpinë si *Achillea moschata, Alyssum alpestre, A. montanum, Armeria alpina, Bupleurum gramineum Campanula linifolia, C. Sheuchzeri, Crepis aurea, C. Froelichiana, Dianthus alpinus D. glacialis, Hieracium Hoppeanum, H sabinum, Koeleria splendens, Leontodon pyrenaicus, Pimpinella alpestris, Polygala alpestris, Polystichum lonchitis, Potentilla intermedia, Ranunculus alpester, Scorzonera aristata, Silene saxifraga, S. vallesia e Veronisa alpina.*

GRAMOZI NGA PIKËPAMJA FITOGJEOGRAFIKE

Që Gramozi nga pikëpamja e gjeografisë së bimëve ka lidhje më tepër me florën e Europës qëndrore, na e tregon vetë një pjesë e mirë e bimëve si *Fagus silvatica. Achillea atrata, A moschata, Alyssum alpestre, Armeria alpina, Asperula longiflora, Campanula Sheuchzeri, Carex approximata, Crepis aurea, Dianthus alpinus, D. glacialis, Heracleum alpinum, Hieracium sabinum, Hypericum Desetangsii, Lotus alpinus, Ornithogalum tenuifolium, Orobanche lutea, Pimpinela alpestris, Potentilla intermedia, Ranunculus alpester, Rosa pyrenaica, Scorzonera aristata, Sedum elegans e Veratrum album,* të cilat takohen gjithashtu me malet e Bavarisë Austrisë, Italisë e të Bosnjes-Hercegovinës.

Pretendimi i Fr. Markraf-it 1) se ahu në jugë të Gurit Topit nuk formon veçse pyje të vegjël, munt të jetë me vend për lokalitetet më në jugë se Gramozi, por jo për Gramozin vetë, se ky, si pas shenjave të ahut që ekzistojnë (Mal' i Butkës, Pylli i Vakëfit, i Bezhanit, i Skorovetit, i Kreshovës, i Starjes, Razdolli [Rehovë], pyll i Rrapes [Taç i sipërm], (Badhra) ka qënë i veshur, me gjithë ekspozitën e tij perëndimore, me ahishta që kapnin një sipërfaqe prej të pakën 12000 hektarësh. Në veri të Gramozit, zona e ahut lidhet me atë të Nikolicës, Dardhës, Badvicës, Hosishtit.

Gjithashtu të veshur me ah janë dhe kanë qenë malet prej Gurit të Prerë (Opar) gjer në Malin e zi të Lubonjës, sic e dëshmojnë ahishtet e Zerecit, Dusharit, Miosarit, Mazrekës, Çermenikës, Sherr' e Panaritit, mbeturinat e ahishteve të Vithkuqit dhe Pyll i Piqerit, sipërfaqe kjo lart nga 15.000 hek-

1) Shif Fr. Markgraf: Pflanzengeographie von Albanien f. 46.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATI" SHKODËR

tarë. Që sot në këto vende s' takohen pyje të gjërë ahu, kjo nuk do të thotë se klima për zhvillimin e ahut mungon; përkundrazi, dikur kanë ekzistuar ahishte, por dora e njeriut i ka shkatërruar.

Flora e ahishteve në jugë të Gurit Topit nuk është e ndryshme nga bimërija e pyjeve me ah të Mokrës. Si mbas vrejtimeve të mija në Sherren e Panaritit e në Piqer të Selenicë — Stratobërdës gjinden po ato bimë që takohen dhe në ahishtat e Mokrës e të Shpatit, si p. sh. *Arum maculatum, Melittis melissophyllum, Polygonatum officinale, Paris quadrifolia, Atropa Belladonna, Orchis maculata, Lathraea squamaria, Geranium silvaticum, Digitalis lutea, Lilium martagon, Aquilegia vulgaris, Equisetum maximum, Scolopendrium vulgare,* pa marë parasysh shkorret e përbashkëta si *Corylus avellana, Diphne mezereum, Cornus mas, Sambucus racemosa, Lonicera xylosteum, L. periclymenum, Evonymus, europaeus,* etj.

Markgraf-i në Hartën e Vegjetacjonit të Shqipërisë, Gramozin e shënon si të veshur me korifere mesdhetare (bredh), kurse në të vërtetë ay është pothuaj se krejtësisht i shveshur, dhe pyjet që ekzistojnë përbëhen në pjesën e tyre më të madhe prej ahu, pastaj prej pishe dhe më në fund vjen bredhi i Maqedhonisë *(Abies Borisii-regis)* (krh. hartën t' onë të vegjetacjonit të Gramozit).

Po të peshohen mirë të gjithë faktorët, dhe në radhë të parë ata edafikë (që nga toka e gjer te kundrejtimi), këta nuk janë në favor të zhvillimit të ahishtave (toka serpentini e flyshi, ekspozitë perëndimore); me gjithë këtë, formimi i një zone të gjërë ahu në Gramos (1250-2100 m.) dëshmon se ky mal nga pikëpamja e vegjetacjonit shkon me florën e Europës qendrore.

Një konstatim i tillë ka një rëndësi të madhe, sidomos nga pikëpamja e përmirësimit të kullotave dhe e ripyllëzimit të vëndeve të zhveshuna të Gramozit, si edhe për vetë bujqësinë që duhet zhvilluar në rrafshnaltën e Kolonjës.

II. PYJET

Thuhet se gjer në shekullin XVIII Gramozi ishte mjaft i veshur me ahishta të gjera të përziera me pak bredh, pishë të zezë e trobull. Së bashku me këto lloje kryesore mbinin dhe lloje drurësh sekondarë si panja, vodhe t' egra, mëlleza, shelgje t' egër e plep i egër.

Pjesa më e madhe e këtyre pyjeve kishte formë të naltë dhe vetëm pyjet për rreth fshatrave kishin trajtë të ulët. Mbrojtja e tokës pra, ishte më se e mjaftuarshme. Vetëm në pyjet me pishë e me trobull, që kishin mjaft të rralluara dhe që kulloseshin pa ndërprerje, kishte filluar një farë degradimi.

Më vonë me shtimin e nevojave të popullsisë, e cila sa vinte e bëhej gjithmonë më e madhe, dhe sidomos me shumëzimin e gjësë së gjallë, sipërfaqeja e pyjeve e këtij vargu të gjërë malesh filloi të pakësohej duke u këthyer në kullotë.

Kjo gjendje u keqësua sidomos në kohën e Ali Pashës dhe mbas vdekjes së këtij, kur shumica e pyjeve, nga pronësija kolektive kaluan në duart e agallarëve për të cilët pyjet përfaqësonin vetëm një mjet shfrytëzimi gjer në pikën e fundit. Kuptohet vetiu se kur pyjet s' kishin ç't'u jipnin më,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

tarë. Që sot në këto vende s' takohen pyje të gjërë ahu, kjo nuk do të thotë se klima për zhvillimin e ahut mungon; përkundrazi, dikur kanë ekzistuar ahishte, por dora e njeriut i ka shkatërruar.

Flora e ahishteve në jugë të Gurit Topit nuk është e ndryshme nga bimërija e pyjeve me ah të Mokrës. Si mbas vrejtimeve të mija në Sherren e Panaritit e në Piqer të Selenicë — Stratobërdës gjinden po ato bimë që takohen dhe në ahishtat e Mokrës e të Shpatit, si p. sh. *Arum maculatum, Melittis melissophyllum, Polygonatum officinale, Paris quadrifolia, Atropa Belladonna, Orchis maculata, Lathraea squamaria, Geranium silvaticum, Digitalis lutea, Lilium martagon, Aquilegia vulgaris, Equisetum maximum, Scolopendrium vulgare,* pa marë parasysh shkorret e përbashkëta si *Corylus avellana, Diphne mezereum, Cornus mas, Sambucus racemosa, Lonicera xylosteum, L. periclymenum, Evonymus, europaeus,* etj.

Markgraf-i në Hartën e Vegjetacjonit të Shqipërisë, Gramozin e shënon si të veshur me korifere mesdhetare (bredh), kurse në të vërtetë ay është pothuaj se krejtësisht i shveshur, dhe pyjet që ekzistojnë përbëhen në pjesën e tyre më të madhe prej ahu, pastaj prej pishe dhe më në fund vjen bredhi i Maqedhonisë *(Abies Borisii-regis)* (krh. hartën t' onë të vegjetacjonit të Gramozit).

Po të peshohen mirë të gjithë faktorët, dhe në radhë të parë ata edafikë (që nga toka e gjer te kundrejtimi), këta nuk janë në favor të zhvillimit të ahishtave (toka serpentini e flyshi, ekspozitë perëndimore); me gjithë këtë, formimi i një zone të gjërë ahu në Gramos (1250-2100 m.) dëshmon se ky mal nga pikëpamja e vegjetacjonit shkon me florën e Europës qendrore.

Një konstatim i tillë ka një rëndësi të madhe, sidomos nga pikëpamja e përmirësimit të kullotave dhe e ripyllëzimit të vëndeve të zhveshuna të Gramozit, si edhe për vetë bujqësinë që duhet zhvilluar në rrafshnaltën e Kolonjës.

II. PYJET

Thuhet se gjer në shekullin XVIII Gramozi ishte mjaft i veshur me ahishta të gjera të përziera me pak bredh, pishë të zezë e rrobull. Së bashku me këto lloje kryesore mbinin dhe lloje drurësh sekondarë si panja, vodhe t' egra, mëlleza, shelgje t' egër e plep i egër.

Pjesa më e madhe e këtyre pyjeve kishte formë të natë dhe vetëm pyjet për rreth fshatrave kishin trajtë të ulët. Mbrojtja e tokës pra, ishte më se e mjaftuarshme. Vetëm në pyjet me pishë e me rrobull, që kishin mjaft të rralluara dhe që kulloseshin pa ndërprerje, kishte filluar më farë degradimi.

Më vonë me shtimin e nevojave të popullsisë, e cila sa vinte e bëhej gjithmonë më e madhe, dhe sidomos me shumëzimin e gjësë së gjallë, siperfaqeja e pyjeve e këtij vargu të gjerë mbeti filloi të pakësohej duke u këthyer në kullotë.

Kjo gjendje u keqësua sidomos në kohën e Ali Pashës dhe mbas vdekjes së këtij, kur shumica e pyjeve, nga pronësija kolektive kaluan në duart e agallarëve për të cilët pyjet përfaqësonin vetëm një mjet shfrytëzimi gjer në pikën e fundit. Kuptohet vetiu se kur pyjet s' kishin ç't'u jipnin më,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

fizuar vetëm në dy-tri katunde, ndërsa fshatrat e tjerë nuk kanë asnjë pyll të rëndësishmë të vetin, në kundërshtim me krahinën e Leskovikut (Arëzë, Gërmenj, Shalës, Radat) e më atë të Devollit t'epërme (Nikolicë, Dardhë).

Pasqyrë e sipërfaqeve pyjore të fshatrave rrëzë Gramozit

Emri i katundit	Pisha ha	Ah ha	Qarr ha	Shkozë ha	Të ndryshme ha	Sipërfaqja e përgjithshme ha
Kozel	230	73	42	—	10	361
Butkë	—	8	—	—	—	8
Shtikë	74	40	55	3	23	195
Bezhan . . .	—	6	4	4	—	14
Milec	—	12	—	3	—	15
Skorovol . . .	—	7	12	3	3	25
Kreshovë . .	—	4	—	—	2	6
Starje	—	64	—	—	16	80
Rëhovë . . .	—	40	—	—	—	40
Taç i sipërm .	—	—	12	—	—	12
Gjonç	12	310	12	6	4	344
Shuma . . .	316	564	143	19	58	1100
Përqindja . .	28,6	51.2	13	1,8	5,4	100

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

RIMËKËMBJA PYJORE

Konfiguracioni orografik e konstitucioni gjeologjik në njërën anë dhe kushtet klimato-ekologjike të këtij vargu malesh n'anën tjetër, përkufizojnë më së miri rrugën që duhet ndjekur për mëkëmbjen e Gramozit.

Kulturat silvopastorale, për shkak të natyrës së tokës e të topografisë së vëndit, nuk mund të zëvëndësohen me kultura bujqësore.

Kushtet tokësore dhe klimatike janë shumë të përshtatëshme si për rritjen e pyjeve në zonën e gjërë të ahut ashtu edhe për barërat foragjere sipër saj, në zonën e kullotave.

Po dhe nga pikëpamja e ekonomisë silvopastorale, veshja e Gramozit me pyll si dhe përmirësimi i florës kullosore i përgjigjet më tepër nevojave të popullsisë që jetojnë rrëzë këtyre maleve të larta.

Rimëkëmbja e pyjeve si dhe e pasurisë silvopastorale imponohet nga shumë faktorë, dhe në radhë të parë për arësye :

Ekonomike, sepse duke i ripyllëzuar gjithë sipërfaqet e thyera, që s'paraqesin kushte të përshtatëshëm për një lëndinë kullosore të mirë, si dhe duke u veshur me barëra foragjerë të mira gjithë vëndet ku drurët pyjorë s' kanë mundësi të gjallërojnë, do të nepet një kontribut i rëndësishëm për vleftësimin e këtyre tokave të shveshura ;

Hidrogjeologjike, sepse pylli me anë të drurëve të tij kontribuon jo vetëm në mosgryerjen e tokës nga ujrat e shirat, po është njëkohësisht një faktor i rëndësishëm për regjimin e mirë të ujrave, të përrojve e të rrëkeve, duke pakësuar llomrat e ngadalësuar vrullin e tyre ;

Shqërore, sepse duke përmirësuar kullotat e pyjet, duke veshur përsëri me pyll shpatet e shveshur si dhe duke rregulluar rriedhjen e ujrave, do të shtohen t'ardhurat e popullsive lokale, gjë që do të shkaktojë përmirësimin e tokave bujqësore për të mirën jo vetëm të tyre por të të gjithë ekonomisë popullore lokale.

Për këto arësye duhet që sa më parë të miret në studim si çështja e ripyllëzimit të pllajave të shveshura ashtu dhe sistemimi i luginave me rrëke e përroj të rrëmbyeshëm. Krahas me këtë studim lypset të mendohet dhe për përmirësimin e kullotavë të lëna mbas dore duke përpiluar projektet e nevojëshme.

Ndër veprat e para që duhen marrë për rimëkëmbjen e pyjeve janë :

1) mprojtja e pyjeve të sotshëm nga çfardo rrezik (prerje, kullotje, zjarr, insekte) ;

2) përmirësimi i pyjeve të degraduar me anë prerjesh ripërtritëse ;

3) normalizimi i ripërtritjes dhe i rritjes së pyjeve të lëna mbas dore duke ushtruar prerje të përshtatëshme ;

4) lënja e një sasije drurësh amësorë (manarë) në pyjet e rrët për të bërë që këta me kohë të kalojnë në një qeverim të naltë ;

5) zhvillimi i një propagande të gjërë në lidhje me mprojtjen, mirëmbajtjen dhe mirëshfrytëzimin e pyjeve.

Sidomos një rol të posaçëm në rimëkëmbjen e pyjeve lot mprojtja e tyre nga gjë e gjallë dhe nga prerjet abuzive. Pa ndalur prerjet e shrregullta dhe pa disiplinuar kullotjen nuk mund të mendohet për një rindërtim të tyre.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

RIPYLLËZIMET

Ripyllëzimi i Gramozit është, nga problemet e ndryshme silvopastorale, problemi më me rëndësi. Me mijra hektarë janë sipërfaqet që kanë mundësi dhe që duhet të ripyllëzohen për të hedhur themelet e rimëkëmbjes së Kolonjës nga pikëpamja bujqësore, pyjore dhe blegtorale. Pa mos sistemuar luginat që gryhen sa vjen e më shumë, pa mos ripyllëzuar pllajat e thyera që vijnë duke u shpënlarë ng mot në mot nuk mund të kihet një qeverim i mirë i ujrave dhe si rjedhim një bujqësi e përparuar.

Nga pikëpamja gjeologjike, në Gramos predominojnë formacionet e serpentinit dhe të flyshit.

Me gjithë se tokat nuk janë nga më të mirat dhe me gjithë se në korrik e gusht nuk bie veç se pakë shi, s'ka dyshim që ripyllëzimet, po të bëhen me kujdes duke përdorur lloje drurësh e mënyra mbjellje të përshtatëshme, do t' ipnin përfundime të mira.

Sistemi i mbjelljes që do të përdoret, d.m.th. mbjellje me gropa ose mbjellje me shkallë (gradone), duhet të jetë sipas vëndit (vënt i rrëpirët ose jo) dhe sipas llojit të tokës (tokë e mirë ose e keqe). Natyrisht në shumë vënde ka për të qënë nevoja të përdoren që të dyja këto metoda të kombinuara me njera tjetrën.

Ndërsa me mbledhjen shkallë-shkallë kihen përfundime të mira në çfardo teren dhe në çdo lloj toke, mbjellja me gropa nuk jep përfundime të mira veçse në vënde me tokë të mirë: secila nga këto mënyra mbjelljeje duhet përdorur, dhe kjo caktohet në vend. Por cilido qoftë sistemi i ripyllëzimit, një gjë duhet të kihet parasysh që më parë: mbjellja të bëhet me drurë të përshtatëshme dhe në mënyrën më të mirë.

Llohet pyjore më të përshtatëshëm për ripyllëzimin e Gramozit janë:

a) Për *sonën e dushqeve* (*Castanetum*) pisha e zezë, bredhi i Greqisë (*Abies cephalonica*), shpardhi (*Quercus hungarica*), bungëbuta (*Q. pubescens*) dhe qarri (*Quercus cerris*), panja fletëgjerë (*Acer obtusatum*) e në ndonjë vend edhe *Robinia pseudacacia*. Sidomos, të një rëndësije të dorës parë duhen konsideruar pisha e zezë e shpardhi për lëndë ndërtimi, qarri për dru zjarri dhe robinala për të sistemuar tokat që shëmben. Që të gjitha këto lloje kanë mundësi të mbillen drejt për drejt në teren pa qenë nevoja të mprohen. Si pisha e zezë ashtu edhe dushqet e përmëndur më sipër janë drurë autoktonë, janë lloje që takohen si në Kolonjë vetë ashtu dhe në krahinat kufitare.

b) Për *sonën e ahut* (*Fagetum*), ahu, *Abies Bartoli-regis*, pisha, në pjesën e poshtme, dhe rrobulli, në pjesën e sipërme; pastaj, dunjat (*Acer pseudoplatanus* e *A. obtusatum*) dhe, në faqet verlore të luginës së Vallmarës e të Lumit të Starjes, me pakicë, Abies alba.

Që të gjitha këto esenca pyjore kishin për të dhënë përfundime të mira në rast se mbillen në tokat e altitudat e përshtatëshme. Sidomos pisha e rrobulli duhen mbjellë si dru pregatitorë në shkallë të gjerë në zonat përkatëse; d.m.th. gjer në 1500 m. pisha dhe përmbi 1500 m. rrobulli; si dru defi-nitivë, pisha gjer në 1400 m. dhe rrobulli ndërmjet 1900-2200 m.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKENCORE

SISTEMIMET

Dëmet që shihen në përrënjt e ndryshëm të Gramozit janë të një natyre të ndryshme, por që të gjithë janë të lidhur ngusht me regjimin e shrgullit të ujrave.

Ka disa lumenj që kanë burimet e tyre në Gramos: më të rëndësishmit janë: Lumi i Kozelit, Lumi i Skorovotit e Kreshovës, Lumi i Starjes si dhe lumënj më të vegjël të Rehovës dhe të Prodanit. Që të gjithë këta lumënj janë të dëmëshëm, po ata që dëmtojnë më tepër fushën e Kolonjës janë Lumi i Starjes dhe Lumi Rrapë që e kanë mbushur me zhavor pjesën më të madhe të rrëzës së fushës përposh syresh. Që të dy këta lumënj sjellin nga rripat e shveshura e të degraduara me mijra metra kub materjal detritik.

Kjo rjeth nga veprimi i shirave dhe i ujrave që përshkojnë pllajat e thyera të Gramozit. Dhe me qenë se natyra e tokës është e butë, fenomeni i gryerjes paraqitet në trajtat më karakteristike të tij. Por edhe atje ku një gryerje e tillë e rëndë nuk ngjet, prap se prap degradim ka. Pllajat e rëpirta që dikur ishin të veshura pjesërisht me bar, paraqesin mjaft pika të dobëta për gryerjen e tyre nga ujrat, kështu që me përjashtim të luginave në jugë të Badrës që janë pak' a shumë të veshura me ah, të gjitha luginat e tjera vijnë duke u degraduar përvjet e më shumë.

Për të ndaluar degradimin e këtyre pllajave të shveshura gjer më sot nuk është bërë asgjë, me gjithëse ujrat e lumit të Starjes vënë në rrezik pothuaj se përvjet rrugën kombëtare që shkon përmes fushës.

Për të larguar rrezikun e ujrave si dhe për të vleftësuar vargun e gjërë të Gramozit, është e nevojëshme që të fillohet sa më parë me studimet përkatëse për pyllëzimin dhe sistemimin e të gjithë këtij mali, që prej tokave të shveshura, kullotave e pyjeve gjer te tokat e kultivuara dhe shtratet e lumenjve. Në një vepër të tillë të madhe pjesa hidraulike duhet t' u përshtatet nevojave që janë të domosdoshme për të ndaluar dëmet lokale dhe imediate si dhe të lejojë një sistemim të parë të rripave për t'i dhënë vegjetacjonit mundësinë t'i veshë këto në kohën më të shkurtër e në mënyrën më të mirë. Do të jenë pra të nevojëshme vepra hidraulike të vogla për të krijuar atë dishkanë minimale të mundësisë që do të lejojë të vërë në veprim një program të gjërë sistemimi agro-silvopastoral. Ndërsa pjesa bujqësore duhet zhvilluar sidomos në sistemin e tokave malore, pjesa pyjore duhet të përfshijë si tokat absolute pyjore ashtu dhe gjithë tokat e tjera që duhen veshur, ose pse e kërkon natyra e vendit ose pse pyjet përbëjnë të vetëmen mundësi të shfrytëzimit të tyre. Duke vepruar në këtë mënyrë popullsisë së kësaj krahine malore do t'i hapeshin perspektiva të reja zhvillimi jetese.

Duke pakësuar vrullin e ujrave vjen vetiu se gryerja e tokës ka për t'u kufizuar gjithashtu e s'ka për të patur me rrezik erosioni a degradimi.

Sipërfaqet pyjore që përqendrohen vetëm në pjesën jugore si dhe parcialisht n'atë të veriut, ndënë kushte normale në të cilat gjinden tokat malore të Gramozit, janë krejt të pamjaftuarshme për regullimin e ujrave. Po dhe për ato zona të pakëta që janë të veshura, forma me e përhapur e qeverimit të pyjeve është pylli i ulët i cili, duke mos qenë i dëndur sa duhet, tokën nuk e mpron sa lypset.

Gjëja më kryesore për të bërë që të mos gryhet toka është veshja e saj

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

me një rrip të gjërë pyjesh, i cili vënde-vënde duhet të shtrihet dhe në vetë zonën më të lartë të Gramozit. Kjo veshje munt të fitohet duke mbjellë në vëndet e rrjepura shkurre subalpine.

Se sa e madhe duhet të jetë sipërfaqja e tokave për t'u veshur me pyll dhe sa e madhe ajo që duhet të mbesë kullotë, kjo nuk mund të caktohet qysh më parë, pa bërë studime më t'imta dhe më të plota në lidhje me kushtet ekonomike të gjithë rrafshnaltës së Kolonjës si dhe në lidhje me shtegëtimin e bagëtive që vijnë të kullosin në këtë rreth.

Vështirësitë më të mëdha që kanë për t'i dalë sistemimit të Gramozit do të vijnë si nga gjë e gjallë që shtegëton në këto male ashtu edhe nga bagëti e fshatrave përfund tyre që vjen duke u shtuar nga mot në mot. Një zgjidhje e këtij problemi nuk mund të bëhet pa filluar më parë me disiplinimin e kullotjes dhe me përmirësimin e zonave kullosore, duke bërë pastrime gurësh, duke riveshur me bar vëndet e shveshura si dhe duke përmirësuar florën e tyre. Në këtë mënyrë shtypja që bën sot gjë e gjallë mi tokat e shveshura e pyjet e degraduara do të kufizohej në minimumin, gjë që do të lejonte ripyllëzim e kësaj zone të gjërë kullosore, pa sjellë një disekilibrim fort të madh në sistemin e sotshëm të jetës së popullatës së kësaj krahine malore.

* * *

Si përfundim i sa u shpjegua me sipër del se shkaku kryesor i shrregullimit hidrogjeologjik të rrafshnaltës së Kolonjës është shveshja e maleve të Gramozit, ripyllëzimi dhe sistemimi i të cilëve është i nevojëshëm dhe i mundëshëm teknikisht.

Në lidhje me ripyllëzimin dhe sistemimin e Gramozit le të na lejohet të vërejmë dhe sa vijon:

Në zonën e kullotave alpine, d. m. th. në zonën sipër pyjeve, vëndin e parë për të ndaluar të gryerit e tokës, duhet t'a zërë përmirësimi i kojës së barit, dhe atje ku kjo mungon, krijimi i një lëndine të përshtatëshme.

Përbri riveshjes së tokave me bar duhet të ndërtohen prita e sistemime të vogla në gjithë ato vënde ku shihet nevoja.

Përmirësimi i sipërfaqeve kullosore nuk do t'i vlenjë vetëm ripyllëzimit dhe sistemimit, por tërthorazi do të vlenjë edhe për të pakësuar shtypjen që ushtron gjë e gjallë mi vetë kullotat dhe pyjet: këto duke u ulrur nga gjë e gjallë, kanë mundësinë të përmirësohen e të mëkëmben.

Tokat e shveshura munt të sistemohen me dy mënyra: me ripyllëzime të thjeshta ose me sistemime.

Në lidhje me ripyllëzimet, vëmë në dukje se në disa zona ka për të qenë e nevojëshme mbjellja e një esence pyjore pregatitore. Po dhe në kushte të tilla është e nevojëshme që llojeve pyjore me më pak vleftë t'u përzihet një esencë më e vleftëshme, duke e mbjellur këtë në grupe të vegjël në tokat më të mira. Në këtë mënyrë, me kalim të kohës ka për t'u transformuar natyralisht pylli provizor në një pyll definitiv.

Një gjë e tillë vlen sidomos për tokat e shveshura të zonës së ahut, që dash e pa dashur ka për të qenë nevoja të mbillen me pishë të zezë (*Pinus nigra*) ose me rrobull (*Pinus leucodermis*). Duke u përzierë këtyre esencave bredha (mundësisht *Abies Borisii-regis*) kanë për t'u krijuar kështu qendra përhapjeje të këtyre llojeve që janë kaqë të vleftëshme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

III. KULLOTAT

Në Gramozin e Kolonjës gjinden 15 kullota që zënë një sipërfaqe prej afro 9500 hektarë dhe kanë një kapacitet prej 22.000 krerë kafshë t'imta, por sot ato janë të ngarkuara me 26.600 krerë dhen, 2130 dhi dhe 470 njëthundrakë. Me qënë se shumica e kullotave të Gramozit janë shumë të rëpirëta dhe pa rrugë, në pjesën e tyre më të madhe nuk vlejnë veç për të kullotur në 'to dhen.

Bjeshkimi fillon aty nga fundi i muajit të majit dhe vazhdon gjer në fillim të nëntorit. Në zonat më të lartra, të kulloturit zgjatet vetëm prej 15 qershorit gjer dy javët e para të tetorit.

Si kullotje dhënsh, pllajat e shveshuna të Gramozit janë të përshtatëshme për një bjeshkim racional, sepse shtrihen prej 1200 gjer 2400 m., sepse ujët nuk u mungon dhe bari që mbin në 'to është shumë i ushqyeshëm. Nga barërat, ato që zotërojnë janë graminoret, por dhe bishtajoret nuk mungojnë. Krahas me këto bimë takohen dhe bimë familjesh të tjera që në përgjithësi s'kanë veçse një vlefitë të vogël ushqimore.

QEVERIMI DHE SHFRYTËZIMI I KULLOTAVE

Kushtet në të cilat ndodhen kullotat e Gramozit nuk janë të mira, sidomos për shkak se nuk trajtohen si duhet, d. m. th. nuk mirren masat e nevojëshme për ndalimin e varfërimit të tyre.

Blegtorët kullotat i konsiderojnë si një gjë të pa-shtershme, si një gjë të natyrëshme për të cilën s'është nevoja të mirren masa mirëmbajtjeje, se bari rritet vetiu. Ky është shkaku kryesor që bën të mos tregohet asnjë kujdes për të pastruar kullotat nga gurët, barërat e këqija dhe gjëmbat; kështu një pjesë e sipërfaqes së këtyre kullotave mbetet e papërdorur. Pastrimi i kullotave nga gurët, barërat e këqija dhe ferrat po të përsëritej mot për mot, do të sillte një përmirësim të ndiheshëm në ushqimin e gjësë së gjallë në t' arthunen.

Krah për krah me pastrimin e kullotave duhet të shkojë dhe sistemi i tokës dhe veshja me bar e sipërfaqeve të shpërlara nga ujrat dhe e atyre që s'janë veçse pjesërisht të veshura me barëra të përshtatëshme. Në raste të tilla duhet që të fillohet sa më parë me mbjelljen e bimëve foragjerë të përshtatëshme duke patur kujdes që vëndet e rimbiella të plehërohen duke fjetur në 'to gjën' e gjallë.

Një gjë që sot nuk njihet por që mund të vlerë shumë për shtimin e barit është të vaditurit. Është e vërtetë që të vaditurit ndër male paraget vështirësi, por gjithashtu nuk duhet harruar se je në pakë kullota ka mjaft sheshe e vende të vajtsura që mund të ujiteshin. Përndaj n' ato vënde që ka ujra të mjaftuarshme dhe që ndodhen afër zonave kullosore jo fort të pjerta, ose n'ato vënde ku s'është frika se mos lermohen frana, mund të vaditeshin shumë sipërfaqe kullose të gjëra me pak shpenzime.

Një arësye tjetër e varfërimit të kullotave të Gramozit nga mot në mot është shfrytëzimi irracional i tyre. Rregullisht në kullotat e Gramozit shtihen për të kullotur sa më shumë bagëti, pa marrë parasysh dëmin që mund t' u

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

shkaktohet nga një ngarkim i tillë. Shfrytëzimi i jashtëfuqishëm i këtyre kullotave ka shkaktuar varfërimin e lëndinës, kështu që kullotat vijnë duke u degraduar vazhdimisht.

Kuptohet vetiu se kur një kullotë hahet me më shumë bagëti nga ç'mund të ushqenjë, jo vetëm që kullota shkatërohet po dhe vetë gjë e gjallë dobësohet, se kafshët duke mos gjetur ushqim të mjaftuarshëm detyrohen të bëjnë lëvizje të mëdha për të shuar urinë e tyre. Një gjë e tillë përpos se dobëson bagëtinë dëmton barin duke mos e lënë të zhvillohet; njëkohësisht fillon të dobësohet dhe vetë lëndina kështu që në një kohë jo të largët edhe kullota më e mirë dhe më e pjellëshme shkatërohet.

Për të ndaluar dëmtimin e kullotave është e nevojëshëme që këto të shfrytëzohen më racionalisht duke mos i ngrënë këto në blloqe, por duke i kullotur në pjesë-pjesë dhe simbas kapacitetit të çdo pjese. Vetëm duke u ngrënë një kullotë në këtë mënyrë do të i lpet mundësija barit të zhvillohet si duhet. Gjë e gjallë si të ketë kullotur për disa dit në një pjesë të tillë kullosore, shtihet të kullosë një pjesë tjetër dhe kështu vazhdimisht gjer sa të jetë ngrënë e gjithë kullota. Kuptohet vetiu se në pjesët e ngrëna por që nuk kulloten vazhdimisht, bari ka të gjitha mundësitë të rritet.

S'ka asnjë dyshim se duke u shfrytëzuar një kullotë në këtë mënyrë ajo jo vetëm që nuk shkatërohet por vjen dhe duke u përmirësuar, po të kihet sidomos kujdes që herë pas here të lihet një pjesë e saj pa u ngrënë për t'a bërë që të vishet vetiu me bar.

PËRMIRËSIMI I KULLOTAVE

Pajisja e kullotave me ugrehina.

Sot për sot asnjë nga kullotat e Gramozit nuk është e pajisur me ndonjë lloj ugrehine; qoftë kjo dhe një kasolle e thjeshtë. Natyrisht, duke munguar ndërtesat për punimin e qumështit, bulmeti që punohet sot në baxhot primitive t'improvizuara nuk mund t'i përgjigjet plotësisht rregullave të higjienës. Gjithashtú duke mos qenë të pajisur kullotat me gjysmë-stalla për mprojtjen e dhënve në ditët e vrazhdëta, prodhimi i qumështit nuk është i kënaqëshëm. Krahas me ugrehjen e bulmetoreve dhe gjysmë-stallave duhet të shkojë dhe ndërtimi i kasolleve për fjetjen e barinjve, të cilët në këto male të larta janë të detyruar të bëjnë një jetë të vështirë për mungesë të çdo lehtësije jetese.

Pajisja e kullotave me kronje dhe lugje.

Eshtë e drejtë se kullotave të Gramozit nuk u mungon ujët, por për të mos munduar gjën'e gjallë të zbresë e të hipë në rrapave dhe përronjve si dhe për të mos i dhënë shkas tokës që të frahohet nga të shkelurit, është e domosdoshme që, atje ku e lyp nevoja, ujrat e rjedhëshëm të mblidhen në kronje të pajisur me lugje të përshtatëshëm. Këto ujëra mund të përdoreshin njëkohësisht dhe për të ujitur kullotën, kështu që me një punë kihen dy përfitime: shtimi i qumështit dhe ay i mishit.

Pastrimi i kullotave nga gurët

Që të gjitha kullotat e Gramozit janë të mbushura me gurë. Këta përveç se, me vëndin që zënë, pengojnë gjën'e gjallë gjatë kullotjes, ngushtojnë mjaft dhe sipërfaqen e kullotave. Pastrimi pra i gurëve duhet të jetë një nga

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKENCARE

masat më të para që duhen marrë për vleftësimin e kullotave dhe, duke qënë se është një vepër e thjeshtë, d.m.th. që nuk kërkon ndonjë teknikë të posaçme, mund të kontribuojnë në grumbullimin e tyre dhe fëmija e vegjël.

Përmirësimi i florës

Siç u përmënd edhe më sipër nga të kulloturit shumë, pjesa më e madhe e kullotave të Gramozit nuk përmbajnë veçse pjesërisht dhe me sasi të kufizuara barëra të mira foragjere. Të gjitha këto sipërfaqe ka mundësi të rivishen përsëri me bimë foragjere të vleftëshme me anë të rimbiellieve artificiale. Por që të kenë suksesin e duhur mbiellja e tilla, duhet më parë që të gjindet fara e përshtatëshme, gjë që mund të sigurohet në vënd duke u përdorur për prodhim fare disa nga sheshet e veshtira me bimë foragjere të dorës së parë. Kjo është një mundësi. Një tjetër mënyrë pët të siguruar farën kishte për të qenë kultivimi i bimëve foragjere në një vend të përshtatëshëm për këtë qëllim.

Krijimi i një rrjete rrugash

Në të gjithë vargun e Gramozit nuk ekziston as një rrugë qerreje. Dhe ato të pakëta rrugë kafshësh që janë, ndodhen në një gjendje të keqe. Mund të mirret me mënd se sa kohë dhe ç'mundime kërkohen për të bartur me anë të kafshëve, nëpërmjet të këtyre rrugëve të vështira e të rrezikëshme, bulmetrat e ndryshmë nga kullotat për në treg, dhe, prej tregut, ushqimet e materjalet e ndryshme për në kullotë. Ndërtimi i një rrjete rrugësh të përshtatëshme do të lehtësonte për së tepërmi si vetë transportin ashtu edhe ngritjen e gjësë së gjallë për në kullotat e nalta nëpërmjet të këtyre rrugëve.

Veshja e kullotave me drurë mprojtës

Shumë kishte për t'i vleftur gjësë së gjallë që kullot në Gramoz mbiellja e disa tufave rrobujsh të cilët, njëkohësisht me mprojtjen e gjësë së gjallë nga stuhitë e vapa, do të mpronin me rrënjët e gjethin e tyre dhe tokën e shveshur. Por edhe vetë punimit të bulmetrave, që sot bëhet duke sjellë dru nga vënde të largëta, mbiellja e disa vëndeve me esenca të përshtatëshme pyjore do t'i vlente më së miri.

* * *

Vetëm duke përmirësuar kullotat nga të gjitha anët, d.m.th. duke i pastruar nga gurët e ferrat, duke përmirësuar florën e tyre, duke i pajisur me rrugë të përshtatëshme, duke sistemuar ujrat dhe sidomos duke goditur ndërtesa për punimin e bulmetrave e duke ndërtuar strehime për njerëz e kafshë do të qe e mundur një shtim i gjithëanëshëm i prodhimeve blegtorale.

RIMBIELLJA ME BAR E VËNDEVE TË SHVESHUNA

Është më se e ditur që dikur kullotat e Gramozit prodhonin më tepër bar se sa sot, por gjithashtu dihet se këto kanë mundësinë të rivishen përsëri me bimë të vyershme foragjere që i përshtaten klimës dhe natyrës së tokave.

Rruga që duhet ndjekur për të riveshur me bar kullotat e Gramozit është e dyfishtë: riveshje me anë sipërfaqesh të mos kullotura dhe riveshje me anë mbiellješh artificiale.

1. Riveshja me anë sipërfaqesh të moskullotura.

BIBLIOTEKA UNIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Rimbjellja e një kullote me anë të sipërfaqeve të moskullotura supozon që në sipërfaqen për t'u riveshur me bar të gjinden bimë foragjere të përshtatëshme në sasi të mjaftuarshme. Kjo mënyrë rimbiellje përdoret shpesh në praktikën kullosore për riveshjen e lëndinavet të varfëruara. Në lëndina të tilla mjafton që të mos lihet të kullosë gjë e gjallë gjatë një mot-moti. Farat që mbijnë gjatë vjeshtës ose në prendverën e vitit tjetër janë më se të mjaftuarshme për të ridëndësuar kojen e kullotës së varfëruar.

Për kullotat e degraduara një masë e tillë është efikase vetëm atëherë kur sipërfaqja për t'u riveshur bëhet disa vjet me radhë pa u ngrënë. Po të njëjtit qëllim i arrihet, pa qenë nevoja të sakrifikohet, të lihet pa u ngrënë e gjithë kullota, me anë të ashtuquajturve *rrypa riveshje*. Këta rrypa, që janë 75 gjer 100 metra të gjatë dhe 5 e gjer 10 metra të gjerë, zgjidhen në vënde të përshtatëshme për shpërndarjen e farës me anë të erës si në qafa e maja kodrinash. Rrypat e riveshjes, për të mos u dëmtuar nga gjë e gjallë, duhet të thurren me tel me gjëmba; gjerdhe që ndalojnë hyrjen e erës nuk duhen përdorur, mbasi gjithë suksesi i riveshjes së kullotës të degraduar mbështetet në përhapjen e farës me anë të erës. Brënda dy ose tri vjetësh, një pjesë e madhe e kullotës së degraduar që ndodhet për rreth këtyre qëndrave rimbiellieje pa dyshim do të jetë riveshur me bimë të reja foragjere.

Kjo mënyrë rimbiellieje duhet përdorur në shkallë të gjerë në gjithë ato kullota të degraduara që kanë një farë lëndine, por jo të veshur krejtësisht me bimë foragjere të përshtatëshme.

2. Rimbiellja artificiale.

Në kullotat e Gramozit ka mjaft vënde që duhen mbiellë në mënyrë artificiale se, ose këto sipërfaqe janë krejt të shveshura dhe atëhere s'kanë se qysh të rimbillen ose edhe në qoftë se ndodhen pranë lëndinash nuk e vlen barra qiranë të rimbillen me bimë foragjere të dobëta që mund të gjindeshin në këto lëndina.

Që të japin rezultate të mira këto rimbiellje artificiale, lypset që farërat e përdorura t'i përshtaten kushteve klimatike dhe tokësore duke qenë njëkohësisht bimë të mira foragjere.

Nga bimët që mund të japin rezultate të mira në kullotat e Gramozit ndër të tjera janë: *Poa alpina, P. compressa, P. pratensis, Avena elatior, Dactylis glomerata, Lolium perenne, Phleum alpinum, P. pratense, Festuca rubra, F. ovina, Bromus inermis, B. erectus, Agrostis tenuis, Arithoxanthum odoratum, Trisetum flavescens, Trifolium repens T. pratense, Lotus corniculatus, Medicago lupulina, Onobrychis vicaefolia, Anthyllis montana, A. vulneraria e Plantago montana.*

Këtu më poshtë po rrjeshtojmë disa përzierje të këtyre bimëve të ndara si pas llojeve të tokave.

1. Për toka argjillore (të rënda):

	kgr.
Poa alpina ose *P. pratensis*	10
Festuca ovina	» 8
Dactylis glomerata	» 8
Lolium perenne	» 4
Trisetum flavescens	» 5
Trifolium repens	» 2
Medicago lupulina	» 3
Lotus corniculatus	—
	48

2. Për toka të lehta:

	kgr.
Dactylis glomerata	6
Bromus inermis	» 10
Trisetum flavescens	» 3
Lolium perenne	» 5
Festuca ovina	» 8
Poa alpina	» 6
Trifolium pratense	» 3
Medicago lupulina	» 2
Lotus corniculatus	» 6
Anthyllis vulneraria	» 2
	51

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

3. Për toka mesatare:

Daetylis glomerata	kg. 6
Poa compressa	« 8
Festuca rubra	« 10
Lolium perenne	« 8
Agrostis tenuis	« 10
Trisetum flavescens	« 2
Trifolium pratense	« 4
Lotus corniculatus	« 2
	50

4. Për toka e lartësira të ndryshme:

Avena elatior	kg. 4
Bromus erectus	« 6
Festuca glauca	« 8
Poa alpina	« 6
Agrostis tenuis	« 10
Trisetum flavescens	» 4
Anthoxanthum odoratum	« 2
Lotus corniculatus	« 3
Onobrychis sativa	« 2
Trifolium pratense	« 5
	50

LUFTIMI I EROSIONIT NË KULLOTAT E GRAMOZIT

Dëmet më të mëdha të shkakëtuara nga erosioni në kullotat e Gramozit shihen në tokat e shveshura nga çdo lloj mbulesë bimore si dhe në kullotat e ngrëna për së tepërmi. Dëmet nuk kufizohen vetëm në pakësimin e prodhimit në ushqim dhe në mbushjen e tokave bujqësore me zhurr e tinë, ata shtrihen edhe në lëmin e ujrave duke shkaktuar pakësimin e tyre në një shkallë të dukëshme.

Me mijra metra kub dhe i vleftëshëm shpërlahet nga pllajat e shveshura e gjysmë të veshura nga bari për shkak t'erosionit. Është një detyrë e vështirë, por luftimi i erosionit duhet kryer. Veçse më parë së gjithash duhen njohur shkaqet që i japin shkas dobësimit të mbulesës bimore, shdukja e së cilës i çel rrugën erosionit.

Një ndër shkaqet që kontribuon në shdukjen e mbulesës bimore është të ngrënit e një kullote me një sasi më të madhe kafshësh se sa mund t'ushqenë ajo. Të mbikulloturit, siç thirret të ngrënit e një kullote me një sasi gjëje të gjallë të sproporcionuar me kapacitetin e saj, njihet nga fiziku i dobët i bimëve ushqimore të vleftëshme si dhe nga pakësimi i tyre në individë dhe sasi. Më vonë filloinë të duken shenjat e para të shveshjes, të gryerjes dhe të erosionit të tokës. Pra nuk duhet lejuar kurrë dhe në asnjë mënyrë ngrënia e një kullote me më tepër bagëti se sa mund të ushqehen në të.

Erosioni në kullotat e Gramozit është shkaktuar dhe nga të kulloturit pa rregull e pa kohë të barit, d. m. th. nga të ngrënit të barit tepër herët, pa qenë rritur mirë. Sidomos vlen një gjë e tillë për kullotat e lartra të rrëpirëta që hahen fill mbasi ikën dëbora, d. m. th. kur toka është akoma e lagët dhe e shkrifët, gjë që shkakton prishjen e mbulesës bimore. Krahas pra me ndalimin e ngrënies së një kullote me një numur bagëtish më të madh se sa kapaciteti i saj duhet të shkojë dhe ndalimi i kullotjes para se bimët të kenë zënë të rriten, para se të jetë forcuar toka.

Por për një pjesë të mirë të kullotave të Gramozit, masat e mësipërme nuk do të ipnin përfundimet e dëshiruara në lidhje me luftimin e erosionit pa mos marrë dhe disa masa të tjera, si ajo e qarkullimit të kullotjes dhe e veshjes së saj me bar. Vetëm kur kapaciteti i kullotës të jetë caktuar si duhet, kur kullota të hahet në stinën e përshtatëshme dhe kur të jetë adoptuar sistemi i shlodhjes dhe i qarkullimit mund të fitet për marrje masash efikase kundra erosionit.

Në ato kullota ku shpërlarja e tokës dhe gryerja e saj nuk mund të ndalohen me anë të riveshjes me bar për të luftuar erosionin, s'mbetet veçse përjashtimi i gjësë së gjallë nga kullota, terasimi dhe ripyllëzimi, ose sistemimi i kësaj.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRDITA" BARLETI

Pasqyrë e kullotave

Nr. renduer	EMRI I KULLOTËS	Katundi	Sipërfaqja aproksimative Ha.	Gjë e gjallë	
				Dhen	Dhi
1	Mal'i Kozelit	Kozel	350	1000	200
2	Mal'i Butkës	Butkë	1600	4800	400
3	Mal'i Milecit	Milec	900	2800	—
4	Mal'i Skorovotit	Skorovot	830	2504	380
5	Vallamarë	Kreshovë	1020	2565	380
6	Varibob	Starje	1000	3000	—
7	Mal'i Vakëfit	Starje	540	1076	100
8	Kalive	Starje	500	1250	—
9	Razdoll	Rehovë	1120	3366	380
10	Cucul	Taç i sipërm	320	800	—
11	Pelëz a Valaj (Llazinë)	Taç i sipërm	360	900	160
12	Badër	Taç i sipërm	370	935	130
13	Ripez	Taç i sipërm	200	400	—
14	Mal'i Gjonçit	Gjonç	160	400	—
15	Mal'i Leshnjës	Leshnjë	200	400	—

SHËNIM: Në kullotat e sipërme nuk ekzistojnë strehime, qoftë për njeri qoftë për kafshë. Për punimin e bulmetit ndërtohen ngas mot kasolle (baxho) primitive prej thuprash. Po prej thuprash ndërtojnë vlehtë kasollet për banimin e tyre. Ujët për punimin e bulmetrave mirret nga burime e përroni. Bagëtija pinë ujë ku mundin. Ujët është i bollëshëm. Frugë nuk ekzistojnë dhe ato të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

të Gramozit

që kullot Njëthundrakë	Kualiteti	VËREJTJE
37	II	Pjesërisht e pyllëzuar. Ka nevojë për pastrim.
80	I	Kullotë e mirë. Pastrim nga gurët
—	I	Kullotë e mirë, plot me ujra. Ka nevojë për sistemime të vogla dhe pastrime uga gurët
49	II	Disa nga sipërfaqet e saj që gjinden në degradim duhen përjashtuar nga të kulloturit duke u kujdesur njëkohësisht për ripyllëzimin dhe sistemimin e saj. Pastrime rrugësh.
95	II	Si më sipër.
—	I/II	Kullotë e mirë. Ka nevojë për sistemime të vogla e pastrime.
25	II	Pjesa e Lumit Starjes ka nevojë imediate të sistemohet dhe të ripyllëzohet. Rrugë. Pastrime. Mbrojtje e pyllit.
—	II	Rrugë. Pastrime. Sistemime të vogla.
90	I/II	Sistemime të vogla. Pastrime. Mbrojtje e pyllit.
—	II	Rrugë. Pastrime.
60	II/III	Ndalim kullotje në gryken e lumit Rrapë. Ndalim i prerjes së grumbujve që ekzistojnë. Pastrime. Rrugë.
34	II/III	Pjesërisht e veshur me ah. Pastrime gurësh. Rrugë. Sistemime të vogla. Mbrojtje e pyllit.
—	II/III	Kullotë e dobët, e thyer, e ndërprerë prej kulturash bujqësore. Ka nevojë për pastrime e rimbiejlje të pakëta.
—	II	Kullotë mesatarisht e mirë me pyll përsipër. Nevojiten pastrime të vogla gurësh e dëllinjash.
—	II/III	Kullotë e dobët e mbushur plot me dëllinja e shkorre. Ka nevojë për pastrime dhe rimbiejlje me farë bari.

paka vraga që ndodhen janë në gjëndja të keqe. Gjëndja e kullotave jo e mirë, këto nuk janë të përkujdesura. Vënde-vënde janë të mbushura me gurë. Mungojnë drutë e zjarrit se pyjet që ekzistojnë janë prerë. Duhen ndërtuar baxho për punimin e bulmetit, strehime për gjën' e gjallë, kasolle për barinjt. Nevojitet pastrimi i kullotave nga gurë dhe në përgjithësi sistemimi i tyre.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

RÉSUMÉ

En 1947, l'Institut des Sciences, en vue d'étudier sur place la flore de Gramoz et les possibilités d'améliorer les paturages et de reboiser les endroits dénudés se trouvant sur cette chaine de montagnes, a envoyé à Kolonja une expédition scientifique, composée de N. Lako et de l'ing. Ilia Mitrushi.

L'auteur, après avoir traité en général du climat et du sol, fait, dans la première partie, une description de la région et de la flore. Après quoi il décrit les zones phyto-climatiques et aboutit a la conclusion que le mont Gramos au point de vue phytogéographique, se rattache à l'Europe centrale et non point à la Méditerranée, comme on l'a pensé jusqu'à présent (Markgraf).

Dans la deuxième partie l'auteur fait une description générale des forêts, indique les essences forestières et les moyens, propres à reboiser ce massif.

Dans la troisième partie l'auteur traite des pâturages et préconise les procédés et les mesures qu'il est necessaire de prendre en vue de leur amélioration et en vue de combattre l'érosion.

BIBLIOGRAFI

Adamovic : Die pflanzengeographische Stellung und Gliederung der Balkan halbinsel — Denkschr. Akad. Wiss. Wien, Mathnaturw. kl. 80 (1907) 405.

Grisebach : Reise durch Rumelien und nach Brussa im Jahre 1939 — Goetingen 1841.


Markgraf : Pflanzengeographie von Albanien.—Stuttgart 1932

Mitrushi : Kullotat t'ona—Buletini teknik i Min. Bujq. e Pyjeve — Nr. 2, 1943.

Regel : Quer durch den Pindus — Mitt. Deutsch. Dendrolog. Ges: 52 (1942).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Karta e Vegjetacionit Gramoz



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ANONIMI I ELBASANIT

SHKRIMI SHQIP N' ELBASAN NË SHEKUJT XVIII-XIX DHE DHASKAL TODHRI

DH. S. SHUTERIQI

I.

Anonim t'Elbasanit po quajmë njerin nga të dy dorëshkrimet shqipe të vjetra që u gjetën, Janarin e kaluar, n'Arkivën e Institutit të Shkencavet. E kemi fjalën te ai dorëshkrimi i vogël, i skeduar nën Nr. 5093, me alfabet gjer më sot të panjohur në historinë e gjuhës sonë. Sikundër ka qënë lajmuar (1), dorëshkrimi përmban një si predikim ungjillor dhe disa copë të shkurtëra ungjijesh, të përkthyera mjaft lirisht. Arsyet për të cilat po i apim këtij dokumenti emërin e mësipërmë, d.m.th. një origjinë elbasanase, po i çfaqim më poshtë.

1) Dorëshkrimi u gjet në mes një togu dorëshkrimesh të vjetra t'Elbasanit, shqip, shumica me alfabetin e Todhrit dhe nonjë me alfabet grek. Gjithë këto dorëshkrime, të cilat do t'i përshkruajmë shkurtimisht më poshtë, kanë qënë mbledhur n'Elbasan dhe në manastir të Sh. Jonit. Veçse, mbledhësi i tyre, Lef Nosi, s'ka lënë asgjë të shënuar mi to, të pakën me sa dimë ne sot: kur dhe si i mblodhi, kush ia dha, ç'pat mësuar mi auktorët dhe historinë e tyre etj. Për sa i takon Anonimit, me sa duket, ai nuk pat dyshuar se munt të qe shqip dhe as nuk e bëri për fjalë që ta kish këtë dokument, me sa dimë. Po kështu s'kemi asnjë shenjë që të jetë përpjekur të zbulojë gjuhën e disa letrave me alfabete të panjohura, dhe të fillimit të sh.XIX, të cilat u gjetën me dokumentet e mbledhura prej tij. A janë edhe këto letra shqip?

Një shenjë të vetme kemi që Anonimi të ketë bërë pjesë në dokumentet e ndryshme të mbledhura në Sh. Jon: një fletë e izoluar e tij u gjet pas nja dy muajsh brënda në një kondik të vjetër të manastirit (Nr. 5008 i Arkivit t'Institutit të Shkencavet).

2) Në faqen e brëndëshme të kapakut të sipërmë të dorëshkrimit, me vështirësi, lexohet emëri *Theodhor*, me një alfabet silav e grek përzjerë. A mos është emëri i Dhaskal Todh-

1) Te *Zëri i Popullit*, Tiranë 9.1.1949, dhe te *Buletini i Institutit të Shkencavet*, Tiranë 1948, Nr. 2-3, f. 79.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

rit: Theodhori i Haxhi Filipit? Po aty, me shkronja thuaj se të ngjajshëme, janë shkarravitur edhe disa fjalë ose emëra të tjera njerëzish, të cilat s'i kemi lexuar dot dhe që, po të deshifroheshin, munt të na mësonin gjëkafshë të re mi dokumentin. Sidoqoftë, emëri Theodhor tërheq vërejtjen. Ai s'ka qënë shkruar nga një njeri që e njihte mirë alfabetin që përdor: ka qënë shkarravitur, më mirë të themi. Mundet që shkruesi dinte ose mendonte që dorëshkrimi të ketë qënë pronë e Todhrit, gjë që bën të përfundosh se Todhri ka patur n'Elbasan një parardhës, të cilit ia njihte veprën shqipe. Mundet që shkruesi ka menduar se ky dorëshkrim qe vepër e Todhrit vetë, duke mos ia njohur alfabetin këtij.

3) Po në faqen e brëndëshme t'atij kapaku, është vizatuar, me lule përreth, një shkronjë iniciale: ndofta shkronja *i*. Si punë, ky vizatim u përngjet pak nj'a dy vizatimeve të tjera, të cilat gjinden në një tjetër dorëshkrim elbasanas: në radhuan e tregtarit Jakov Popa i vogël — siç e quante gjindja (Nr. 5097, f. 25) — prej lagjes Kala t'Elbasanit.

Ky radhua, herë i mbajtur greqisht dhe herë shqip me alfabetin e Todhrit, ruan kronologjinë e familjes Popa (lindje, martesa, vdekje etj). Në vitin 1812 (f.66), lexojmë se radhoi ka qënë pronë e priftit Petër Papa Prendi. Më 1816 (f.70), mësojmë se radhoi është pronë e një tjetër Jakov Pope, të cilin ne po e quajmë Jakovi i ri, siç duket nip i të parit. Më 1828, duke kaluar nga Elbasani, Petër Papa Prendi shënon mi këtë radhua një mrekulli që ka parë më 1825 në Sh. Jon, me qëllim që të mbahet mënt nga pasardhësit. Petrua duket pra të jetë nonjë prift i Sh. Jonit, që ka farefisni me Popat e Elbasanit, me që bëhet pronar i një radhoi të tyre familjar për një copë herë.

Për sa u takon Popave, vlen të shënojmë se ata janë më të vjetrit tregtarë elbasanas që dimë të kenë përdorur alfabetin e Todhrit: më 1797. Më tjetër anë, Jakovi i vogël ka qënë ortak i të vëllait të Todhrit, i cili quhej edhe ai Jakov — Jakov Haxhi — dhe hesapet e ortakërisë së tyre kanë qënë mbajtur edhe greqisht, edhe me alfabetin e Todhrit në një radhua tjetër që na ka arritur (Nr.5099). Ja pra lidhjet konkrete të tregtarëve Popa me Todhrin dhe me alfabetin e tij.

Në radhuan e tyre Nr. 5097, si në vitin 1812 ashtu edhe më 1828, Petër Papa Prendi ka bërë ato dy vizatimet që, si punë, u

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM FRASHËRI" E.SH.K.O.D.E.R

përngjajnë atij vizatimit të kapakut t'Anonimit. Ka mundësi pra që dorëshkrimi të ketë qënë ndër duar të Petros — njeri kurios, që ve shënime mi radhojt e botës, farefis i Popave —, ose të ketë qënë në dorë priftërinjsh vëndas, të cilët i lulëzonin kështu shkrimet e tyre.

3) Gjithë po n'atë faqe kapaku, me shkronja greke, lexohet emëri Papa Jani *(Papa Jojan)*. Po ky emër është nisur të shkruhet, prej së njëjtës dorë, edhe mi kapakun e fundit të dorëshkrimit anonim. Cili është ky prift?

N'Elbasan dhe Sh. Jon, së lashti, ka patur disa Papa Janë. Në mes tyre ësht edhe një Papa Jan Popa, për të cilin kemi shënim më 1839 (Nr. 5101), si dhe një Papa Jan i Paparistos, prej të cilit kemi gjetur n'Elbasan një dorëshkrim shqip që do të përshkruajmë më tej. Ky prift ka jetuar gjer aty nga fillimi i pjesës së dytë të sh. XIX.

Po diçka tjetër është për të vënë re në kapakun e parë t'Anonimit: si vizatimi ashtu edhe shkrimi i emërit Papa Jan duken të jenë prej së njëjtës dorë dhe me të njëjtën bojë: blu më të zi, që ësht edhe boja e tekstit vetë. Biles, mi këtë kapak, është bërë një herë vizatimi, pastaj është vënë një vijë e hollë (po me atë bojë), e cila e ndan faqen dysh, së fundi, përreth vizatimit, janë shkarravitur disa fjalë ose emëra, në mes të cilave edhe emëri Theodhor, me një bojë tjetër: si kafe e errët. Ka shum mundësi pra që vizatimi të jetë punë e Papa Janit dhe, ndofta, edhe teksti vetë që është me të njëjtën ngjyrë, me sa diktohet sot. Po ky Papa Jan nuk munt të jetë as ai i Popës as ai i Paparistos, sepse gjuha e dokumentit paraqitet mjaft arkaike, edhe më arkaike se ajo e Todhrit, që ka vdekur në fillim të sh. XIX.

Sidoqoftë, gjurmat e mësipërme lenë të mendosh se mos teksti ësht elbasanas, se mos ka qënë në dorë të Popave ose në Sh. Jon. Le të shënojmë se familja Popa është m'e vjetra n'Elbasan që njihet të ketë ruajtur, bres pas bresi, kujtimet dhe dokumentet e saj të shkruara: që nga viti 1780. Një shekull më vonë, më 1881, Grigor Popa, nip i Jakovit të ri, duke lexuar me kujdes radhojt e pleqve të tij, përmbledhi gjithçka gjet aty interesante për fisin e vet dhe për kronologjinë e Elbasanit, greqisht, «sepse tani, shkruan, s'ka më njerës që t'i dinë shkronjat shqip, veç të pakëve» n'Elbasan. Kjo kështu tenton të thuash se mos Anonimi ka qënë nonjë prej Popave të herëshëm dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MATIN BARLETI" SH.K.U.D.E.R

u ruajt në një familje kaqë të kujdesur për dokumentet e saj. Në qoftë gjë, kondiket e vjetra t'Elbasanit dhe të Sh. Jonit munt edhe ta sqarojnë këtë çështje.

Gjithë sa thamë, pa dyshim, janë gjurma të cekta fort. Po, si informim i parë, le të kihen parasysh.

4) Si do të shihet nga faksimilet që po boton sot *Buletini* i Institutit, baza e alfabetit t'Anonimit duket të jetë alfabeti sllaf. Duke lënë mënjanë ç'u tha më lart, po të pranojmë se gjuha e tij është m'e vjetër se ajo e Todhrit, gjë që del nga një krahasim i parë, kjo influencë e sllavishtes n'Elbasan munt të kuptohet lehtë.

Dihet se, gjer më 1767, n'Ohër ekzistonte një Patriarkat bullgar, në luftë shekullcre me Patriarkatin grek të Stambollit. Atë vit, Patriarkati bullgar u çkatërrua dhe Ohri u bë një piskupatë e thjeshtë e Stambollit, e mvarur nga kryepiskupata e Durrsit, e cila u krijua po atë vit. Patrik Arseni i Ohrit i u nënshtrua Patrikut grek. E pra, gjer më 1767, piskupatat e Gorë-Mokrës, Elbasanit, Beratit dhe Durrsit mvareshin nga Patriarkati bullgar i Ohrit (2). Gjer atë vit pra, ortodoksët e këtyre eparhive ishin nën influencën direkte të kishës bullgare.

Ky fakt ka një rëndësi të madhe. Studimi i kësaj çështje, pa dyshim, do të hedhë mjaft dritë mi historinë e shkrimit shqip jo vetëm n'Elbasan, po dhe në Voskopojë (qendër që duhej të mvarej nga piskupata e Gorë-Mokrës) dhe në Berat. Gjithë këto qëndra, dhe të tjera si Grabova e Vërçës, Llënga e Mokrës, Niça e Gorës, Vithkuqi etj, kanë pasur marëdhënie të ngushta në shekujt e kaluar, të pakën në sh. XVII-XIX, ma-

2) Mitropoliti Sardeon GERMANOS: *Katalogët episkopalë t' eparhive t' Epirit dhe Shqipërisë, që mvareshin nga Patriarkati i Stambollit*, Stamboll 1937 (përkth. shqip nga greqishtja, i Arkivës s' Institutit). Duket se ahere, episkopi i Gorë-Mokrës, Averkiu, rezistoi më shumë se të tjerët dhe vetëm pas pesë vjeç, më 1772, u rrëzua nga froni «për gabime kanonike» (?), duke u prishur edhe episkopata e tij, e cila i u aneksua Durrsit. Interesant është të shënohet se, tamam më 1768, metu pas prishjes së Patriarkatit bullgar t' Ohrit, nisin prishjet e para të Voskopojës. Këto u bënë nga bejlerët dhe agallarët përreth, të cilët munt t'i këtë shtyrë Turqia, me kërkesën e Fanarit, që vetëm kështu do të këtë arritur ta nënshtrojë Averkiun. Më 1772, edhe mitropoliti i Beratit, Joasaf, heq dorë me dashje nga detyra e tij dhe dënohet rëndë nga Patriarkati grek. Po edhe ai që i zuri vëndin, Meleti, hoqi dorë shpejt, sepse «gjeti vështirësi në kryerjen e detyrës së tij dhe e kuptoi se ai vetë nuk ish i zoti t'i kapërxejë», dhe nuk deshi «të sjellë trazira në kishë».

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SH. K. O. E. R.

rëdhënie tregtare një herë dhe pastaj të tjera. Koka e tyre spirituale, gjer më 1767, ishte Ohri, qendra e Patrikut të tyre. Pa dyshim, shkrimi i shqipes në sh. XVIII — e pse jo dhe më parë ? — ka gjetur mbështetje të mirë te rezistenca e kishës bullgare kundër kishës greke, sikundër duhet të ketë gjetur edhe zvetë populli ortodoks kundër Patriarkatit të Stambollit, që ishte një nga feudalët më të mbëdhenj të Turqisë dhe dora e djathtë e sulltanëve për të shtypur politikisht dhe ekonomikisht rajenë. Tentativa e Todhrit për ta bërë kishën shqip — ai pat përkthyer edhe ungjijet, po sidomos *Liturgjinë* (3) —, munt dhe duhet të ketë qënë një tentativë e guximëshme për të mos rënë kryekëput nën kthetrat e Patriarkatit grek, një formë rezistence shqiptare, në Shqipëri të mesme, pas çkatërrimit të kishës bullgare. Dhe Todhri s'është vetëm. Tamam më 1768 duket se e ka nisur punën e tij shqipe përkthyesi beratas, Kostantini (4). Dhe sikundër shkrimet e Todhrit dhe alfabeti i tij patën sukses të math n'Eibasan, si do ta shohim, dhe ndofta u njohën dhe u ndoqën edhe në Berat, siç na e dëshmon Hahn-i (5), kështu edhe përkthimet e Kostantinit nga Berati vajtën gjer në Vithkuq, me anë të një dhaskali të kohës, Kostë Cepi (6), ndofta dhe gjetiu. Nuk duket të jetë pa gisht kisha greke më 1797, kur botohet fjalori tetraglos i mjeshtërit Dhanil, për

---

3) J. G. HAHN: *Shënime përmi shkrimin e vjetër shqip* (përkth. nga *Albanesische Studien, I),* Stamboll 1910, f. 36.

4) Sipas kreit të faqes 3 të dorëshkrimit që ka Biblioteka Kombëtare, ku mësojmë se punën e nisi më 21 Maj 1768 një farë Konstantini dhe jo «Konstantin Ieromonaku», si e pretendon I. M. Qafëzezi (gazeta *Drita*, Tiranë 16-17.VIII.1938). Fjala «Ieromonak» ka qënë shkruar më vonë mi dorëshkrimt, me kalem dhe s'ka asnjë shënjë që të ketë ekzistuar më parë. Duket se është një shtesë fare e vonë, e ditëve tona mbase. E shënojmë këtë, sepse z. Qafëzezi e identifikon Konstantinin me një «Ikonom dhe iereis Konstantin» që, bashkë me Todhrin dhe Kavaliotin, kanë nënshkruar një dokument në Voskopojë më 1779 botuar nga A. ALEKSUDHIS, *Sindomos istoriqi perigrafi tis ieras mitropoleos Velegradhon, Korfus 1868*, f. 73, (*Përpjekja shqiptare*, 1937, f. 250). Identifikimi nuk provohet.

5) HAHN, f. 36.

6) Dorëshkrimi i këtij dhaskali ka qënë gjetur në Vithkuq nga I. M. Qafëzezi. Gjetësi nuk e ka vënë re se lënda e tij është e njëjtë me atë të Kostantinit nga Berati: një transkriptim pikë për pikë, me nonjë gabim ortografie. Kostë Cepi ka ardhur në Vithkuq nga Berati më 1828 dhe e ka gjetur ishatin të djegur. Po atë vit munt të ketë gjellë me vehte nga ky qytet kopjen që i ka bërë pjesërisht Kostantinit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

t'u mësuar greqishten vllehëve, bullgarëve dhe shqiptarëve. Ja shenjat e luftës në mes të dy palëve.

Njihet teza e Geitler-it, sipas të cilit alfabeti që përdori Todhri është babai i alfabetit glagolitik (7). Pa dyshim, kjo tezë është e gabuar : alfabeti glagolitik është m'i vjetër se ai i Todhrit. Po ballafaqimet që bën Geitler-i në mes të dy alfabeteve janë shum interesante dhe tregojnë afëri evidente në mes tyre, me gjithë që më vonë është thënë se alfabeti i Todhrit është një kursif grek i sh. XVIII, i stilizuar individualisht (8). Sidoqoftë, për alfabetin e tij — në se e ka krijuar ai vetë (9) —, Todhri ka pësuar, në një mënyrë ose në një tjetër, influencën e alfabetit sllaf. Dhe kjo spiegohet, sepse ai e ka arritur kohën e influencës direkte të kishës bullgare n'Elbasan dhe ka jetuar çastet e përleshjes së fundit në mes të dy Patriarkateve, sikundër do ta shohim më tej.

Në se Todhri krijoi një alfabet shum origjinal duke u bazuar te alfabeti sllaf dhe të nonjë kursif grek i kohës, po kështu duket të ketë bërë edhe Anonimi i jonë, i cili, edhe ai, ka përdorur një alfabet mjaft origjinal. Ky duket të jetë edhe m'i vjetër se Todhri ; pra edhe m'e thellë ka qënë te ai influenca e sllavishtes : alfabeti i tij është më shum sllaf se grek. Ka të ngjarë që Anonimi të jetë m'i herëshëm se viti 1767, d.m.th. të jetë i kohës s'influencës direkte të kishës sllave në Shqipëri të mesme. Ai origjinën duhet ta ketë tamam në Shqipëri të mesme, kryesisht n'Elbasan, ku do të zhvillohet shkrimi shqip me një alfabet origjinal jo pa lidhje me alfabetin sllaf, në pjesën e dytë të sh. XVIII dhe gjithë sh. XIX.

5) Një mendim të tillë e përforcon edhe gjuha e Anonimit. Kjo paraqitet si një gegërishte e mesme, m'e vjetër se gjuha e Todhrit. Po toskizmat e saj janë të shuma dhe sistematike.

Anonimi munt ta ketë përzjerë gjuhën e tij duke ndenjur në Toskëri, posaçërisht në Korçë me rrethe (Voskopojë, Sh. Naum (10) etj), në Berat, ndofta dhe në Vlorë me rrethe, siç

7) L. Geitler : *Die Albanesischen und Slavischen Schriffen,* Vienë 1883.

8) Gj. PEKMEZI : *Vorlaeufiger ueber das Studium des Dialektes von Elbasan,* in : Anzeiger der philosophisch-historischen Cl. der k. Ak. der Wissensch., Vienë 1901.

9) V. fundin e artikullit.

10) Mi marëdhëniet në mes Voskopojës dhe manastireve të Sh. Naumit dhe Sh. Jonit, v. E. KURILLA : *I Moskopolis qe i néa Akadhimia avtis,* Athinë 1935 (veçanërisht f. 256).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SH.T.U.D.E.P.

duket nga disa dialektalizma tipike të këtyre viseve (11). Po ka të ngjarë të ketë njohur edhe veriun e Shqipërisë, në mos shkrimtarët e vjetër gegë, sepse përdor nonjë formë mjaft veriore (12). Në se ka qënë klerik i Sh. Jonit, prap influencimet e tij të ndryshme dialektale spiegohen sepse në këtë manastir ka patur kurdoherë klerikë nga gjithë viset e Shqipërisë, edhe nga shtetet fqinj.

Le të shënojmë se diktohet në shkrimin e tij një si përpjekje gjuhësore. Turqizmat i ka shum të ralla: gjithsejt gjashtë. Greqizma ka nja dy herë kaqë (13). Në një vënt (f 29), ka shkruar fja-

---

11) Nuku; të jeç, të diç; zamëte, dimëte, binite (zemë, dimë, u bini) etj. Këto tri forma të fundit, që u përngjasin labërishtes së sotme kamte, jamte (kam, jam) munt të kenë ekzistuar edhe në Shqipëri të mesme, sepse Anonimi shkruan zamëte dhe jo zemëte. Vini re urdhëroren binite; po kështu përdor edhe: gjallnite, qëronite, nxirnite, epnite. Është një formë e vjetër që nuk dimë të dëgjohet sot në Shqipëri të mesme. Nër format e tjera të vjetra që ka Anonimi, bie në sy rjedhorcja e çquar, të cilën e përdor zakonisht Buzuku: një trimashit, prej tjerëshit, fjalëparëshit etj. E kemi gjetur edhe te Kostë Berati: pei seimenëshit, pei duarshit (f. 79 e dorëshkrimit). Gjindet një herë edhe te Naimi: «që rrjeth qiellshit bukurija» (*Dit' e re*).

12) Prej krygjet, parris (parrajsë), upeshkëpit (dhespotët). Përdor neologjizmin letërorët (levitët), që na thonë se gjindet te Bogdani. Për sa i takon mundësisë që Anonimi të ketë njohur shkrimtarët e veriut, le të shënojmë diçka interesante. Dihet se në Himarë ka patur, në shekujt XVII-XVIII, monakë bazilianë, të dërguar nga Vatikani, të cilët punonin aty me ortodoksët vëndas. Prej tyre, disa kanë qënë arbëreshë nga Italia e Jugut, si Nilo Catalano, nga Siqilia, i cili ka lënë edhe një dorëshkrim të një fjalori shqip-italisht, italisht-shqip, si dhe të një gramatike shqipe, dhe vdiq ipeshk i Durrsit dhe vikar apostolik, në Dhërmi të Himarës (1694). Prej këtyre monakëve, një farë Neofit Rodino, nga ishulli i Qipros, në një letër që dërgon në Romë më 1637, na mëson se, me ndihmën e një prifti vëndas, Dhimitrit kishte përkthyer kateqizmën shqip dhe ia kishte propozuar Propaganda Fides. Kjo i u përgjegj se nuk ish nevoja të botohej, sepse «doktrina e krishterë» kish qënë përkthyer dhe botuar shqip. Është fjala për Budin, pa dyshim. Monakët bazilianë të Himarës kanë qënë në lidhje të ngushta me Patriarkatin bullgar t'Ohrit, i cili mbështetej edhe te Papati në rezistencën e tij kundër Stambollit. Më 1660, vetë Patriku i Ohrit bëri një vizitë në Himarë. Ja pra shenjat e lidhjeve në mes kishës katolike dhe kishës ortodokse në Shqipëri në shekujt XVII-XVIII. Librat që botoheshin në Romë, s'ka pse të mos kenë qarkulluar edhe n'Elbasan e gjetiu në Shqipëri të mesme. V. Nilo BORGIA: *I monaci basiliani d'Italia in Albania*, Romë 1935 (veçanërisht f. 76).

13) Turqizma: sarajet, kabil, dushmanëvet, sahat, pahaj, shehër. Greqizma apostoj, nomi, dhaskal, parigori, stadhium, igemon, laus, marturi etj.

BIBLIOTEKA UNIVERSITARE "MARIN BARLETI" SHKODËR

lën *shehër*, e ka fshirë dhe mi të ka vënë *qytet*. Ka edhe disa neologjizma. Interesant është se ka zëvëndësuar edhe një fjalë si *profit*, kaqë të përgjithësuar në gjuhën tonë, me *fjalëparë* (14). Siç duket pra, ka evituar me sa ka mundur jo vetëm turqizmat po dhe greqizmat. Një gjë të tillë është munduar ta bëjë edhe Todhri më vonë, duke krijuar shum fjalë të ra, po duke evituar më shum greqizmat se turqizmat, gjë që munt të merret si një shenjë e rezistencës së tij kundër kishës greke.

A mos kemi në këtë dokument anonim shenjën e një përpjekje të parë dhe të nërgjegjëshme për të shkruar një gjuhë të përzjerë, d.m.th. të përbashkët shqipe, që së lashti? Hahn-i dëshmon se Todhri qënka marrë me krijimin e një gjuhe të përzjerë shqipe, nga gjithë dialektet bashkë. Në të vërtetë, gegërishtja e mesme, ajo e Elbasanit, në kohë të Todhrit ka qënë më pranë toskërishtes nga ç'është sot. Një afëri e tillë e lehtësonte dhe e nxiste punën për një shqipe të përzjerë, të përbashkët. Kështu, gegërishtja e mesme përdorte rëndom diftongun *ua* te verbat, substantivat dhe agjektivat verbalë (shkuam, të shkruame etj.) dhe në fjalë të tjera (grua, ftua etj). Një gjë e tillë vihet re te Anonimi, Todhri, shkrimet e ndryshme t'Elbasanit në sh. XIX, dhe akoma munt ta dëgjosh edhe sot n'Elbasan atë diftong (15). Kish edhe afëri të tjera që do të duken te copat që do të japim më poshtë nga Anonimi, Todhri etj. Në se Todhri ia pat hyrë me nërgjegje punës për një shqipe të përzjerë, s'ka pse të mos të ketë pasur një parardhës tjetër elbasanas.

Që ësht elbasanas Anonimi, këtë bëjnë ta mendosh disa forma tipike që ai përdor zakonisht: jo vetëm *c* për *s* (cë prapi, cipër, aci), siç e konstatojmë edhe te Budi më në veri, siç e konstatojmë te Todhri dhe n'Elbasan gjer më sot, po edhe forma të ndryshme të këtij qyteti si: çefun (fshehur), tye (duke), më vjene (më vjen), ende, nde (edhe, dhe), mjen njëme (gjer

14) Neologjizma: letërorëtë, ergjandashun, fjalepare, të patëdashmat (fatkeqësitë?), qinpari (centurioni).

15) Kavalioti (sipas J. THUNMANN: *Untersuchungen über die Geshchte der oestlichen europaeischen Voelker*, Leipzig 1774): mburuam (të fejuar), i gëzuam, i shtëpuam etj. Te Kavalioti nuk mungojnë as gegizmat: andërë (ëndërr), hidhënim, nji, njizet (këto dy të fundit i gjejmë edhe te Dhanili (sipas Per. PAPAHAGI: *Scritori Aromani in secului al XVIII*, Bukuresht 1909). Te Kostë Berati gjejmë: të shejtëruamen, të ngazëlluamen, të lavduruamen etj. Veqilharxhi ka: të shkruame (sipas *Kalendarit kombiar*, 1900).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

tani), ien (legen), të vteni (të dëfteni), pshanëtinë (shamtinë) etj.

6) Përfundim. Anonimi duket të jetë elbasanas, nonjë prift ose murg i Sh. Jonit ndofta, i influencuar prej sllavishtes, i kohës kur eparhia e Elbasanit mvarej nga Patriarkati i Ohrit, m'i vjetër se Todhri, m'i vjetër se viti 1767.

II.

Përfitojmë nga ky rast për t'informuar lexuesit mi tekstet ei vjetra shqipe të nëndialektit t'Elbasanit që ka sot Arkiva e Institutit të Shkencavet ose që gjinden në duar të tjera, duke bërë një përshkrim të shkurtër të shumicës prej tyre dhe duke dhënë nonjë shënim të nevojëshëm. Kjo kështu do të na tregojë se si, n'Elbasan dhe Sh. Jon, Todhri — para tij edhe Anonimi, që na duket elbasanas — krijoi një traditë të shkrimit të shqipes, e cila zgjati më se një shekull. Kjo traditë nuk shihet vetëm te klerikët, po edhe te shtresat e tjera, kryesisht tregtarët. Kjo kështu do të na tregojë se, sot, nëndialekti i Elbasanit munt të ndiqet, në zhvillimin e tij, thuaj se çdo njëzet vjet, që nga fundi i sh. XVIII. Asnjë nëndialekt tjetër i gjuhës sonë nuk munt të ndiqet në këtë mënyrë gjatë asaj kohe; as nëndialekti i Shkodrës, sepse në sh. XIX, ky u shkrua kryesisht nga klerikë italianë, të cilët, sado, nuk munt ta njihnin faremirë.

1) *Anonimi i Elbasanit.* Po japim një copë prej tij, përkrah një cope të pabotuar të Todhrit, për të vënë në dukje afëritë dhe ndryshimet në mes tyre.

ANONIMI	TODHRI
Atë ditë darkoi zoti Krisht nd(ë) Vithanit me apostojt në shtëpi të Marisë e Marthësë me t'amënë, e desh të venjë tjetërënë ditë ndë Ierosolimit të kryqzohetë. I thoshinë apostojtë: Dhidhaskale ku do të bajmë gati për pashkë? E Krishti ju tha: Ecëni ndë Ierosolimit, e kini me gjetun një njeri ke	*O zot qi beekon ata qi të lavdojnë, ndë qi shenjtënon ata qi shpreejnë më ty, sos lauz tat, ndë beeko trashëgesën tate; të qenët e kishës tate ruaj; shenjtëno ata qi duanë bukuriinë e shtëpi(së) tate. Ti kihe latë më perëndishtet fuqii tate, ndë mos kiij me na lanë nee qi shpreejmë më*

BIBLIOTEKA UNIVERSITARE "MARIN BARLETI" SHKODËR

bar një shtambë me ujë: atini ju gjitni; e i tho ti zot shtëpisë: Ku është vend qi kam për të bam pashkëtë me të psuamitë mi? E ai ju ka për të ju dëftyam vend të math e atje bani gati. E tye votë këta të dy apostoj, e... (ba)në si i porositi Krishti. Pra pësëri u kthyenë ndë Vithanit... e shkoi atë natë me të mëdha të lutyj. Fal pajtimnë më jetë tate, në kishat tua, më priftënit, në mbretënit tonë, më ushtëriit, nde në gjithë l(au)z tat. Se çdo e mirë dhanë, nde çdo dhunëtii, tamam, të nalti asht zbritun, prej teje atit të ndriçuamevet. Nde çojmë laftnë, e gratëninë, nde lutin, më tyj atnë, e birrë (bir-rë), nde shpiirtin shenjt, njime e kurdo, nde në jetë të jetvet, amin.

tuna, e e njofti zoti Krisht se erth koha, të (d)ahetë prej këco gjinvet të venjë ke i ati. E donte të vinte nde Ierosolim të marë me të dashunitë tij mort. Thirri t'amënë e tij e i thotë: O e amblë (j)ama ime të lutem të jeç me durim të math, e ta diç bukur se është e duhetë të mbarohenë gjithë të thanët e fjalëparëvet, qi kanë shkruam për mu, e duhetë të vdes, për shëndet farësë njeriut; e njëme erth koha e mortsë sime, e ti ke o mama ime të helmohesh tepër mbi gji(th) gra të jetesë. Qe të mbarohetë fjala e shenjtë e plakut (Sim)eon... (k)a për të shkuam shpatë ndë mjedis të zemërësë sate. O mama ime të dhimtunit qi ke për të marë, për mort eme është ajo shpatë qi do të shkonjë ndë zemër të shp(ir)tit yt. Me gjithë këte të dhimtunit është i math, ashtu duhetë të mbarohetë të dashunit të prindit tim. O mama ime sot dua të darkem me apostojt e mi të cëprapëme darkë, e ta dish se duanë të parët e çifutëvet, të më kryqzonjënë, e u shiçë për L (=30) rgjande. Ma kij këtë parigori, se kam për t'u gritun të tretënë (d)itë, e atëherza duhetë të më shofç të lavdshim mbret (të) pa (vd)ekun (16).

2) Një radhua hesapesh i tregtarëvet Jakov Popë i vogël me ortakët e tij Jakov Haxhiu (i vëllai i Todhrit), Kostantin Haxhiu (tjetër vëlla i Todhrit?) dhe një farë Apostol, ndoita i vëllai i Jakov Popës. Shkrimi shuip nis më 1797. Kjo është data m'e vjetër në të cilën e kemi gjetur të shkruar gjer më

16) E transkriptoi Injac Zamputti, f. 6-7 e origjinalit. S'i kemi ndenjur besnikë as pikësimit as ndarjes së fjalëve, të cilat janë shkruar ngjiturazi. Kështu do të bëjmë dhe më poshtë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

sot alfabetin e Todhrit. Në pjesën më të madhe, radhoi është mbajtur greqisht, gjë që munt të tregojë se shkrimi shqip sapo ka filluar të përhapet nër tregtarët elbasanas (Nr. 5099).

3) *Një radhua i dytë hesapesh i Jakov Popës së vogël*, edhe ky me pak shkrim shqip dhe shumicën greqisht. Shqipja nis këtu më 1798. (Nr. 5098).

4) Një radhua kronologjik i familjes Popa, i mbajtur kryesisht shqip me alfabetin e Todhrit, në vitet 1800-1828 (Nr. 5097). Më 1812 ka qënë në dorë të Petro Papa Prendit; më 1816 e trashëgoi Jakovi i ri nga Jakov Popa i vogël, me vdekjen e këtij. Që atë vit, alfabeti shqip nis të përzjehet me nonjë shkronjë greqishte, gjë që do të thotë se Jakovi i ri s'e dinte mirë alfabetin e Todhrit. Është m'i vjetri radhua elbasanas që ka Arkiva, pas kondikeve të ndryshme t'esnafëve dhe kishave. Nis, greqisht, që më 1780 dhe 1785, gjë që duket të na provojë edhe një herë se alfabeti i Todhrit nisi të përdoret më vonë n' Elbasan, rreth viteve 1797-98. Fakti është i rëndësishëm. Radhoi ka edhe një interes etnologjik, sepse ka nja gjashtëmbëdhjetë faqe me reçeta mjeqesh të ndryshme popullore. Sikundër shihet, përmban mjaft material gjuhësor. Ai na dëshmon për gjuhën e Elbasanit në vitet kur vdes Todhri.

5) Një radhua që mban një *Fjalorth* shqip-veneciançe, gjuhët sllave t'Evropës qendrore, gjermanisht, i tregtarit elbasanas Simon (Nr. 5092). Ky radhua u gjet bashkë me Anonimin. Ka një sasi të mirë materiali gjuhësor, disa fish më shum se radhoi i mësipërmë. Ka edhe disa reçeta mjeqesh popullore etj.

Tregtari Simon ka udhëtuar nëpër Trieshtë, Pesht (Vienë), Krakovi, Çestekovë dhe Random të Polonisë. Në Shkurt 1823 duket të ketë qënë në Trieshtë. Në faqen e parë të radhojt greqisht, një farë Todo Grabovski, që banon në Ponçò (?), i ka shkruar që t'i sjellë një tekst gjeografie «romejisht» dhe jo «elenisht» botuar në Venedik më 1706. Munt të jetë nonjë grabovar i Vërçës, i vendosur jashtë për tregti, si kaqë e kaqë shqiptarë te kohës.

Që nga viti 1825, radhoi është bërë regjistër kronografik i një farë Papa Nikollai, elbasanas, dorëzuar prift në Sh. Jon më 1829, vdekur si ekonom i këtij manastiri në 1867 — sipas shënimeve që mban regjistri. Simoni duket të ketë qënë pra nonjë i afërm i ekonom Papa Nikollës, mbasi i ati. Po të kërkohet mirë, munt të gjindet emëri i tij i plotë nër kondike

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

e Elbasanit dhe të Sh. Jonit. Po japim disa radhë të shqipes së tij:

Kush të det të ngjyei beze të kuqe, të marri e të bai fi prej këlqereje e ta kuloi, pra ta shtjer bezen mrenda e ta lai for(t), pra ta qisi e ta lai me ni prateri, pra ta shtjer në bagla lopësh e ta fërkoi fort, pra ta qisi e ta lai e ta teri, pra ta shaplladisi, pra ta lai e ta teri, pra të marri pagëz boi grash, po jo aco boje jeshile, po aco të keqeje, qi asht e bardh, e ta marri e ta shtypi fort e ta bai si mijell, pra të marri atë pëlhurën si ka shaplladisun e ta ngjyei me boi të kuqe, pra t'i shtjer ne atë boi grash mrenda bashk, pra si ta ngjyei me atë boi të kuqe e me atë boi grash, të bi fii prei kalatashi e t'i shtjer ne voi mrenda asai fis kalatashit, pra të shtjer mrenda e ta fërkoi, pra ta lai (17).

6) Një radhua që mban *Liturgjinë e Sh. Jon. Gojartit*, përkthim i Dhaskal Todhrit, kopjuar, prej origjinalit duket, prej ieromonakut Haxhi Josif i Haxhi Anastasit, igumen i manastirit të Sh. Jonit (Nr. 5208). Këto këshitu i mësojmë nga disa rrjeshta sllavisht që kanë qënë shkruar mi kapakun e dorëshkrimit (18). Sa për Haxhi Josifin, po aty marrim vesh se ka qënë elbasanas. Shenjat e tij të para i kemi gjetur te një kondik i Sh. Jonit (Nr. 5008), më 1830, kur ai është igumen dhe epitrop i manastirit. Vdiq më 1852, sipas një kondiku të Sh. Marisë së lagjes Kala t' Elbasanit (Nr. 5172).

Kopja që na ka lënë Haxhi Josifi nga *Liturgjia* ka një vlerë të madhe, sepse, gjer më sot, origjinali i Todhrit nuk njihet. Prej saj kanë qënë botuar disa pjesë te revista *Kopështi Letrar* i Elbasanit (1918).

Për një kohë, Todhri ka shërbyer në Sh. Jon, ndofta si igumen. A është Haxhi Josifi një disheputi direkt i tij? Ka të ngjarë, po të pranojmë se Dhaskali vdiq brënda viteve 1805-6, si do ta shohim më tej.

Në kapakun e dorëshkrimit, po aty ku gjejmë disa rrjeshta sllavisht, gjejmë, shqip me alfabetin e Todhrit, disa fjalë të

17) E transkriptoi Qemal Haxhihasani. Origjinali s' ka asnjë shënjë pikësimi.

18) Këto rrjeshta kanë qënë botuar nga R. NAHTIGAL: *O elbasanskem pismu in pismentstvu na njem*, in Arhiv za arbanasku starinu, jezik i ethnologjiju, Beograd 1923, f. 171.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

përmalluara që një grua, e quajtur Donë, i drejton një tjetre, Sanës. Është fjala për dy murgesha të manastirit të Sh. Jonit, të cilat i mbajmë mënt edhe ne: e para Dona (Andona) e Xhuvanit ka vdekur më 1936 dhe e dyta nja tri vjet më parë. Në duar të tyre ka qënë pra ky dorëshkrim dhe duket edhe dorëshkrimet e tjera shipe të Sh. Jonit. Ato janë të fundit persona që e kanë njohur dhe shkruar alfabetin e Todhrit, me sa dimë ne. Shkrimi i Donës gjindet edhe në funt të *Liturgjisë*, si edhe në disa fletë të tjera të skeduara me Nr. 5212.

7) Një tjetër radhua tregtarësh elbasanas është *radhoi i Tupes* (Nr. 5208). Fletët që i kanë mbetur sot mbajnë hesape të viteve 1844-52, shqip me alfabetin e Todhrit. Ndryshimi me radhojt e Popave, është se Tupja shkruan vetëm shqip. Shkrimin e ka shum të keq. Mi Tupen vetë nuk dimë gjë, po do të jetë e lehtë t'identifikohet nëpër mes kondikeve t' Elbasanit dhe nga familja e tij që është edhe sot n' Elbasan.

8) Një dorëshkrim me *Predikime fetare* dhe me *Këngët e përmivarrëshme*, përkthyer nga Papa Jani i Paparistos, që kemi ne në dorë. Është i pari dorëshkrim shqip elbasanas që gjejmë me alfabetin grek. Ky alfabet është shum i pasigurtë. Duhet krahasuar me alfabetet e Kavaliotit, Dhanilit, Gjirokastritit, librat e të cilëve s'kanë munguar nëpër kishat dhe manastiret tona (19).

Papa Jani ka jetuar në mes të sh. XIX. N'Elbasan na treguan se ishte prift i fshatit Godalesh, një orë lark në verilindje të qytetit, kur fshati nisi të myslimanizohej mirë (20). Gjurmat ia kemi gjetur në një kondik të vjetër të Sh. Marisë së Kalasë në vitet 1846-47 (Nr. 5005). Duket se është i njëjti Papa Jan që gjejmë edhe në Sh. Jon më 1867 (Nr. 5100, kondik i këtij manastiri). Shkrimi i tij është pra rreth një qind vjec. Ai na tregon se gjithkush nuk e përdorte, nga ata që shkruanin shqip, alfabetin e Todhrit n'Elbasan. Në Shqipëri të mesme, nër ortodoksët, mendimet kanë qënë të ndara në mes atyre që shkruanin shqip në shekujt XVIII-XIX: njera palë përdorte shkronjat

19) I. M. Qafëzezi: *Nga librat shqipe të bibliotekës së Sh. Njonit t'Elbasanit*, në Tomorri, Tiranë 13.X.1940.

20) N' Elbasan tregohet gojëdhëna sipas së cilës, kur Papa Jani zbriste prej Godaleshi në qytet, udhës takonte hoxhën që ngjitej, dhe i thosh: «Ti pagëzo, unë gropo» — që do të thotë: ti me të rinjtë, unë me të vjetrit, se këta e ruanin besën.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SH.K.O.D.E.R.

greke, tjera — ajo më intransigjenteja dhe që bënte luftë kundër kishës greke — përdorte shkronja origjinale, sepse kështu afirmohej më mirë gjuha shqipe si një gjuhë fare më vehte dhe populli i jonë si një popull i dalluar nga të tjerët.

Radhoi i Papa Janit ka patur 56 faqe, po katër të parat i kanë humbur. Ka pra lëndë të mjaftë gjuhësore. Po japim një fragment prej *Këngëve të përmivarrëshme* (21):

Të madhënoim, o mbret Iisu Krishtë, ne të nderoim vorrin tatë ene të hekmit e tua. Çunqi me ato të vuitëme na shtipove neve nga gjynafi Adhamit.

Ti qi godite dheen, ti qi i vune karaar, o mbreti gjith dynjas Iisu Krishtë, qysh rri në vorrt sot qi prei vorrezësh ngrite të vdekunit ene i shtëpove?

Iisu Krishtë mbreti gjith dynjas, ç(k)irkove qi erdhe në xhehenem, po erdhe qi të shtëpoish çetin e njerzëvet?...

O jet e pasosme, u vune në vorrt, o Krisht, ene me dashunin tate vdiqe e na shtipove neve nga shejtani.

9) Arkiva e Institutit ka edhe një tjetër dorëshkrim shqip me alfabet greqisht: një *Fjalorth greqisht-shqip* me mjaft lëndë (Nr. 5100). Duket t'i ketë shërbyer nonjërit që nuk e dinte greqishten mirë dhe ndofta do t'udhëtonte në vise ku flitej kjo gjuhë, sepse ka edhe disa këshilla mirësjellje dhe pastërtie të veshjes, po greqisht.

Pronar i fundit i dorëshkrimit ka qënë Papa Anastas Gega, prift i Sh. Jonit, prej katundit Përmishijon, që, siç e tregon edhe emëri, është tamam përmi manastir. Lindi më 1853 dhe vdiq rreth vitit 1917. Në Sh. Jon ka lënë emër për urtësinë e tij. Pa dyshim, ai ka bërë mjaft për t'i ruajtur dokumentet shqipe të manastirit.

Ne mendojmë se *Fjalorthi* është vepër e igumenit të Sh. Jonit, Grigor Todhrit, i cili, më 1863, vajti në haxhillëk bashkë me Anastas Popën, bir i familjes për të cilën folëm — sipas një dokumenti ku vetë Grigori e përshkruan me hollësi udhëtimin e tyre (Nr. 5006). *Fjalorthi* munt t'i ketë shërbyer Anastasit, se Grigori e dinte mirë greqishten, sikundër kuptohet nga shkrimet e tij. Duke ballafaquar këto shkrime me *Fjalorthin*, del se përngjasin fort.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" H. K. O. B. R.

21) I nipi i Papa Janit, Dhimitër Paparisdha, i njohur me emërin Dhaskal Dhimitri, vdekur rreth vitit 1930, ka përkthyer edhe at *Këngët e përmivarrëshme* dhe i ka botuar përpara F.S.Noli-t

i dhe igumen Grigori ka qënë nga Përmishijoni. U dorëzua prift më 1840, kur epitrop i manastirit qe Haxhi Josifi që njohëm. Në kohë të tij janë bërë një pjesë e mirë e ndërtesave të Sh. Jonit që dogjën gjermanët më 1944. Gjurmën e tij të fundit e kemi gjetur më 1876 (Nr. 5100).

10) Një *Predikim i Sh. Efremit* (dhidhaqi), përkthyer shqip më 1878 nga Papa Partheni, tjetër prift i Sh. Jonit, me alfabet të Todhrit (Nr. 5212 a). Auktori, në funt të veprës së tij, e porosit murgeshën Sanë të mos gabohet t'ia apë njeriu «këtë kartë». Është koha kur Turqia ka syun mi lëvizjen e shqiptarëve, koha e Lidhjes së Prizrenit, dhe kur Patriarkati grek e lëfton me të madhet shkrimin e shqipes dhe përkthimin e librave fetare. Më 1876, n'Elbasan, turqit janë munduar të provokojnë një masakër të të krishterëve nga myslimanët, me rastin e luftës ruso-turke, që t'i shtien frikën elementit ortodoks, i cili, për më se një shekull, e priste çlirimin nga Rusia — sipas kronikës së Grigor Popës (Nr. 5140). Para kësaj date, dhespoti i Durrsit, Visari, me gjithë se elbasanas, ka djegur në lagjen e Kalasë librat e Kristoforidhit — sipas kujtimit të pleqve n'Elbasan.

Papa Partheni ishte prej kësaj lagjeje. Emërin e tij e kemi gjetur për herë të parë nër kondike më 1867. Vdiq në fillim të këtij shekulli, fort i motuar. Kujtimi i tij rron akoma n'Elbasan. Ish farefis i mësuesit elbasanas Dhaskal Pinës — Tushi (Dhimitri) Pina —, shqiptar i flaktë i fundit të shekullit, që ka vdekur shum i ri. Ky përmëndet për zgjuarësinë e tij. Shkruante me alfabetin e Stambollit, po e lexonte dhe atë të Todhrit. Duket se ka përkthyer shqip *Edipin* e Sofokliut dhe klasikë të tjerë (22). Arkiva e Instituti ka prej tij disa dorëshkrime, po s'kemi mundur t'i gjejmë akoma.

Papa Partheni ësht i fundit njeri që dimë të këtë shkruar mjaft gjë me alfabetin e Todhrit. Bashkë me Papa Anastas Gegën, ai duhet të këtë bërë shumë për të kuajtur dokumentet shqipe të Sh. Jonit. Dorëshkrimi tij ka rëndësi, sepse na tregon gjëndjen e vërtetë të nëndialektit t'Elbasanit më 1878, sepse prifti shkruan ashtu sikundër flet, kurse Kristoforidhi e punon dhe e përzien gjuhën e qytetit të tij kur e shkruan. Po këtë

22) PEKMEZI, f. 39. Tushi ka qënë orator i fortë dhe duket të këtë mbajtur fjalimin e vdekjes së Kristoforidhit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

interes kanë edhe shkrimet e tjera më të vjetra përballë Todhrit, i cili edhe ai e punon dhe e përzien gjuhën e tij. Një copë nga Papa Partheni:

Macohere dot biin burijat prej qill, ene engjujt dot tundullohen, ene gjith dheu dot tundulllohet posi ujt e detit nga lafti tii. Lum zjarri dot eci për(p)ara aciu, qi t'pastroj gjith dheen për gjynafet. Macohere do shkojn me shend të math ata qi kaan lambadhet me driit, demek ata qi kaan bamun ti mira shpirtit. Macohere kuj të shofish lambadhet e shumet ndezun, e taten të shume, lambadhet e shumet me driit e jotja e errësume, pra at'here do shamtiish, ene me turp dot thuush qi më falni nji çiik voj o vllazën, se lambadhja ime m'u shua; ene ata do përgjigjen e të thoon: kemi friik se na mehet, po shko e blii atje ke shesin. Ene ti tye qamun do shkosh të kërkojsh voj, e z'do gjeesh të bleejsh sepse u prish panagjyri ksaj jeete . . .

Këtë dhidhaqi e ka nxjeerr Shën Efremi. Un Papa Partheni e kam shkrumun këtë kaart në Shkurt dit 6, seneja 1878.

11) Arkiva e Institutit ka edhe një sasi dorëshkrimesh të tjera shqipe me alfabetin e Todhrit, shumica në gjëndje shum të keqe dhe që duken shum të vjetra. Janë grumbulluar m' Nr. 5212. Munt të ketë në mes tyre shkrime të Papa Parthenit dhe të nonjë tjetri që përmëndëm. Gjindet sidomos nër to një fletë shum e vjetëruar, me përkthimin e dy fabulave t'Ezopit — e dyta e pambaruar. Përkthyesi e ka shkruar fabulën në tri gjuhë, në tri rrjeshta konsekutive. greqishte të vjetër, greqishte të re dhe shqip me alfabetin e Todhrit. Përkthimi është tepër i dobët dhe literal (23). Interesi i vërtetë i kësaj fletë, mendojmë, është se na dëshmon ndofta që shkrimi shqip së lashti nuk u përdor vetëm për të kthyer librat fetare n'Elbasan, po edhe për fëmijët në shkollë. Ja një gjurmë e shkollës shqipe që munt të ketë mbajtur Todhri n'Elbasan ose Sh. Jon. Ish zakoni që pranë kishave dhe manastireve të kishte shkolla së lashti.

12) Një dorëshkrim me alfabet të Todhrit dyshojmë të gji-

23) PEKMEZI ka botuar një faksimile të një faqeje nga këto pralla. Ai ka patur edhe disa dorëshkrime këngësh fetare me të tri rrjeshtat konsekutive, gjë që e paska bërë të përfundojë se alfabeti i Todhrit është një kursiv grek i sh. XVIII, sipas revistës *Dituria*, Tiranë 1926, f. 3.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SH K O D E R

ndet edhe në Bibliotekën Kombëtare, i lidhur brënda një libri greqisht. Duhet kërkuar (24).

13) Përfundim. I datuar, shkrimi shqip me alfabetin e Todhrit nis n'Elbasan më 1797-98, me tregtarët Popa, duke vazhduar më 1800-28. Nuk dimë se kur zuri rrënjë në Sh. Jon, ku igumen Haxhi Josifi, që kopjoi *Liturgjinë* e Dhaskalit, jeton në vitet 1830-52. Më 1834, tregtari elbasanas Mimë Bibaja nënshkruan me alfabetin e Todhrit (Nr. 5212). Brënda viteve 1836-60, një tjetër tregtar elbasanas, Kostandin Andoni, nënshkruan kurdoherë shqip n'aktet e shumta që kemi të firmuara prej tij (Nr. 5001, 5002, 5213). Në vitet 1844-52, tregtari elbasanas Tupe i mban hesapet e tij shqip me alfabetin e Todhrit, dhe asnjëherë greqisht. Papa Partheni gjithë po kështu i bën përkthimet e tij më 1878. Shkrimi shqip me atë alfabet këndohej dhe përdorej edhe prej dy murgeshash të Sh. Jonit gjer më 1933-36. Këto janë gjurmat që kemi, gjatë më se një shekulli, për shkrimin shqip n'Elbasan dhe Sh. Jon me alfabetin e Todhrit. Përveç kësaj, këtu kemi edhe njerës që shkruajnë shqip me alfabetin grek — pa vënë në hesap Kristoforidhin (25).

Nga gjithë dokumentet e mësipërme, duket qartë se Elbasani është, gjer më sot, vëndi ku dimë të jetë përdorur më shumë shkrimi i shqipes, që nga fundi i shekullit XVIII e këndej (26).

Për sa u takon alfabeteve origjinale që gjejmë në shkrimet e Elbasanit, ai i Anonimit dhe ai i Todhrit, le të shënojmë se në shekullin e XVIII kemi edhe një tjetër alfabet origjinal, i cili gjindet te kondiku beratas që mban shkrimet shqipe të Kostë Beratit: me këtë janë shkruar vetëm dy rrjeshta në kondikt, po shkrimi është aq i sigurtë, sa të bën të mendosh se ai alfabet

24) Dorëshkrimi ka qënë i Lirak Dodbibës, pastaj i Luvro Skëndos. L. Dodbiba ka edhe një tjetër dorëshkrim shqip me alfabetin e Todhrit, që ka mbajtur datën 1897, po që është shuar sot. Duket të jetë kopje e një dorëshkrimi më të vjetër.

25) Me Nr. 5209, Arkiva e Institutit ka një copë shkrimi fetar shqip me shkronja greke, që mban emërin e Artem Ieromonakut, klerik i Sh. Jonit në pjesën e dytë të sh. XIX (Nr. 5110).

26) Duhet kërkuar edhe për shkrimin shqip nër qytete të tjera. Për shembull, Osman Myderrizi ka një letër private, të një tregtari shkodran të fillimit të sh. XIX, me shkronjat latine që kanë përdorur shkrimtarët e veriut, përzjerë me nonjë shkronjë sllave ose origjinale. Duhet parë në Berat, ku nuk mungojnë dokumentet e vjetra.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ka qënë përdorur rëndom, të pakën prej dorës që e shkroi. Edhe ky alfabet ka lidhje me atë glagolitik më shum se me atë grek. Nërsa Guiseppe Crispi na bën fjalë për një alfabet origjinal kishëtar, që duket se paska ekzistuar nër arbëreshët e Italisë (27), Hahn-i na dëshmon se edhe në Gjinokastër ka qënë përdorur një alfabet origjinal. Edhe këta të dy alfabete janë të sh. XVIII ose të fillimit të sh. XIX. Pra kemi pesë alfabete origjinale thuaj se bashkëkohëse, gjë që dëshmon mirë për aktivitetin e math që duhet të jetë bërë në lëmën e shkrimit shqip ahere. Prej kësaj përpjekje ne njohim sot disa auktorë. Pa dyshim ka patur edhe të tjerë, për të cilët duhet kërkuar, në kishat dhe manastiret tona një herë, nër arkivat tona private, pastaj edhe nër vise të huaja, posaçërisht atje ku shtegtonin ose ishin vendosur tregtarët shqiptarë, si në Trieshtë e Venedik, në Budapest e në Vienë, nëpër qytetet e Polonisë, Rumanisë, Bulgarisë, në manastiret e Malit të Shenjtë, në Sh. Naum t'Ohrisë, në këtë qytet vetë etj. (28).

Pa dyshim, këto përpjekje nuk janë të shkëputura nga rezistenca e ortodoksëve shqiptarë kundër kishës greke të Stambollit, aleate e sunduesit otoman. Ato bëjnë pjesë në lëvizjen nacionale të kohës dhe kuptohen vetëm në kuadrin e kësaj lëvizje. Prej tyre, suksesin më të gjatë e pat përpjekja e Todhrit për të kthyer kishën shqip. Pas tij, Elbasani, me manastirin e Sh. Jonit, u bënë qendra t'aktivitetit të shkrimit shqip, që lulëzoi pak edhe në Voskopojë në sh. XVIII dhe, më shum se në Voskopojë ndofta, në Berat. Në se pranojmë se Anonimi i Elbasanit është m'i vjetër se viti 1767, ahere lint pyetja në se në Voskopojë shkrimi i shqipes vajti nga qytete si Elbasani dhe Berati dhe nuk nisi tamam atje, siç është zakoni të thuhet. Dhe

27) G. CRISPI: *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo 1831, f. 3-4 nota.

28) Në sh. XIX kemi alfabetin origjinal të Vegilharshit (1844), i cili nuk është pa lidhje me alfabetin glagolitik. Pastaj, atë të Hoxha Tahsimit, të cilin s'e njohim. Arkiva e Institutit ka një alfabet të shtypur më një fletë volante, titulluar *Alphabet méthodique albanais*, kriluar para alfabetit të Stambollit të vitit 1879. Prapa, fleta mban një shënim turqisht me kalem, ku vihen si krijestarë të këtij alfabeti Vaso Pasha, Abdyl Frashëri dhe Hoxha Tahsimi etj. Alfabeti ka qenë pra inspiruar nga Hoxha Tahsimi. Një frazë shqipe që është shkruar me të, ka gjuhën e Vaso Pashës, shkodranishten. Dihet se, para se të pranohej alfabeti i Stambollit, shum shkrimtarë dhe patriotë të kohës deshën një alfabet origjinal. Në mes tyre, Mitkua kërkonte alfabetin e Todhrit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKENCORE

një gjë e tillë është e natyrëshme, sepse Voskopoja ka qënë e populluar kryesisht prej vllehësh. Më tjetër anë, fjalorthet poliglosë të Kavaliotit dhe të Dhanilit kanë patur më shum për qëllim t'u mësojnë të tjerëve greqishten, gjuhën me të cilën janë botuar librat e Voskopojës dhe me të cilën punonte shkolla *Akademia è re* e atij qyteti, se sa t'u mësojnë shqipen, vllahishten apo bullgarishten. Fillimi i të shkruarit të gjuhës sonë në Shqipëri të mesme dhe të jugës, do kërkuar më shum n'Elbasan, Berat dhe gjetiu, si fjala vjen në Himarë, ku i kemi gjetur gjurmën, etj. (29).

III.

Le të shënojmë së fundit edhe disa gjëra mi Todhrin, që kemi mundur të gjejmë duke kërkuar me këtë rast për Anonimin dhe të tjerët.

1) Problem për Dhaskalin është saktësimi i datave të lindjes dhe vdekjes. N'Elbasan thuhet se ai vdiq fare i ri, dyzet vjeç. Po me sa kemi gjurmuar ne, përkundrazi, Todhri duket të ketë vdekur fort i motuar, pranë të tetëdhjetave.

Sipas disa shënimeve që ka Arkiva e Institutit nga L. Nosi, dora e Dhaskalit nis të duket në kondikun e Esnafit t' argjendarëve t'Elbasanit më 1750 (f. 129 e kondikut), pastaj zhduket për një kohë të gjatë dhe gjindet prap në vitet 1801-5. Gjurma e fundit n'atë kondik është më 21 Maj 1805 (f. 131, sipas Nr. 5151). Kjo është edhe data e fundit që gjejmë Todhrin. Ne vetë s'kemi mundur ta shohim atë kondik, sepse nuk e ka Arkiva, po kemi kërkuar në një kondik të Sh. Marisë së lagjes Kala t'Elbasanit (Nr. 5207). Aty, për herë të parë dora e Todhrit duket më 1751 (f. 42), pastaj në vitet 1761, 1768 (f. 149, 158). Nërsa për datën 1751 s' jemi kaqë të sigurtë, sepse Dhaskali ka nënshkruar vetëm me emërin Theodhor («Kagò o Theòdhoros martirùmen»), për të tjerat jemi të sigurtë, sepse gjejmë emërin e tij të plotë («Theodhoros tu Haxhi»). Që të ketë qënë 20-25 vjeç më 1750-60, Todhri duhet të ketë lindur në mes viteve 1725-40. Ai i ka njohur pra vitet e fundit të përleshjes në mes dy Patriarkateve. Në një tjetër kondik të Sh.

29) V. shënimin 12.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
I MIRËNJOHJES
S H K O D ËR

Marisë s'Elbasanit, dora e Todhrit gjindet edhe më shpesh: 1761, 65, 69, 81, 83, 84, 85, 86, 90, 1801 (Nr. 5113).

Sa për datën e vdekjes së tij rreth vitin 1805, ne s'kemi mundur të gjejmë vetë asgjë nëpër kondiket. Po më 1806, n'Elbasan gjejmë një tjetër dhaskal, të quajtur Dhimitër (Nr. 5207, f. 117). Më vonë pastaj, më 1812, dhaskal është një farë Argjiri, nip i dhespotit të Durrsit, Samuil Gonohorri, grek (Nr. 5176). Lagjeja s'ka mundur ta zëvendësojë Todhrin me një dhaskal të ri, më 1806, po të qe ky gjallë. Pra vitet 1805-6 duhen marrë si datat më të sigurta të vdekjes së Todhrit. Tani ai ka qënë 65-80 vjeç, pra edhe në pragun e vdekjes.

Mirëpo gojëdhana thotë se Todhri e gjet vdekjen në Xhyrë të Babjes, duke sjellur n'Elbasan barrët me shkronja që kish derdhur në Rusi dhe që do t' i dërgonte pastaj në Voskopojë. Prap ed lie gojëdhana thotë se i vëllai, Jakovi, vajti dhe e konstatoi në vënt vdekjen. Thuhet se e vranë kolarët vlleh se pandyen mos kish flori nër ato barrë të rënda. Ky, pa dyshim, është një spiegim që u dha për vrasjen. Po në se vrasja ngjau, më mirë është të mendojmë se këtë e bënë ata që s' ishin t' interesuar që të shkruhej dhe të shtypej shqipja, d.m.th. kleri grek dhe Turqia. Sidoqoftë, dhaskali i shkretë në pleqëri të shkuar ia arriti qëllimit që të derdhë shkronjat e tij. Po të pranojmë se shkrimi i tij nisi të përhapet n'Elbasan vetëm në funt të sh. XVIII, një gjë e tillë spiegohet: munt që vetëm ahere ai gjeti një mbështetje materiale dhe morale për të krijuar një shtypshkronjë shqipe, nër tregtarët elbasanas që përdorën alfabetin e tij.

2) Gojëdhana thotë se Todhri studioi në Voskopojë, n'*Akademinë e re*, që u hap më 1744. Mësuesit e para i bëri n'Elbasan, në shkollën greqishte, për të cilën kemi dëshmi se ekziston që nga viti 1736 (Nr. 5112, kondik i Sh. Marisë. f. 58-64), po që nuk do të thotë se ahere u krijua për herë të parë. Mësues i kësaj shkolle u bë vetë Dhaskali më vonë. Për shkollën flitet në të njëjtin kondik në vitet 1763, 69, 70-71.

Më 20 Korrik 1784, Todhri ka marrë «testir» (leje ushtrimi zanati që epnin esnafët) te gëzerçit (Nr. 5177, kondik i Esnafit të gëzofçive t'Elbasanit). A mos gjer ahere nuk është bërë prift, siç duket të ketë qënë kur shërbeu në Sh. Jon? Nëpër kondiket e esnafeve shohim që edhe priftërinjt marrin «testir». Po gjer më 1779 të pakën, Todhri nuk duket të ketë qënë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

prift, me sa kuptohet nga një dokument i botuar nga mitropolit Aleksudhi i Beratit (30). Ky dokument ka qënë nënshkruar një herë nga pesë klerikë të ndryshëm, në mes të cilëve edhe Theodhor Kavalioti, të cilëve, përpara emërit, u ka qënë vënë nga një kryq që tregon se ishin klerikë. Pastaj nënshkruajnë Todhri dhe një farë Vreto Kostantini, të cilëve emëri nuk u fillon me nga një kryq. Në se Todhri vajti në Sh. Jon si igumen, kjo duhet të ketë ngjarë pra pas vitit 1779.

Gojëdhana thotë se Todhri qe martuar, po u nda shpejt me të shoqen dhe nuk la fëmijë. Kjo nuk duket të jetë e vërtetë. Në të njëjtin kondik t'Esnafit të gëzofçive, gjejmë se një farë »bir i Theodhor Dhaskalit», Joani, ka marrë «testir» më 1789. Është thënë se Todhri nuk munt të shërbente si igumen në Sh. Jon po të qe i martuar (31). Po në se ai u nda herët nga e shoqja, kjo nuk e pengonte të bëhej klerik. Fakti që edhe më 1789 Todhri quhet «dhaskal» duket të tregojë se gjer ahere nuk qe dorëzuar prift, nuk ish vendosur në Sh. Jon si i tillë. Ka të ngjarë që shkrimi shqip në këtë manastir, me alfabetin e Todhrit, të jetë zhvilluar më vonë, pasi ai u vendos atje dhe bëri dishepuj.

3) Hahn-i dëshmon se ka dëgjuar n'Elbasan që Todhri ta kish sjellë alfabetin e tij nga një tjetër vënt, të mos e kishte shpikur vetë pra (32). Sipas Papa Parthenit, ai e solli nga Voskopoja (33). Po këtë gjë na dëshmon edhe Kristoforidhi në një copë dorëshkrimi të tij greqisht që ka Arkiva e Institutit (Nr. 5136). Gjithë po Kristoforidhi na dëshmon se alfabeti i Todhrit përdorej edhe në disa katunde përreth Elbasanit, kurse sipas Hahn-it ai përdorej edhe në Berat. Me këto katunde, ndofta Kristoforidhi kupton Sh. Jonin dhe Përmishijonin. Elbasani ka pranë katundet ortodokse të Shpatit, në Jugë të Shkumbinit, dhe nja dy katunde të vogla pranë Sh. Jonit, Fikas dhe Bradashesh.

4) Sipas gojëdhanës, shkrimet e Todhrit i dogji fare ai i tij, me rasin që u ra murtaja në shtëpi: superstcioni i vëndit atyre ua mveshi fajin e kësaj fatkeqësie. Këtë na e dëshmon edhe Hahn-i. Pa dyshim, kleri grek dhe grekofil ka pasur gisht në këtë çështje. Shkatërrimi i shkrimeve të Todhrit duhet të këtë

30) V. shënimin 4.

31) I. M. Qafëzezi: *Th. Kavalioti dhe Dh. Todhra Haxhifilippidhi*, në Përpjekja Shqiptare, Tiranë 1937, f. 250.

32) HAHN, f. 37. KURILLA na dëshmon se (sipas ZAFIRAS: *Néa Ellás*, Athinë 1872, f. 236) tipografi i Voskopojës, Grigor Konstantinidhi, paska shpikur një alfabet origjinal shqip (f. 255). Pra bëhet vetvetiu hipoteza se mos është ky alfabeti që Dhaskali paske sjellë nga Voskopoja. Sipas KURILLËS, Grigori i mësipërmë paske qënë durrsak. Pra dhe një tjetër shenjë që një jo-voskopojar krijon një alfabet origjinal shqip para Todhrit, mbase alfabetin që do të përdorë ky.

33) PEKMEZI, f. 43.

BIBLIOTEKA PUBLIKE E SHTETIT

ngjarë më 1827. Atë vit, më 13 Qershor, ra murtaja në shtëpi të Jan Jakov Haxhiut, nipit të Todhrit nga i vëllai, dhe Jani u shua, duke vdekur e bija Dije, Prendi djali i së shoqes, ai vetë dhe së fundit e shoqja (Nr. 5092, *Fjalorthi* i Simonit, f.13). Kjo ka qënë, pa dyshim, një fatkeqësi e madhe për shkrimin shqip n'Elbasan në shekullin e kaluar, sepse duhet të jenë djegur shumica e shkrimeve të Todhrit, dhe kleri grek dhe filogrek të ketë triumfuar dhe ta ketë persekutuar edhe më shum pastaj shkrimin e shqipes (34), që tani do të ketë si qendër më të sigurtë, po të veçuar, Sh. Jonin.

5) Për ata që do ta ndjekin çështjen e Todhrit, le të shënojmë së fundi se, nër kondikët e Elbasanit, gjinden edhe dy emëra të tjerë që munt të përzjehen lehtë me të tijin dhe të lindin gabime: një Haxhi Filip, prift elbasanas i sh. XVIII, dhe një Filip Haxhi Jakovi, i cili jeton në fillim të sh. XIX. Ky i fundit duket të ketë qënë fis i Todhrit, nonjë nip i tij, mbase nga i vëllai, që duket dhe ai të ketë qënë haxhi. Sot familja Haxhijakovi e Elbasanit e njeh vehten se rjeth nga Todhri dhe i vëllai i këtij.

RÉSUMÉ

Janvier dernier fut découvert, dans les archives de notre Institut des Sciences, un ancien manuscrit albanais, écrit en un alphabet inconnu dans l'histoire de notre langue, et contenant quelques traductions assez libres des Evangiles. Dans cet article, l'auteur, Dhimitër Shuteriqi, qui a découvert le manuscrit, émet l'hypothèse qu'il est l'oeuvre d'un ecclésiastique originaire d'Elbasan ou du monastère de St. Jean Vladimir, situé aux environs de cette ville. En effet le manuscrit a été trouvé parmi d'autres documents albanais provenant de ces lieux; à la base de son alphabet se trouve l'alphabet slave, et, jusqu'en 1767, les orthodoxes d'Elbasan dépendaient du Patriarcat Bulgare d'Ochrida; la langue du texte se présente être le sous-dialecte guègue d'Elbasan, assez mélangé avec le dialecte tosque, son voisin. Shuteriqi est de l'avis que ce manuscrit est antérieur a l'année 1767, surtout parce que sa langue est plus archaïque que celle de Maître Théodore, un autre auteur d'Elbasan, qui, selon lui, aurait vécu approximativement pendant les années 1725-1805.

Dans la deuxième partie de l'article sont décrits brièvement les anciens textes albanais d'Elbasan que possèdent nos archives et dont la plupart sont écrits dans l'alphabet de Théodore. Dans la troisième partie, l'auteur donne quelques précisions sur la vie de Théodore, d'après les anciens recueils d'Elbasan qui se trouvent dans nos archives.

34) Në fillim të sh. XIX, n' Elbasan, ka patur mos-marrëveshtje të forta me mitropolitët e Durrsit, Gjerasimin dhe Anthimin. I pari u detyrua të largohet për një mot nga Elbasani, kurse për të dytin mbahet mënt ta ketë mallkuar populli «me qiri të zezë».

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

DISA SHËNIME RRETH ALFABETIT TË DORËSHKRIMIT TË ANONIMIT ELBASANAS

Prof. INJAC ZAMPUTTI

Në pasqyrën alfabetike që kemi nxjerrë nga leximi integral i dorëshkrimit t' auktorit anonim, zbulue n' Arkivën e Institutit të Shkencave ditët e para të këtij viti 1949, do të vrehet :

1) Se nuk asht fjala për germa të mëdha dhe të vogëla :

2) Se shumica e germavet kanë trajtë të preme dhe unike, dhe si të tilla përdoren vazhdimisht që nga faqja e parë e deri në fund. Por ka edhe përjashtime.

Për sa i përket pikës së parë, do të shtojmë se shkruesi, vetëm në rastin kur e përdor si inicjale, e shkruen shenjin e germës x me proporcjone ma të mëdha dhe me kujdes ma të madh. Pra, kur të vrehet mirë, inicjalja nuk asht tjetër veç se germa e zakonshme e smadhueme dhe e zbukurueme.

Për sa i përket pikës së dytë, do të vrehet se ka edhe disa germa që — ose për pasiguri të hartuesit o të shkruesit, ose për ndonjë rast të veçantë fonetik (e këtë do ta thonë studimet e mâtejshme) — nuk përdoren gjithënjë me të njajtin shenj dhe kanë prandej varjante të ndryshme. Në pasqyrën që kemi hartue, kemi vumë korrispondentet e germës s'alfabetit të soçëm atë shenj t' alfabetit të tekstit që asht ma i zakonshmi, dhe varjantet relative i kemi vumë fill mbas me shënimet 1), 2), 3)... që kështu, në këto vrejtje që po bajmë, të mund t' i gjejmë në pasqyrë shenjat për të cilët flasim, mbasi nuk kemi mundësi t' i riprodhojmë sa herë që na duhet me i xanë në gojë.

Germa g — Ma e para germë që na del me varjante, asht germa g.

Shenji i parë e kryesor i kësaj germe asht ai që përdoret dendun kudo që nevojitet. Por në fjalën *igemoni*, në vend të germës *g* të zakonshme, përdor germën *g*, e këtë e ban ndoshta për t' i dhanë tingullin e veçantë që ka germa *g* e ndjekun prej *e*-s në greqishtet. Gjithashtu, në fjalën *magdhalinë* të fq. 14 radha 9 dhe po n' atë fjalë të fq. 53 radha 7 në vend të *g*-s së zakonshme, ka respektivisht g^2) g^6). Në këto rastet e fundit duket një varjante e kotë sepse po në fjalën magdhalinë të faqevet tjera germa *g* asht e shkrueme si zakonisht.

Germa h — Në trajtën e saj të parë përdoret dendun kudo

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

që nevojitet. Në trajtën që ne e kemi shkrue përbri grupit *ch*, përdoret në fjalën *christ* (por ka raste edhe kur fjala asht shkrue *hrist*); përdoret në fjalën *të chekunit* (të hekunit) të fq. 9 radha 14; *ngozhdochi* të fq. 13 rradha 16; *bachi* (bahi) të fq. 32 rradha 2, 57 rradha 16; *kocho* (koho) të fq. 38, 39 etj. Prej disave nga këta shembuj (bachi, kocho etj.) të cilët jashtëzakonisht gjënden në këtë grafi pse dendun shkruhen *bahi*, *koho* etj., nxieret se shenji *ch* ka një tingull ndërmjet *h* dhe *k* dhe se shkruesi nuk e ka gjithkund të sigurt tingullin.

Germa i — Në shenjin e parë përdoret vazhdimisht. Por në fq. 18, në radhën e 5-të në fjalën *ishin*, i-ja e dytë asht me shenjin *i*[1]). Edhe mbasandej, aty-këtu mundohet ta qesë kryet ky shenj, por dendun përdoret shenji kryesor.

Germa n — Gjithkund përdoret në shenjin e saj kryesor. Shenji *n*[1]) ka për t' u ndeshë ndonjë herë ndër grupe, si do të shohim ma poshtë, por në vedi kurr. Krejt jashtëzakonisht, e, më si duket për një gabim shkrimi ose një shtojcë e kotë, në fq. 12 rradhë 15 ka fjalën *nu* (un, u ?) në të cilën germa *n* asht me shenjin *n*[1]).

Germa x — Duket se shkruesi (njëkohësisht edhe përpiluesi i alfabetit (?) ka bamë përpjekje për ta kërkuem shenjin për tingullin e kësaj germe. Ndërsa shkruen *zamë* etj., në faqen 38 shkruen *ncerënë*, në fq. 39 *ncirnite*, në fq. 41 *ncinte* (për nxerënë, nxirnite, nxinte), ja se në fq. 48 del shenji i *x*-it në fjalën *xveshnë*. Pastaj shenji i *x*-it duket në grup me *c* në fjalën *xcjerrë* (për nxjerrë). Në faqen 58 në rradhën 16 kemi *nxuarrë*, e cila fjalë një herë duket se asht shkruem *ncuarrë* dhe përmbi *c* dora e shkruesit, tue e korrektue, ka vumë shenjin e *x*-it. Po n' atë faqe, prap me një korrektim të lehtë, në rradhën e 17-të përdoret shenji i *x*-it në fjalën *xuarrë*.

Germa xh — Mungon. Nuk asht ndeshë ndonjë fjalë që të ketë këtë germë. Edhe në fjalën *tjegulluxhvet* (fq. 46 rradha (5-6) aty ku mund t' ishte *xh* asht (i mesdhëse pak ndryshej prej shenjit të zakonshëm por jo një sa me t' u dukë shenj tjetër.)

(Besoj se as nuk mund të quhet varjantë por një rrshqitje dore një shenj, pak i ndryshëm nga i zakonshmi, n' e-n e rradhës 4 në fq. 16).

Grupi nd — Në pjesën e parë të dorëshkrimit, d.m.th. në copën e prozës së fjalimit kishtar, ky grup asht vazhdimisht i

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

kombinuem me *n* dhe *d* të zakonshme. Në pjesën e dytë, d. m. th. në copat e përkëthyeme nga ungjijt, del menjëherë grupi *nd* [1]) në të cilin gërma *n* ka shenjin e veçatë n^1), por nuk zhduket definitivisht grupi *nd* me *n* të zakonshme. Interesant me shikue se disa heresh, edhe n' inicjale, përdorë shenjin djakritik *d* me një pikë (nd^2).

Grupi ng — Në këtë grup germa *n* ndjekë po atë varjacion si në grupin *nd*.

Grupi ngj — Ndërsa në ma të shumtat e rastevet përdoret kudo germa *gj* (gjitun, gjoftë etj.), del edhe grupi *ngj* në fq. 35, 36 në fjalët engjëlli; engjitë e në fq. 38 në fjalën ngjallnjënë.

Dhe ja tani riprodhimi i njëj faqe të tekstit me transkriptimin relativ përbri.

qun i qëronite· djemënitë
e nelrnite· dhunëti muartë
(dh)unëti epnite: ———
shënëdréut· ioan·
Nd atë kócho· mbet ioàni· ede
të psuamt e tij du· e shófënë
jisùnë ke ècënte, thotë· shëko
ni qenjn e perëndisë· e nëgjù
anë të dy të psuamit ke thòsh-te
u ngjitnë me jisunë· u kthù
e jisùci e shëkon ata qi u
ngjit me tà· i thotë atyne
kë kërkòni· i thonë ata·
ravi· qi do të thotë dëftë
is· ku jet: thotë atùne· e
ni shifni e vonë e panë

RÉSUMÉ

L' alphabet de ce manuscrit, découvert dans les archives historiques de l' Institut des Sciences sous le Nr. 5093, était inconnu jusqu' à présent par les studieux. Dans le paradigme reproduit dans le présent numéro du Bulletin on peut voir les types de lettres emplyées et on peut faire une comparaison avec d' autres alphabets. L' auteur n' emploie pas des majuscules et des minuscules, toutes les lettres son identiques, sauf pour les initiales, qui sont de dimensions plus grandes et mieux présentées, mais sans changement de forme. Pour certaines lettres et certains groupes de lettres à pronociation particulière, l' auteur n' est pas toujours sûr, mais en général on voit qu' il s' agit d' une personne habituée à écrire avec cet alphabet. Nous reproduisons une page de ce texte avec la transcription relative.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI"

TERMINOLOGJIA E MATEMATIKËS

Po botojmë sot terminologjin' e landëvet shkollore tue fillue nga ajo e matematikës. Seksioni i Gjuhësisë e i Letërsisë me anë komisionesh prej profesorësh të posaçëm të çdo lande mësimi i âsht vû punës si termi ologjisë shkollore si edhe asaj administrative qysh në vitin e kaluem. Për caktimin e çdo termi âsht marrë para sysh përdorimi i maparshëm i tij nëpër shkollat, por aty ku nuk dukej i posaçëm ndonji term âsht krijue nji tjetër m â i përshtatshëm. Termat me origjinë greke e latine, si termat *hyperbole, symetrie, aksiome, postulat*, etj. që janë bâ, si me thanë ndërkombëtare, janë mbajtë edhe në gjuhët tona, por tue i u-përshtatë fonetikës së saj. Gji hashtu janë mbajtë edhe ato terma origjine latine, si *ekuacion, tangjente, inversion*, etj, që nuk mund të përktheheshin nga brumi i gjuhës sonë e që janë ruejtë edhe në gjuhët e tjera të pasuna, si në rusishtet e në gjermanishtet. Kështu âsht veprue edhe për termat e landëvet të tjera shkollore, që do të botohen me radhë në këtë Buletin.

Veçse janë të lutun gjith'ata profesorë që nuk kanë marrë pjesë ndër komisjone e që e kanë landën e vet matematikën me na shfaqë me shkrim mendimin e tyne mbi ndonji term, që u duket se do t'ishte mirë të caktohej ndryshe, si edhe mbi caktimi i e ndonji termi që mund të jetë lanë metë e nuk figuron ndër termat e tjerë. Me nji të tillë bashkëpunim terminologjia do të caktohet e do të zâjë vend mâ mirë.

abscisse	=	abshisë-a
accollade	=	kllapë e përdredhme
accroissement	=	shtesë
aire	=	syprinë-a
aire latérale	=	syprin' e a ësnme
alliage	=	lidhje
amortissement	=	amortizim
angle	=	kand i kande-t a kënd-i, kënde-t
angles adjacents	=	kande të përbrijëshme
angles adjacents supplementaires	=	kande të bashkëpështetuna
angle aigu	=	kand i mbyllët
angles alternes	=	kande të tjetëranëshme

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

angle au central = kand qendror
angle complémentaire = kand plotësuese
angles correspondants = kande përgjegjëse
angle de depression = kand i uljes
angle d' élevation = kand i ngritjes
angle de 180° = kand i shtrimë
angle de 360° = kand i plotë
angle droit = kand i drejtë
angle inscrit dans un cercle = kand periferik
angles internes au externes d'une même côté = kande të njianëshme të mbr ndëshme e të jashtme.
angle obtus = kand i hapët
angles opposés par le sommet = kande të kundërta në kulm
angle supplémentaire = kand shtimtar
anneau = u azë-a
annuité = përvjetësi, anuitet
annuler = anuloj
antipériode = antiperiodë-a
apothéme = apotemë
application = zbatim
appliquer = me zbatue
arc = hark u, harqe-t
arc = ar-i
arrangement = dispozicion, rallhitje
artifice de calcul = njehsim i goditun ose mjeshtëri jehsimi
asymptote = asimptotë-a
axe = bosht-i
axe de rotation = bosht rrotullimi
axe imaginaire = bosht imagjinar
axe orienté = bosht i drejtuem
axe radicale = bosht radikal
axe réel = bosht real
axiome = aksiomë

base = themel
bicarré = bikuadrat, dykatrore
binome = binom-i
bisectrice = përgjysmore-ja

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

branche	=	krah·u (i lakores)
calcul	=	njehsim
calculer	=	njehsoj
calcul différential	=	njehsim diferencial
calcul integral	=	njehsim integral
calotte spherique	=	kësulë sferike
capital	=	kapital-i (krenë-t)
capitalisation composée	=	kapitalizim i ngjizun
caracteristique	=	karakteristikë-a
carré	=	katror-i, katrorë-t
cas de similitude	=	rasë përgjasimi
cathete	=	katet-i
centaines	=	qindshe
centiare	=	centiar
centimetre	=	centimetër-i cm.
centre de symetrie	=	qendër sim·trie
centre d'homothésie	=	qendra e homotesisë
champ des nombres	=	lama e numravet
chiffre	=	shifër-a
cercle	=	rrotullë-a
cercle circonscrit	=	rrotull e rrethshkrueme
cercles concentriques	=	rrotullë bashkëqendrore
cercles eccentriques	=	rrotullë jashtëqendrore
cercle exinscrit	=	rrotull' e anëshkrueme
cercle inscrit	=	rrotull' e mbrëndashkrueme
cilindre	=	cilindër, shul
circonférence	=	rreth-i, rrethe-t
classe	=	klasë
coefficient angulaire	=	koeficient kandor
coheficient	=	koeficient-i
coincidence	=	puqje
coincider	=	me u·puqë
combination	=	kombinacion
comensurable	=	i matshëm
composante	=	komponente-ja
concave	=	lugor
congruence (égalité)	=	puthisje-a (barasi-a)
congruent (égal)	=	(i, e) puthitshëm
conjugué	=	i bashkëlidhun
conséquence	=	pasojë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KORÇË

constant	=	konstant i
constante d'intégration	=	konstantja e integrimit
construction	=	ndërtim
continu	=	i vijueshëm
continuité	=	vijueshmi-a
contour (polygonale)	=	rrethinë (poligonale)
convexe (polygone)	=	kurrizor
coordonnées	=	koordinatë t
coordonné orthogonale	=	koordinatë ortogonale
coordonné polaire	=	koordinatë polare
corde	=	kordhë-a
corolaire	=	rrjedhim-i
consecante (cosec)	=	konsekante-ja (cosec = kosek.)
cosinus	=	kosinus-i
courbure	=	lakesë-a
courbe	=	lakore-ja
courbe croissante	=	lakore ngjitëse
courbe decroissante	=	lakore zbritëse
cotangeante (cotg)	=	kotangjente (cotg = kotg.)
côte	=	brinjë
crochet	=	kllapë katrore: []
curviligne	=	vijëpërkulët
décalitre	=	dekalitër-i = Dl.
décametre	=	dekametër-i — Dm.
décilitre	=	decilitër-i = dl.
décimetre	=	decimetër-i = dcm.
décomposer	=	me zbërthye
décomposition	=	zbërthim
définition	=	përkufizim
degré	=	shkallë
démontrer (une théoreme)	=	demontroj (një teoremë)
deplacement	=	çvendosje
dérivation	=	derivim
derivé de premier ordre	=	derivat i radhës së parë
derivée	=	rrjedhës-i (derivat-i)
dériver	=	me derivue
déterminante	=	determinant-i
détermination	=	përcaktim-i
determiné	=	i përcaktuem
diagonale	=	diagonale-ja

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

diametre	=	diametër-i
diametres conjugués	=	diametra të bashkëlidhuna
diédre	=	dyfaqësh-i
differentielle	=	diferencial-i
différence	=	ndryshim-i
differentiation	=	diferencim
differentier	=	me diferencue
direction	=	drejtim-i
discontinu	=	i pavijueshëm
discontinuité	=	pavijueshmi-a
discriminant	=	diskriminant-i
discussion	=	shoshitje
distance	=	largesë-a
distance centrale	=	largesë qendrore
divident	=	i pjesëtueshmi
diviseur	=	pjesëtuesi ase pjesëtonjësi
le plus grand diviseur commun	=	pjesëtuesi ma i madh i përbashkët
diviser par	=	daj për
division	=	ndarje, pjesëtim
division centécimale	=	ndarje qindore
division harmonique	=	ndarje harmonike
division proportionnelle	=	ndarje e përpjesëshme
division sexagérimale	=	ndarje gjashtdhjetore
la) droite	=	drejtëzë-a
droites concourantes	=	drejtëza që kalojnë
dizaines	=	dhjetshe
échéance	=	ditë pagese
egalité	=	barasi
élever à la puissane	=	me ngritë në fuqi
élimination	=	zhdukje
éliminer	=	me zhdukë
ellipse	=	elipsë-a
enumération	=	njefje numërim
énumérer	=	me njefë, me numërue
équation exponentielle	=	ekuacion eksponencial
equation réciproque	=	ekuacion reciprok
équations simultanées	=	ekuasione të njiherëshme
équilateral	=	(trekand) barabrijës, brijënjinjishëm

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

équivalence = njivleftësi
équivalent = (i, e) njivleftë
épure = trapisje
erreur = gabim
escompte = skont-i
exercisé = ushtrim
exposant = tregues, eksponent
expression algebrique = shprehje algjebrike
expression irrationnelle = shprehje irracionale
expression numérique = shprehje numërore
expression rationnelle = shprehje racionale
extremum = ekstrem-i

faisceau des droites = tufë drejtëzash
faisceau des rayons = tufë rrezesh
figure = figurë
figure circonscrite = figurë e rrethshkrueme
figures congruentes (égales) = figura të puthisëshme (të barabarta)
figures équivalentes = figura të njivlerëshme
figures homothetiques = figura homotetike
figure inscrite = figurë e mbrendashkrueme
figure symetrique = figurë simetrike
fonction circulaire = funksion rrethor
fonction composé = funksion i ngjizun
fonction croissante = funksion smadhues
fonction décroissante = funksion zvogëlues
fonction périodique = funksion periodik
fonction primitive = funksion primitiv
formes indeterminées = forma të pacaktueme
formulaire = formular
foyer = vatër, votër
fraction = thysë a
fraction complexe = thysë e pathjeshtë: $\frac{7}{3}$
fraction simple = thysë e thjeshtë: $\frac{2}{5}$
fraction apparente = thysë e dukëshme: $\frac{10}{5}$ $\frac{5}{5}$
frequence = frekuenc
fuseau spherique = dyaandësh sferik, drugë sferike

génératrice = përftore-ja
grade = gradë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

grandeur	=	madhësi
hauteur	=	lartësi, lartësi
hectare	=	hektar
hectometre	=	hektometër-i
homogénéité	=	homogjen
homologue	=	homolog-u
homothétie	=	homotesi-a
horizontale	=	horizontal-i -e-ja
hyperbole	=	hiperbolë-a
hypothenuse	=	hipotenuzë-a
hypothèse	=	hipotezë-a
identité	=	identitet
illimité	=	i pakufi
incliné	=	i, e pjerrët
inclinée	=	e prirtë-a
inconmensurable	=	i pamatshëm
indéterminé	=	i pap rcaktuem
indentique	=	identik
i dice	=	diftues-i
inegalité	=	pabarasi
inéquation	=	inekuacion
infini	=	i pafund, i pambarim
infiniment petit	=	i vogël pa fund
integral defini	=	integral i kufizuem
intégration	=	integrim
integral indéfini	=	integral i pakufizuem
intégrer	=	me integrue
intérêt	=	interesi (kamatë-a)
interpretation	=	zdritje
interpreter	=	me e zdritë
intersection	=	ndërprerje
intersection asciale	=	ndërprerje boshtore
intervalle	=	interval-i
inversion	=	inversion-i
(nombre) irracionel	=	(numër) irracional
isoscéle	=	(trekand) dybrinjënjinjishëm
latitude	=	gjanësi gjeografike
lemme	=	leme-a
lieu géometrique	=	vend gjeometrik
ligne	=	vijë-a

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARNBARLETI" SHKODËR

ligne brisée	=	vijë e thyem[illegible]
ligne courbe	=	vijë e la[illegible]ueme
ligne centrale	=	vijë qendrore
ligne de numeration	=	vijë e numravet
ligne de base	=	vijë e që[illegible]drimit
ligne directive	=	vijë drejtuese
ligne droite	—	vijë e drejtë
ligne de terre	=	vijë e tokës
ligne frontale	=	vijë [illegible]allsore
ligne inclinée	=	vijë e pjerrtë
ligne visuelle	=	vijë e shikimit
limite	=	kufi
longitude	=	gjatësi gjeografike
losange rhombe	=	romb-i
mantisse	=	mantisë-a
masse	=	masë-a truc-i shtëng-u
maximum	=	maximum-i
médiane	=	mesore-ja
mélange	=	përzierja
mesure	=	matje
mettre en facteur	=	me e nxjerrë në dukje ose me e bâ faktor
milliés	=	mijshe
minimum	=	minimum-i
minuend (nombre dont on soustrait)	=	i zbritshëm-i
monnaie	=	monedhë, monetë
monome	=	monom-i
montant	=	montant-i
monotonicité	=	veti e monotonisë
moins	-	minus-i
moyenne arithmetique	=	e mesmja aritmetike
moyenne géometrique	=	e mesmja gjeometrike
moyenne harmonique	=	e mesmja harmonike
moyenne proportionnelle	=	e mesmja e përpjesëshme
multiple	=	shumëfish
multiplier par	=	shumëzo-me
nombre	=	numër-i
nombre abstrait	=	numër abstrakt
nombre complexe	=	numër kompleks

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

nombres complexes conjugués = numra kompleksë të bashkëlidhun
nombre composé = numër i përziem: $1^2/_3$
nombre concret = numër konkret $1^3/_3$
nombre consecutif = numër pasardhës
nombre décimal = numër dhjetor
nombre entier = numër i tanë, i tërë, i plotë
nombre imaginaire = numër i magjinar
nombre impair = numër cub
nombres inverses = numra t'anasjelltë
nombre irrationnel = numër iracional
nombres naturels = numra të natyrshëm
nombre pair = numër parë
nombre périodique = numër periodik
nombre premier = numër prim
nombre rationnel = numër racional
nombre real = numër real
nombres successifs = numra të njimbasnjëshëm
la normale = normale-ja
notion = njohuni-a
nul = nul
numération écrite = numerim i shkruem
numération parlée = numerim i folun

obligation = detyrim ose përlim
oblique = (i, e) ojerrët, (i, e) kithët
opération = veprim-i
opérations inverses = veprime të kundërta
ordonnée = ordinatë-a
ordre = rend, radhë
origine = origjinë
orthocendre = ortoqëndër

parabole = parabolë-a
parallelogramme = paralelogram-i
perallelepipéde = paralelipiped-i
parenthèse = kllapë: ( )
pénétration = depërtim-i
pentagone = pesëkand-i
pente = pjerrsinë-a
perimetre = perimetër-i
période = periodë-a

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

permutation = permutacion
perpendiculaire = pero·idikulare-ja
perspective = perspe·tivë
pied = kambë
point d'inflexion = pikë kthimi
point d'intersection = pikë ·dëroremje
point limite = pi·të kufizore
point de rencontre = pikë takimi (tangjentja në pikë të rre·hit)
point de similitude = pikë përgjasimi
polaire = polar
pôle = pol-i
polyédre = shumëfaqës·i
polygone = shum·ka·d-i
polynome = polino·n-i
polynome complet = poli om i plotë
polynome entier = polinom i tanë
polynome ordonné = polinom i radhitun
position = gjendje
postulat = postulat-i
pour·cent = përqindje-a
plan = rrafsh-i. plan
plan de symétrie = pla·n simetrie
principe = parim
probabilité composée = probabilitet i përziem
probabilité totale = probabilitet i plotë
probleme = proble·m-i proble·më-a
projection = projektim
projetter = me projektue
proportion = përpjesëtim
proprieté associative = veti sho·ënuese
proprieté commutative = veti ndërruese
proprieté distributive = veti sh·ërdasc
proprieté reflexive = veti refleksive
proprieté tra·sitive = veti transitive
proprieté symétrique = veti simetrike
prouver la racine d'une équatio·n = provoj rranjën e nji ekuacioni
pyramide = piramid·-a
pyramide droite = piramide e drejtë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

pyramide inclinée = piramidë e pjerrët
pyramide irreguliere = piramidë e parregullt ë
pyramide regulière = piramidë e rregullt ë

quadrilataire = katërkand-i
quadrilataire inscriptible = katërkandësh i mbrendashkrue-shëm
quantités compléxes = sasi të bashkëlidhuna
quatrieme proportionnelle = e katërta e përpjesëshme
quotient = herës-i
quotien approché par excés = herësi i afërt me tepricë
quotien approché par défaut = herësi i afërt me të metë

rabat = zbritje-a
rabattement = rrëxim
racine = rranjë
racine approchée = rranjë e afrueme
racine carré = rranjë katrore
racine cubique = rranjë kubike
racine exacte = rranjë e përpikët
radiant = radiand-i
radical = rranjë
radical double = rranjë e dyfishtë
radicant = radikand-i
raison (në progresionin aritm.) = ndryshim-i
raison (në progresionin gjeom.) = herës-i
raport = përpjesë
rappresentation graphique = paraqitje grafike
(nombre) rationnel = numër racional
rayon de courbure = rrezja e lakësës
rayon de symétrie = rrezja e simetrisë
rectangle = kandrejtë-i
rectiligne = vijëdrejtë
régle de compagnie = rregulla e shoqënisë
régle de trois composée = rregulla e treshit e përzieme
régle de trois = rregulla e treshit
relation = marrëdhanie
rente = rente-ja
résolution = të zgidhunit
résoudre = me zgidhë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

reste = mbetje, teprojë
(la) resultante = rezulitante-ja
rotation = rrotullim-i

scaleno = (trekand) brijëndryshëm
secante (sec.) = sekante-ja (sec. sek.)
secteur = sektor-i
section = premje
section axiale = premje boshtore
section charactéristique = premje karakteristike
section conique = premje konike
section en moyenne et extrême raison = premje e artë
segment = segment-i
segments proportionnelles = segmente të përpjesëta
segment spherique = zonë sferike
segment spherique à deux bases = segment sferik me dy baza
semblable = (i, e) përgjashëm (i, e) barabarte
semidroite = gjysëdhejtëza
sens = kahe-ja
série = varg
similitude = përgjasim-i
simplification d'une fraction = thjeshtim i thyses
sinus = sinus-i
solide de rotation = trup rrotullimi
solution = zgjidhje-a
somme = shumë-a
sous-multiple = ndërfishi
sous-normale = subnormale-ja
sous-tangeante = subtangjente-ja
subtrahend (nombre à soustraire) = zbritës-i
sphère = sferë-a
substraction = zbritje-a
substitution = zavendësim-i
succession des nombres = radhë numrash
surface = sipërfaqe-ja
surface de rotation = sipërfaqe rrotullimi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

système d'équations	=	sistem ekuacionesh
système metrique	=	sistem metrik
symetrale	=	simetrale-ja
symetrie axiale	=	simetri boshtore
symetrie	=	simetri-a
symetrie centrale	=	simetri qendrore
système decimale	=	sistem dhjetor
tangeante (tg.)	=	tangjente-ja (tg tëgë)
tangeant d'inflexion	=	tangjentja e kthimit
tendre vers l'indéfini	=	me shkue kah pambarimi
tendre vers un limite	=	me shkue kah nji kufî
terme	=	kufizë-a sh. kufizat (e thysës, e mbledhjes, e zbritjes)
termes extrêmes	=	kufiza të anëshme a të jashtme
termes moyens	=	kufiza të mesme a të mbrëndëshme
titre d'un alliage	=	titulli i nji lidhje
theoréme	=	teoremë-a
theoréme réciproque	=	teorem' e anasjelltë
these	=	tezë-a
trace	=	vrragë (e nji plani)
transportation	=	mbartje
transporter	=	me mbartë
transversale	=	(i e) terthortë, vijë (e-)
trapéze	=	trapez-i
triangle	=	trekand-i
triangulaire	=	trikandësh-i
triangulation	=	trikandësim
triangulaire	=	trikandësoj
trièdre	=	trifaq s-i
trinome	=	trinom-i
tronc de cône	=	cungu i konit
tronc de pyramide	=	cungu i piramidës
valeur	=	vlerë
valeur absolue	=	vlerë absolute
valeur actuelle	=	vlerë e tanishme-ja
valeur extrême	=	vlerë e skajeshme
valeur limite	=	vlerë kufizore
valeur moyenne	=	vlerë mesatare
valeur nominale	=	vlerë emërore-ja

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

variable = ndryshor-i
variable dépendant = ndryshor i varur
variable indépendant = ndryshor i pavarur
variante = variante-ja
variation = variacion; ndërrim-i
vecteur = vektor
vérifier (une identité) = vërtetoj (një identitet)
verticale = pingule-ja

unité = njësi-a
unités des différents ordres = njësitë e rendeve të ndryshme
unité imaginaire = njësi imagjinare

zône sphérique = zonë sferike

Fluchtpunkt = pikë e ikjes
fetta sferica = thelë sferike
a prime = a e parë (á)
a second = a e dytë (á)
a tiers = a e tretë (á!!!)

Do të thohet: pesë, gjashtë, shtatë, etj. lekë dhe jo: lekë pesë, gjashtë, shtatë, etj.

Do të thohet: 5 ½ l, pesë lekë e gjymës dhe jo: lekë pesë e gjymës.

RÉSUMÉ

Il s'agit ici de la terminologie des mathématiques, établie par la section de langue et de litterature, en collaboration avec des professeurs de mathematiques. Les termes y sont rangés selon l'ordre alphabétique du Français en Albanais.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D Ë R

DISA EUFEMIZMA TE SHQIPES

E. ÇABEJ

Eufemizmat që përdoren në gjuhët popullore paraqesin një interes të veçantë si për linguistin ashtu dhe për etnografin, ato janë si të thuash ura që të shpie nga gjuha në folklor. Veçanërisht të pasura në eufemizma janë gjuhët e Ballkanit; kjo shkon krahas me karakterin e tyre të posaçmë, me sintaksën e me frazeologjinë më vete që kanë; shkon krahas me poezinë popullore që kanë ruajtur këta popuj. Ne Shqiptarët e shohim përdita, dhe mund ta studiojmë në vënd, sesa shprehet me figura populli ynë në të folët e tij të zakonshëm, sidomos banori i thjeshtë i fshatit e i malësisë. Duke qënë pra se dhe eufemizmat janë një pjesë e së folurit figurativ, nga kjo spiegohet pasuria e gjuhës sonë në këto. Këtu do të flasim për eufemizmat e gjuhës popullore, duke lënë mënjanë ato që mund të kenë përdorur shkrimtarët tanë.

Eufemizmi, siç dihet, konsiston në këtë që një frymor, një send, një koncept, një figurë e besimit popullor, një sëmundje etj. në disa rrethana evitohet të quhet me emrin që ka, dhe ky emër zëvëndësohet me një emër tjetër, i cili të thuash se vjen e mbulon atë të parin. Një nga arsyet e një veprimi të tillë është frika, po dhe të tjerë faktorë si turpi, frika se mos lëndojmë ndjenjat e tjetrit ose zakonet e mira të shoqërisë, e të tjera si këto janë shtysat që pjellin eufemizmat në një gjuhë.

Ndër shtazë ujku është tmeri i bariut. Prandaj kurse ne njerëzit e shtresave që janë larg jetës baritore përdorim fjalën e vjetër indoeuropiane *ujk (ulk, uk)*që lidhet me lat. *lupus*, gr. λύκος, sanskr. *vrkah* etj., bariu i maleve tona ruhet ta zëjë ngoje ujkun, sepse brez pas brezi atij i është bërë zakon frika, besimi se po t' i thuhet emri, ujku do ti i dalë përpara (lupus in fabula). Prandaj barinjtë tanë thonë për ujkun *bisha*, fjalë që përgjithësisht do të thotë «egërsirë», po që në sferën baritore ka marrë kuptimin e ngushtuar e të posaçmë të ujkut. Emrin *bishë* për «ujk» e gjejmë sëpari te Hahni. Fjalor 14: ky dijetar me atë rast shënon se edhe bariut grek të sotmë nuk i vjen mirë ta quaj ujkun drejtpërdrejt me emrin që ka, po i thotë zakonisht ζουλιπι; ai shton (f. 37) se edhe në shqipet fjala *zullap* përdoret për ujkun. Më interesant është emri

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

që i jep ujkut bariu i Matit e i Pukës. Ai e quan *gojëlidhuni*, një kompozit desiderativ, si të thomi «ai që ju lidhtë goja». Analog me këtë janë emrat e ujkut në Toskëri: *gojëmbërthyeri, i pagoji, bisha e pagojë*, emra, të cilat ja detyrojmë P. Tases në Fjalorthin e ri 55. Të tilla emërtime eufemistike të ujkut gjejmë dhe në gjuhë të tjera. Kështu P. Sébillot. Le Folk-lore 160 shënon se në Bretagne kësaj egërsire i thonë *chien de nuit* «qeni i natës». Për ujkun ekziston në Shqipëri edhe një mit i bukur, të cilin na i tregon Hahni I 165. Përveç ujkut edhe të tjera shtazë të egra kanë emra eufemistike. Sllavët që në kohët më të vjetra ariun e quajtin *medved* d.m.th. «mjaltngrënës»; duke humbur kështu emrin e lashtë të përbashkët të gjuhëve indoeuropiane motra për këtë egërsirë, shq. *ari*, lat. *ursus* gr. ἄρκτος, sanskr. *rksah* etj. Këtyre eufemizmave të gjuhëve indoeuropiane nga bota e shtazëve u ka kushtuar një vëmendje të veçantë i ndieri A. Meillet në studimin e tij Quelques hypothèses sur les interdictions de vocabulaire dans les langues indo-européennes (1906). Duhet shënuar se sipas përfundimeve të etnologjisë moderne një emërtim i tillë i ri dhe zhdukja e emrit të vjetër, përveç se me ndjenjën e vërtetë të frikës, ka qënë lidhur ngushtë edhe me besimet primitive të popujve. Në rasa të këtilla, duke folur me etnologët, thomi se emri i vjetër i kafshës bëhet *tabu*, ndalohet të zihet ngoje. Prandaj zëvëndësohet me një emër të ri, i cili merr për shkas një cilësi fizike a një zakon të kafshës në fjalë; sh. dhe R. Meringer në IF 21, 313. Edhe në letonishtet ka eufemizma për ujkun e për ariun, siç shtjellon K. Plukss në të përkohëshmen Celi 5 (1935) 31-41. Pas Meilletsë një tjetër dijetar trëng, Gauthiot, vërtetoi ka shumë vjet (Mém. Soc. Ling. XVI 264 vv.) se në disa gjuhë edhe bleta ka qënë veshur me tabu, prandaj edhe emri i saj u zëvëndësua me emra më të re, në shqipe p.sh. ndër të tjera me *mjaicë*. Edhe të tjera emra të bletës, si *mizë, mizë mjalti,* në Piana dei Greci në Sicili *mizarè,* duket se kanë qënë në ballë eufemizma: për *mizë mjalti* khs. trëngj. *mouche à miel*. Përmbi emrat e bletës në gjuhë shqipe ka shkruar Norbert Jokli, albanisti më i madh i ditëve tona, në veprën e tij Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen 297 vv. Le të shtojmë me këtë rast se bletarët kur vrasin bletët thonë në mënyrë eufemistike *qethim bletët* për të evituar fjalën *vrasim*, në Pukë, siç më thotë Z. M. Ndoja, *me pre bletën,*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI"

me gjithë këtë te Budi. Speculcum Confessionis 92 gjejmë *vrasim bletët*. Nga shtazët e egra një tjetër që e ka pasur emrin të veshur me tabu është dhelpra. Prandaj dijetari suedez H. Frisk emrin e kësaj shtaze te Lakonët e vjetër, κίων, e spiegon (IF 49,99) si «qimekuqe», se edhe nëpër dialektet suedeze dhelpra po këtë emër ka. Sipas Joklit (në veprën e cituar 297 vv.) edhe shqipja *dhelpër, dhelbun* është një emër — tabu që në të parë ka dashur të thotë «qimeverdhë». Ky dijetar edhe në *makth* «këlysh lepuri, lepurushkë» sheh (IF 43, 57 vv.) një emër eufemistik nga sfera e tabusë, sepse edhe lepuri, shënon ai, është një nga ato shtazë që i duken njeriut këmbëterse dhe lozin një rol me rëndësi në supersticione. Një shëmbëll interesant nga eufemizmat në botën e shtazëve janë emrat e nuses së lalës në gjuhët e ndryshme. Shumë herë kjo quhet *nuse*: shq. *nus' e lalës, nusezë*, gr. e re νυμφίσα, bullg. *nevëstulka*, rum. *nevastuica*: të gjitha me kuptimin "nusezë"[1]). Një tjetër emër që i kanë ngjitur një radhë popuj kësaj shtaze është *e bukura:* shq. *bukërë, buklëzë*, në Tiranë pas Kristoforidhit 47 *bishtfurkabukura*, në frëngj. *belette*. Të tjera emra të kësaj shtaze përmënd Victor Hehni në veprën e njohur Kulturpflanzen und Haustiere[5] 449 v., si gjerm. *Schöntierlein, Schöndinglein*, dan. *den kjönne (=putchra)*, angl. e vjetër *fairy*, span. *comadreja* «kumare», bask. *andere egeirra (anarea «grua»)*, sllav. *lastocka (laskati* «lajkatis»); këtyre Gustav Meyeri në Fjal. etim. të gju. shqipe 51 u shton dhe emrin e kësaj shtaze në Bretagne, *kaerell*, që lidhet me *kaer* «e bukur». Një buri emrash të nusezës gjejmë në gjuhët romane (neolatine). Kështu prej Fjal. etim. të Meyer-Lübkes (Romanisches etymologisches Wörterbuch) marr (në Nr. 1027), përveç frëngjishtes *belette:* në Milano *betora*, Piemont etj. *benda*, sicil. e vjetër *bitlottula*; në Sardenjë (Nr. 2624) i thonë edhe *jana e muru* «Diana, Zana e mureve», në Treviso *bela donola*, ital. përgjithësisht *donnola*, në Sardenjë edhe *donna de muru*, në Portugal *doninha* (Nr. 2733). Të gjitha këto emra janë eufemizma. Si spiegohen? Siç shënon Hehni, nusen e lalës nga shkathtësia e trupit dhe nga puna që bën përnatë dhe shumë popuj e mbajnë për një qënie demonike, dhe si e tillë nuk zihet ngoje

1) Sh. Meyer Fjal. etim. 52, P. Papahagi, Weigands Jabresbertcht, XIV 141' Nr. 210.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

me emrin e saj. Pas këtij dijetar edhe emri latin i shtazës, *mustela*, që do të thotë «që zë mi», dunet spieguar si një emër eufemistik. Hehni shënon edhe se te të vjetrit besohej në shndrimin e një gruaje në një nuse të lalës dhe anasjelltas. Ky dijeter vren edhe se Antoninus Liberalis tregon që kur Alkmena nuk lindte dot Herkulin, sepse Moirat me Eileithyian e pengonin lindjen, Galinthia i gënjeu perëndashat, në mënyrë që u bë lindja, dhe këto për dënim e shndruan në një nuse të lalës, γαλῆ. Dhe Eliani thotë: «Nusja e lalës, kam dëgjuar, ka qënë njëherë njeri si né, bënte magji dhe helmatime dhe qe e pafrë në dashuri të paletuar; inati i hyjnisë Hekate e shndroi në këtë shtaz' dashakeqe». «Përkundrazi», thotë Helini, «në përrallën 32 të Babrit nusja e lalës shndrohet prej Afroditës në një vajzë të bukur, po diiën e nuses e trathton veten dhe çfaqet ashtu siç është — si një nuse e lalës.» Këto data nga mitologjia greke e vjetër mund të shërbejnë për të kuptuar eufemizmat rreth kësaj shtaze në gjuhët e sotme të Ballkanit. Brënda botës shtazore një eufemizëm është, siç shënon dhe Kristoforidhi 477, emri i kukuvajkës në Malësi: *herë-keqja:* «sepse ndjell herën e keqe. Kur këndon herë-keqja grat' i thonë: Hangrësh kryetë t'at!». Nderim të madh gëzon përkundrazi nër Shqiptarë shqipja, siç e ka shtjelluar imtas, në krahasim dhe me Malazez, E. Durham në revistën Man 3 (1923) 55-61. Duket se eufemizëm është dhe *mënaafshi i egër,* emër me të cilin në Veri quajnë një farë merimange që bën një pëlhurë më të dëndur se kjo; përmbi besimet e zakonet që kanë ato anë në lidhje me këtë insekt sh. Folklorë I 61.—Një tjetër familje shtazësh që kanë gëzuar në gjithë kohët një nderim të përzier me frikë janë gjarpinjtë. Hahni I 162 na thotë se në katundet e Rrëzës së Tepelenës aj' qënie që mendohet si mbrojtësja e shtëpisë quhet *vitore.* Këtë e përfytyrojnë si një gjarpër të vogël e të trashë me lëkurë të shkruar. Kcili rri në mure të shtëpisë. Vitorja paralajmon të mirat e të këqiat që do t'i vinë shtëpisë, dhe po të vdesë burrëria e të shuhet vatra, ajo e lë atë shtëpi për ngahera. Në Çamëri, pas Pedersenit, Alb. Texte mit Glossar 205 *vitoret* janë ato gratë që i vinë foshnjës te djepi natën e tretë pasi ka lerë, dhe i caktojnë fatin. Lambertzi në Përrallat shqiptare (Alb. Märchen) emrin e vitores e bashkon me *vit, vjet* dhe e spiegon pra si «plakë»[1]), kurse

1) Këtë etimologji e ka dhe Hahni I 201 e Meyeri Fj. et. 475.

BIBLIOTEKA PUBLIKE AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Treimeri (Arhiv za arb. star. I 27) e lidh me lit. *vẽta, lett. wita* «vënd». Sidoqoftë kjo, unë besoj se dhe këtu kemi të bëjmë me një eufemizëm. Një figurë që i përgjan vitores së Jugut është në Veri *bolla*. Kjo është në të vërtetë emri i një lloj gjarpëri, po ky gjarpër i madh, i trashë e i zi i shtëpisë sipas E. Reimerit (sh. Jokl ly VIII VII 31) mendohet këtu si një qënie mitologjike e mirë, kurse *bullari* përfytyrohet si një qënie e keqe. Bollës në Pukë i thonë *ora e shpis*. Nga besime të tilla kuptohet se pse gjarpërin katundari në disa vise ruhet ta përmëndë me emër. Kështu në Pukë sipas fjalorit të Gazullit 428 gjarpërit i thonë *tokës, toksi* «shtaza që hiqet zvarë mbi tokë, shtaza e tokës», edhe *i toksi*. Të njëjtën gjë do të thotë *përdhesi,* siç quhet pas Cordignanos 144 gjarpëri në Mirditë, pas Folklorës I 62 i thonë dhe *ai i tokës*. Plotësisht analog me këto është emri i gjarpërit në gjuhët sllave, *zmija;* kjo fjalë, siç e pat treguar i ndieri linguist dhe albanist suedez Evald Lidén në Archiv für slav. Philologie 28, 38, lidhet me *zemlja* «dhe» dhe ka dashur të thotë në të parë «shtazë përdhese, χθαμαλός», tamam si *toksi* e *përdhesi* i shqipes; me *zmija* lidhet dhe *zmiji* «kuçedër»; të dya këta emra sllave do të kenë origjinë eufemistike. Sesa e dron bujku gjarpërin, këtë na e tregon zakoni që në Veri që më 23 Prill e gjer më 3 maj është zakon të mos e vrasin këtë shtazë, sh. Folklorë I 62; khs. dhe nëmën t'axaft i toksi.[1]) Pas Gazullit gjarpërit në ato anë i thonë dhe *dheutokësi*. Ky është një kompozit i ngjizur me dy fjalë sinonime, fjalë të tipit ital. *Mongibello = ital monte* + arab. *xhebel* «mal». Kemi në shqipet edhe të tjera fjalë të këtij tipi *çokiun* «sqep» në katundin gegë Borgo Erizzo (Arbëneshi) afër Zarës në Dalmaci, sipas Tagliavinit, I Albanese di Dalmazia 97, prej shq. *çok* «sqep» + kroat. *kljun* «sqep». Të tjerë shëmbuj janë : *dobromirë* prej sllav. *dobro* «mirë» + shq. *mirë; shatërkaz*, besoj prej *shat* + *kazmë*. Një tjetër shëmbëll është emri i lodrës *gurapesh* te Gazulli 160 : prej *gur* + *pesh* «gur», khs. emrin e lodrës *rrasbuq* te Cordignano 172, edhe *rrasabuq*, prej *rrasë* dhe *buq*. Nga toponimia hyn në këtë kategori fjalësh *Rrethakolli* në Arrnipë të keqe (Leka VII 433), prej *rreth* + *okoll* «rreth, përqark» nga serbokr. *okolo*. Të tilla kompozite hibride me dy elemente që duan të thonë të njëjtën gjë në dy gjuhë të ndryshme përmënd nga toponomastika e Francës A Dauzat, Les Noms de Lieux (1932) 71,[2] si p.sh. *Caste-*

1) Në Veri gjarpërit i thonë dhe *rrëshanësi, i përdredhuni* etj.

BIBLIOTEKA ROBI IKE
SHKODËR "MARIN BARLETI"

llo-dunum, ku *dunum* në galishte të vjetër donte të thoshte «castellum» etj. Duke u kthyer te eufemizmat e gjarpërit, le të shënojmë se një eufemizëm duhet të jetë dhe emri *rezia* që i kanë vënë në dialektin kampidanez në Sardenjë, i cili vjen nga lat. *res* «send», sh. Bertoni te Meyer-Lübke Nr. 7236.

Të shpeshta janë eufemizmat dhe në lëmë të demonologjisë primitive e të mitologjisë, sepse edhe këtu popujt figurat e besimeve të tyre, duke u atribuar atyre ekzistencë reale, nga nderimi e frika që kanë, e kanë për zakon t'i veshin me emra eufemistike. Është gjë e ditur se Grekët e vjetër të tri Eriniet, që bas miteve së tyre ndiqnin e ndëshkonin gjakësin kudo të ishte, e që Romakët i thërrisnin Furiae, i quanin në mënyrë eufemistike Eumenide «dashamire», për t' i marrë kështu me të mirë e për t'i mbajtur larg. Gjithashtu edhe lat. *Manes* «shpirtret e të vdekurve, bota tjetër nënë dhe» sipas Kretschmerit, Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache 198[1] në emrin e tyre lidhen me *manus* «i mirë», sh. dhe Walde-Hofmann II 27. Të njëjtën gjë ne shohim edhe sot tek ne si dhe te fqinjtë tanë të Ballkanit, edhe sot shumë figura të mitologjisë popullore nuk zihen ngoje me emrin e vërtetë. Rumunët fatave u thonë *ele* «ato»; këto «génies malfaisants des croyances populaires» quhen edhe *frumuosele* «të bukurat», sh. Candrea-Densusianu, Dictionnaire étymologique 104, Jokl loc. cit. 73 v. Në fushën shqiptare vezhgimet e para në këtë lëmë si në shumë të tjera ja detyrojmë Hahnit, kërkimet më të ra Lambertzit. Kështu i pari në Alb. Studien I 161 shënon se ato hiet e bukura që mendohen se rrojnë nëpër male dhe vinë e shohin edhe banesat e njerëzve, në Shqipëri jugore quhen *të rashtësmet* emër që i përgjigjet emrit ξωχικά që kanë Grekët e sotmë. Dukej qartë se ky emër (në Çamëri pas Pedersenit, Alb. Texte mit Glossar 170 s.v. *ngarkos: e përjazhmja*) është një eufemizëm, ashtu si do të jenë eufemizma dhe emrat e tjera kësodorë si p.sh. *fatmirat, ato që bafshin natën e mirë*, që na dëshmon Hahni vetë në f. 179. Këto qënie të besimit popullor quhen edhe *nuset e malit*, emër ky që Lambertzi në Përrallat shqiptare (Alb. Märchen) 30 e lidh me të drejtë me emrin e Oreadeve të Grekve të vjetër. Një tjetër eufemizëm është emri *i shtoizotvallave, shtozovalleve*, i cili, siç pa i pari Jokl në 1894, vjen nga urimi *shtoi Zot vallet*, është pra një fjalë e dalë nga një fjali e tërë si p.sh. geg. veriore *razog* nga *ra zogu*, çam. *shklata* «si» te

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Pedersen, Alb. Texte mit Glossar 194, që unë e nxjerr nga *sh kle ata?*, në Gjinokastër *ç'qe ata?* (me peremrin e neutrit) etj. Sadoqë Lambertzi 31 v. e vë në dyshim origjinën e emrit të shtoizavalleve siç e spiegoi Pisko, duke e quajtur një etimologji popullore, ne do ta pranojmë mendimin e të parit. Këtë na e përforcojnë formime analoge emrash të kësaj sfere. Kështu p.sh. orët në Dukagjin e në Malësi të Gjakovës i quajnë *shtoizorrjeshtat shtoizorreshtat,* ngjizje fjale krejt analoge me *shtoizavalle.*[1]) Për emrat e *lugatit* (e kanë dhe Shqiptarët e Greqisë, sh. Visaret e Kombit IV 349), në Berat *luvgat*, të *luvgisë,* që në Fier pas Dozonit do të thotë «furtunë», si dhe të *lubisë*, Jokli në veprën e cituar 70 vv. pas një studimi të imtë ka treguar se vinë të gjitha prej sllav. *ljubëkë*, serbokr. *ljubak* «i hieshëm», *ljuba* «dashuri», janë pra emra eufemistike me kuptimin «të dashurat»; në këtë grup hyn pas këtij dijetari edhe emri i *labiçit, lobiçit,* të cilin Meyeri Fj. etim. 230 e pat lënë të paspieguar. Le të shënojmë me këtë rast se në Gjinokastër nëpër përralla lubisë i thonë në mënyrë eufemistike edhe *mëmëlubi;* ashtu sikundër që Arbëreshët e Siqelisë (Piana dei Greci) *mamadragës* siciliane i thonë *mëmëdregje,* duke e shqiptarizuar fjalën. I origjinës sllave duhet të jetë dhe emri i *milaçes,* e cila sipas P. Sulit (Leka I 85) është një orë e mirë; unë këtë emër e lidh me serbokr. *mila* «e dashur», pra edhe ky duhet të jetë një euonim si *lubia.* Në fushën e gjerë të mitologjisë popullore ka dhe plot e ërtime të këtij lloji. Hahni në një këngë popullore toske Alb. St. 15 130, Nr. 16) përmënd *nuset e Mait,* të cilat pas tij janë njësoj me të jashtësmet, po në atë këngë përdoren si figurë për vajzat. Në Pogradec hieve që përfytyrohen si vasha a nuse të ra që rrojnë në mal u thonë *të bardhat,* edhe kjo sigurisht një eufemizëm. Analogjinë e tyre gjuhësore ato e gjejnë te *albile* «të bardhat» që kanë Rumunët; po më shkon mëndja se dhe [illegible] që nderoheshin në Delfi mund të kenë ndonjë lidhje me këto hie, përsa i takon emrit. Mundet që i natyrës eufemistike të jetë dhe *dhevështruesi* në Mirditë: pas fjalorit të Cordignanos 31 «qënie përrallore që në net prenë vere vë veshin në dhe për të përgjuar se a ka njeri që të vjë nga larg, ose për të dëgjuar zhurmën e ujit ndënë dhe»; ky dhevështruesi mendohet i hypur mbi një pelë shurdhe, që i thonë *dhamsuta.* Emra eufemistike kanë ndër ne në shumë vise edhe ato të tri gratë që i shënojnë a i presin fatin djalit të tretën natë pasi

1) Godin I 117 s. v. *Elfe* ka dhe *e mira e hanës.*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ka lerë. Këto përveç se *fatitë* quhen dhe *të tri grat*, në Çamëri, siç pamë, *vitoret*, në Piana dei Greci në Siqeli *zonja të jashtësme*, siç na dëshmon G. Pitrè te vepra e cituar e Lambertzit f. 38. Ky dijetar i fundit shënon me të drejtë se edhe emri i tyre *mirat*, që ndihet në Toskëri dhe te Shqiptarët e Greqisë e t'Italisë e që vjen prej greq. μοῖρα, ka hyrë aq më kollaj në shqipet, sepse u përzie këtu me shqipen *mirë*, është pra një euonim, një «emër i mirë», i lative të Shqiptarët. *Fatmirat* dhe *fatamirat* që përmëndmë më sipër dhe që përveç Hahnit i ka dhe Kristoforidhi 457, janë edhe këto emra të kësaj kategorie. Duket se duke u mbështetur te antagonizmat me *mirat* Shqiptarët e Italisë kanë shpikur dhe hiet e këqia që quhen *ligat*. Të dya këto, mirat dhe ligat, i gjejmë te poeti romantik Gabriele Dara prej katund t Palazzo Adriano në Siqeli në poemin e bukur të tij Kënka e sprasme e Balës f. 138, 140, 160. Jokli në veprën e cituar 60 vv. flet edhe për ato qënie të besimeve popullore të Ballkanit që i quajnë *hie:* shq. *hie*, gr. χιος, [illegible] ό, serbokr. *sjen*, bullg. *senište, senka*, aroumun, *aumbros* «i shkalur». Nuk është çudi që edhe te ky lloj emër të kemi përpara euonime për të mbuluar ndonjë emër më të lashtë që është dashur të evitohet. I këtillë është sigurisht emri i asaj hie se bardhë që e quajnë në Veri *pèlhura* e *vajzës*, për të cilën flitet në Folklorë I 61. Mundet që e njëjta gjë duhet thënë për *katravesh* «bishë e përrallavet te vjetra që ha njerëz si kulshedra» që gjejmë te Fjalorthi i ri i Pano Tases 73. Nga lëma e figurave të besimit popullor duhen përmëndur sëfundi emrat e shumta eufemistike që kanë dalë për djallin. Një nga këto është i *paudhi;* këtë e gjejmë te Grigor Gjirokastriti (Korfuz 1827) 9, Mateu 4. 11, te Hahni, Fjalor 93, më pastaj te Naim Frashëri, Istori e Skënderbeut 117, te Pederseni 201 s.v. *udhë*, te Kristoforidhi 300. Ky i fundit ka dhe *i papjesi;* Diefenbach, Völkerkunde Osteuropas I 70 i ka të dy emrat. Te fjalori italisht-shqip i Cordignanos 112 gjejmë dhe *brinoçi, shnjalli*. Në Prralla kombtare I, botim i dytë, të D. Kurtit f. 16, 21, 36, 45, 50 ndeshim dhe në këto eufemizma për djallin: *ai që kjoftë larg, asi qi kroshin djegë, si ai qi kjoftë tretë, i mallkuemi ai, prapona Zot, në* Pukë *koftlargu!* Në Elbasan i thonë *naje ukur*.[1]) Po të hidhemi në diasporën shqiptare, te antologjia e litografuar dhe edhe e pabotuar e Reinholdit, autorit të veprës së njohur Noctes pe-

1) Thonë dhe *i zvetnuemi*.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODËR

lasgicae (1856), antologji që gjëndet në bibliotekën kombëtare në Tiranë, do të gjejmë se Shqiptarët e Greqisë djallit i thonë dhe *jashtë këtej,* siç i thonë në Jugë të Shqipërisë *larg-këtej.* Meyeri në Alb. Studien V., ku ka botuar material të lënë nga Reinholdi dhe tjetër lëndë nga kolonitë shqiptare të Greqisë, në f. 97 na jep dhe emrin *njokës,* në ishullin Specia *gjokës,* mundet që dhe këto euonime, emra apotropeike. Të tilla emra të dreqit ka një tok edhe në popuj të tjerë. Nga gjuhët romane p. sh. te fjalori i cituar i Meyer-Lübkes gjejmë (Nr. 382) se në Montbeliard të Francës i thonë *atri* prej lat. *alter* «tjetri», në Provence *vilan* «katundar, malok» (Nr. 9331), po ky i fundit më shumë një emër sharje sesa eufemizëm.

Posaçërisht të pasura në eufemizma janë gjuhët popullore në lëmën e emrave të sëmundjeve. Kjo kuptohet mirëfilli, sepse duke ju larguar emrit të vërtetë të sëmundjes e duke e veshur këtë me petkun e një emri të ri më të butë, njeriu i thjeshtë ka besuar se po i largohet dhe sëmundjes vetë. Shqiptarët e Greqisë një lunge së vogël që del në sqetull i thonë *nusezë,* lisë së zezë *e lum*ë, sh. G. Meyer, Alb. Studien V 97, 94. Është interesant të shënohet se edhe vetë fjala shqipe *li* vjen nga greq. « ὐλογιά e kjo s'është gjë veçse εὐλογιά «bekim», sh. Meyer, Fj. etim. 244, Jokl IF 44, 33 vv; siç po shohim, për këtë sëmundje si në shqipet edhe në greqishtet përdoret një «emër i mirë». Veçse duhet shënuar se në gjuhën tonë *lia* nga një eufemizëm që pat qënë në krye, me kohë erdhi e u bë një fjalë e rendomtë si shumë eufemizma të tjera, e humbi vleftën e saj si eufemizëm, prandaj vise-vise u zëvëndësua me sajime të ra të këtij lloji; të tilla janë p.sh. *e lumë,* që pamë, në Veri e *bardha li,* Folklorë I 63. Në mënyrë analoge lisë në serbokroat. i thonë *boginjë* që lidhet me *Bog* «Zot», do të thotë pra diçka si «sëmundje Zotit». Në bullgarishtet fruthit i thonë *kytka* «lule», sh. Mirčev IY XXI XII B 120. Sëmundjes së urthit (shpregëtisë) në Kosovë i thonë *e paemna,* sh. Illyria VIII 8, kurse gjetiu me këtë emër quajnë «një lungë të tultë të vogël që del në fytyrë e që shkon duke e njomur esëll me pështymë në mbarim të së katërtës së fundit të hënës», për mjekimin e saj «popullorçe» sh. Folklorë I 57; në Shkrel me këtë emër quajnë sëmundjen e shpretkës, në Mirditë të thatin, po këtij i thonë dhe *tesha e gjâs,* sh. Donisa në Cirka II 191. Në Krujë tifos i thonë *sëmunda e*

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODER MARIN BARLETI

ftofët, Illyria XXIX 8. Në Veri pleuritit sipas Bashkimit 448 i thonë *tameltuemja*, kurse në Mirditë pas Donisas (Cirka II 148) kështu i thonë polmonitit nga të dy anët, po trajta e drejtë duket lë jetë *tamëltuemit*, që në Pukë përdoret për të thermit. Hahni Fj. 167, për një njeri ftisik na dëshmon eufemizmin *krahënurli-u*; kollës së keqe i thonë dhe *koll i bardhë*. Siç më thotë z. N. Lako, të thatit në Korçë i thonë *koqe e mirë*. Le të shënojmë edhe se St. Mladenov në Spisanje na bëlgarsk. Akad. na nauk. 6 (1913) 73 vv. shënon se pas Bartholomaesë *paesa* «leprosus» e Avestës mund të jetë identike me *paesa* «stoli», prandaj dijetari bullgar krahason me fjalën e Avestes bullg. *šarka* «morbilli, variola», e cila nëpër dialekte do të thotë «stoli, zbukurim»; nga shqipja mund të sjellim këtu për krahasim shprehjen eufemistike *ju zbukurua plaga*. Është interesante të shohim me këtë rast emrat eufemisiike që përdor populli për epilepsinë. Te Grigori gjejmë *bëtajë*, te Hahni Fj. 175, 141 *bëtajë, sëmund' e ligë, flamë*, si verb *tremem*, te Kristoforidhi 203 *lëngat' e tokësë*, te fjalori i Godinit I 202 edhe *fdigë, shakull, ajo e tokës, botë;* A. Xhuvani te Bashkimi II Nr. 219, 13-IX-1945 ka dhe *ajo e botës, ajo sëmundë, punëhera;* sh. dhe Folklorë I 55, 83. P. Tase 172 ka dhe *shkuma, sëmunda e hënës, puna e hënës, puna e herës, e tokës, ajo e tokës*; i thonë dhe *ajo punë*. Për epileptikun vetë Tasja ka *shkumëngarë*, te Kristoforidhi 79 gjejmë dhe *gjindem keq* σελληνιάζο αι Edhe në gjuhë të tjera gjejmë të tilla emra për dëtë sëmundje. Në serbokroatishte pas fjalorit gjerm-serbokr. të Ivekoviç-Brozit 463 i thonë dhe *velika bolest* «sëmundja e madhe», *gora* «mal», *gorica* «malth», *gorska bolest* «sëmundja e malit», *goropaština* «ileti i malit», *mrska bolest* «sëmundë e urrejtshmë», sh. dhe fjalorin e Vukut 98. 500. Në greqishte të re i thonë edhe γυναικά «e ëmbla» σε ηνα μος «sëmunda e hënës». Ky emër i fundit, siç po shohim, është analogjia e shqipes *sëmunda e hënës, puna e hënës* (mos fjala shqipe është një përkthim,një calque linguistique i fjalës greke?).[1]) —Që edhe për vdekjen, këtë extremum malum, popujt kanë përdorur në të gjitha kohët eufemizma, për t'ja zbutur pakmos tmerin, kjo nga sa u tha më lart kuptohet vetiu. Në Shqiptarët thomi *shkoi, na la, u nda këso bote, ndroi jetë*, te Pederseni 203 *vate;*

1) Më ra të tëhollëtë «të fikët» te Halin Fjal. 137

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

lat. *obitus* «vdekje», gjerm. *verscheide* »vdes» (ndahem), ital. *si estinse* «u shua» etj. Po këtu humori i popullit ka nxjerrë edhe plot fjalë të anës së përkundërt, fjalë që janë pjella e shakasë, e talljes të së gjallit për të vdekurin, si *shkoi me bâ vegsha (voiba), e bëri sheshin breg, vate me të shumët, e drodhi, i bëri këmbët baraj,* te Meyeri Fj. etim. 153 edhe *hovi.* Nga të dy llojet e shprehjeve së tilla, të mira e të këqia, ka plot shëmbuj te P. Tase 196. Po shënojmë se shprehja humoristike *shkoi me bâ vegsha* mund të ketë lidhje me keramikën që i vihej të vdekurit në varr në kohët pagane, ashtu siç i vihej dhe oboli i Karontit, te Grekët e vjetër si dhe në viset tona. Gratë në gjuhën e tyre edhe të vrarët e cirkumskribojnë me eufemizma. Kështu në Gjinokastër thonë *e nxiruan, e shkreluan, e përmbisnë* për «e vranë». Për të vdekurin këtu gratë më shumë thonë *i ziu, i nxiri,* burrat më fort *i shkreti,* në Skrapar *i shuari,* në Veri *i mjeri.* Të tilla shprehje janë veçori të «gjuhës së grave» (language des femmes).

Përveç se në këto që u përmëndnë më sipër, gjuha popullore edhe në punët e vogla të jetës së përditshme disa gjëra nuk i vjen mirë t'i zëjë ngoje me emrin që kanë; këto kanë të bëjnë me zakonet e me supersticionet e popullit, me folklorin përgjithësisht. Ne të gjithë e dimë se në shumë krahina të Shqipërisë punën e së shuarit e veshin në petkun e eufemizmit. Thomi kështu *ul kandilen, jale dritën, u fal drita, ftohe zjarrin, u ul zjarri etj.* Siç shënon dhe Hahni I 157, zjarri digjet për çdo të krëmte të madhe, edhe në dhe të shënuara të verës, si dhe në natën që gdhihet ajo festë, gjithashtu dhe në odë të lehonës për 40 dit rresht pas pjelljes. Në qoftë se zjarri në të tilla raste shuhet, kjo merret për ugur të keq. Nga supersticione të tilla spiegohen fjalët që vin'e zëvëndësojnë fjalën "shuaj"; sepse kjo fjalë njeriut të thjeshtë, e sidomos grarisë, i duket se i ndjell prapësi, i kujton të shuarit e vatrës, të shtëpisë. Prandaj Veriu thotë *dita e të shuemve,* e Jugu *nën' e shuat»,* «nënë që ka mbetur pa fëmijë», një participi me *t* si çam. *ratë «rarë», rîtë* «hyrë» te Pederseni 18, geg. ver. *vend i vûtë* «i fushët» te Gazulli 463, *më të ngritë* te Naim,i Istori e Skënderbeut 250, në Gjinok. *jam e ngjethët* «e ftohur» etj. sh. dhe Jokl, Archivum Romanicum XXIV 14 (Borgo Erizzo në Dalmaci), P. Suli, Leka V 53 (Mirditë). Në Malësi të Ma-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

dhe sipas Gazullit 340 veve u thonë dhe *aso së pulash*, duke besuar se po të thonë fjalën *ve* pulat s'pjellin. Në Gjinokastër, kur gratë vënë bojë në flokë dhe i shtien bojës kripë, që të zëjë kripa mirë, këtë fjalë s'e shqiptojnë, po thonë *na ajo e gjellës.*[1]) Le të shtojmë edhe se në këtë qytet grave që venin e lypnin derë më derë, qoftë nga keqi që ndjenin për to, qoftë nga frika u thoshnin *zonj'e varfër.*

Gjer këtu pamë eufemizma, të cilat, me gjithë se të lidhura me doke e zakone të popullit, në fund të fundit janë pjella e frikës dhe e përpjekjes që bën njeriu primitiv për të larguar rreziqet që ai në bestytnitë e tij mendon se i kërcënohen. Përveç këtyre ka eufemizma të një natyre thjesht sociale. Në krijimin e këtyre shtysa nuk është frika, po më shumë një tjetër aktor psikik: ndjenja e turpit, kujdesi që me të folët tanë mos të lëndojmë ndjenjat e rrethit ku gjëndemi. Këtu hyjnë sëpari kryesisht fjalët e sferës seksuale. Duke filluar nga pudendat kemi *vehtja* për organet gjenitale, që e ka Hahni Fj. 212 e gjithë leksikografët pas tij, e ka si *vet-he* dhe çamërishtja e Margëllëçit, Spatarit afër Filatit etj. Për «penis» shqipja ka dhe *vëndi i ujit*, në Shkodër *rrush* (khs. fletën e ardhisë që mbulon këtë pjesë të trupit në skulpturën greke), për "testiculi" ndër të tjera ka dhe *lule*. Për "mingere" thomi *derdh ujët, bëj ujët*, thomi *vete tej* etj. Për coitusin Veriu thotë në mënyrë më të hollë edhe *me puthë gruen*, tamam si frëngjishtja *baiser*, në Pukë e në Dukagjin edhe *me prekë gruen*. Shëmbuj si këto tregojnë se Malësorët tanë, sadoqë te ata lulëzon një lirikë dashurie natyraliste trashamanqe, në kuvëndin e tyre të përditshëm janë të zott'e një mënyre shprehje mjaft të hollë brënda kësaj sfere të jetës. Po dhe jashtë kësaj fushe ndihet një respekt i tjetrit dhe i rrethit. Kështu p.sh. në kuvënd të burrave në Veri një anëtari që flet rrem s'ja përmasin këtë kurrë, po i thonë njerëzisht *ke gabue*. Një eufemizëm i sferës sociale është dhe *palokafshë*, emri i gomarit te grat'e Çamërisë, një tjetër shëmbëll i "gjuhës së grave". Përkundrazi *gjashtar* për "morr" në Gjinokastër është më shumë pjella e humorit të popullit në lëmë të gjuhës.

1) Khs. *gjellët* «kripë» te Logoreci, Fjalorth 40: perdoret prej grash kur trajtojnë ngjyrën për t'u a qitun flokvet, e cila ngjyrë don edhe nji pisk krypë e kjo thirret atbotë gjellët, pse po u permend emni krypë, ngjyra nuk zen...»

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kaq sa për eufemizmat që ekzistojnë në shqipen tonë në sferat e ndryshme të jetës, mesa kam mundur të mbledh nëpër shkrime dhe nga goja e popullit. Sigurisht që kjo mbledhje që shtruam këtu më lart është larg nga të qënët e plotë. Studime më të imta mund të nxjerrin me kohë material të ri nga kjo fushë interesante e gjuhësisë dhe e folklorit.

RÉSUMÉ

L' auteur de l' article étudie quelques euphémismes de la langue albanaise, en tenant compte des parallèles surtout dans les autres langues balkaniques et ayant trait aux anim aux, (loup, ours, abeilles, belette, serpents), aux figures de la démonologie primitive, aux maladies (variole, splènopathie, typhus, épilepsie, etc..) et â la mort, en effleurant en outre les expressions de l' humour populaire. En dernier lieu il y étudie les euphémismes se rattachant à la vie sociate et à la vie sexuelle. Il fait cas du langage des femmes dans ce domaine en ce qui concerne l' albanais seulement.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Gjurmët e nji kalendari primitiv në popullin t'onë

Populli ynë në shumë çfaqje të jetës së përditëshme paraqet gjurmë të vjetra të nji së kalueme shumë të largët. Të përditëshme janë këto çfaqje, të cilat, të mishnueme në ndërgjegjen tonë, na kalojnë të pavrejtuna, si gja të zakonëshme dhe të pa interesë.

Por si të ndalemi mbi to, të vrejmë me nji kujdes dhe interesë të veçantë, të kërkojmë domethanjet dhe lidhjet në mes tyne, do të shofim se na zbulohen pamje të randësishme të jetës së të parve tonë.

Për shembull, çdo njanit ndër né i ra rasa të shohi dhe të marri pjesë ndër festa popullore tradicjonale, të cilave koha ua humbi kuptimin. Kemi festën e Shëngjergjit, Shëngjinit, Shndritatit, Gjalliqes, Tomorrit, të Dit-kndelljes, Ditës së Verës, Marinajve, Këndravicës, Shmitrit, etj. të cilat vjet për vjet përsëriten me rite të caktueme.

Në popull ritet e vjetra janë ende gjallë. Po zakonisht kalohet mbi këto festa me gjykimin e shpejtë «tradita popullore», dhe rrallë i u vu ndonjani përshkrimit të ritit, dhe aqë ma pak asht shtrue problemi i tyne.

Pa tjetër, këto çfaqje spontane, të përsërituna prej qinda e qinda vjetësh, duhet të jenë fragmentat e ndonji kalendari primitiv, të cilit i treten fletët.

Kohët e ma vonëshme sollen mbi traditat e vjetra zakone të reja, të cilat erdhën tue u shtrue nji mbi nji dhe e mbuluen substratin e vjetër, shtresën e parë, e cila aty-këtu përsa del në shesh.

Më 15 Gusht, populli i rretheve të Tomorrit ngjitet në Kulmak dhe në majën e Qukës, me bamë kurbanat e zakonshëm. Asht vorri i baba Abaz Alis, thonë dhe në kultim të tij bahet pelegrinazhi. Shkrimtarë të vjetër thonë se më 15 gusht ngjiteshin në Tomor për të kremtue festën e Shën Mëris.

Më 10-15 gusht asht festa e Gjalliqes, që kremtohet në majën ma të naltë të Lumës. Sot kjo festë e ka humbun fare kuptimin. Në ritin e festimit ban pjesë të marrunit e avdesit te kroni tradicjonal që thirret «Kroni i Zojës».

Me 2-15 gusht asht festa e Shndritatit, që kremtohet me kubarna në majën e Pashtrikut. Edhe këtu mblidhen muhame-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

danë (prej Hasit) dhe katolikë (prej rretheve të Gjakovës) dhe e kremtojnë së bashku. Edhe burimi i këtij emni u zhduk. Disa mendojnë me e vu në lidhje me Sancta Trinitas, të tjerë me të Shndritunit e Atit.

Në gusht, mbi malin e Shënlleshit të Krujës, mblidhet populli me e kremtue ditën e festës tue përkujtue Sarisalltikun me kurbana. Runja e Malit të Zi të Dukagjinit mbledh popullsin e rrethit me 15 gusht, për festime tradicjonale me kangë e valle dhe kurbana. Në gusht populli i Kurveleshit mblidhet në majën e Këndravicës, për kremtim. E kështu shumë maje të tjera, në nji ditë të gushtit kanë nji kremtim të veçantë tradicjonal.

Kreshtat e këtyne majave janë shtrue me brina berresh, që kush e di për sa vjet balien kurban vazhdimisht mbi to.

Çka janë këto festa, ku me kujtime islame, ku kristjane e ku pa farë kuptimi që kremtohen ndër maje me distanca kaqë të mëdha, po në nji kohë dhe me rite të njajta në të cilat marrin pjesë si kristjanë, si muhamedanë?

Pa dyshim janë data festash të nji kalendari të pashkruem, që n'origjinë mund të jenë kremtue me rite pagane dhe që mund të kenë pasun kuptime të besimit të vjetër, dhe që ma vonë u përshkruen prej frymës kristjane që u ndrroi kuptimin dhe u ndryshoi ritin, kurse në kohë ma të vona influksi islam i zëvëndësoi me kuptime dhe rite muhamedane.

Po të bahej nji harrje e shtesave të kohëve ma t' vona, do të zbulohej shtresa e vjetër, baza e këtyne traditave.

Kalendarët e vjetër, sikurse edhe të tjerët mbas tyne, n'origjinë patën për qëllim ta ndanin kohën dhe kështu ta banin të mundshëm orjentimin në te me anë pikash fikse, që ishin festat. Prandej, për me zbulue mekanizmin e tyne, lypen njohuni mbi besimet e herëshme, me të cilat ishin lidhë festat.

Mbi besimin e të parëve tonë në kohë të lashta kemi shumë pak njoftime, por prej mitologjisë së popujve fqinj dhe të bashk-kohëshëm me ta, prej traditave që rijedhin deri në kohë të vona, dhe pikësëpari prej kondita ve socjale dhe kulturale në të cilët jetoi populli ynë, mund të nxjerrim si konkluzjon në vija të përgjithëshme disa njoftime mbi besimin e tyne.

Në përgjithësi shqiptari me gjithëse u përshkue nën forma të ndryshme të kristianizmit dhe nën islamizëm, nuk u tregue i kurrnjanit. Traditat e vjetra pagane qenë kurdoherë ma të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

qëndrueshme. Edhe sot malcori ynë, me gjithë se paraqitet nën diviza të ndryshme religjoze, është qind për qind ma tepër pagan se sa kristjan ase muhamedan. Dashin ma të mirë e ban kurban për Shëngjergj e jo për Bajram ase për Pashkë. Ditën e verës ase të mjedisit të saj e kremton me mënyra madhështore, ma tepër se çdo festë tjetër. Festat tradicjonale, me gjithë se nuk ua din kuptimin, i ndinë ma tepër se çdo kremtim tjetër fetar.

Doktrinat e ma vonëshme nuk muejtën me i shlye traditat e vjetra, porse u futën tue i modifikue tërthoras. Prandaj, p.sh., festat e gushtit, që u zunë në gojë më sipër, që e kanë bazën në kalendarin e vjetër pagan, kaluen edhe nën kristjanizëm, por u zavendësuen me festën e Zojës Mëri; as islamizmi nuk arrijti me i zhkukë, por i zavendësoi me baba Abaz Alin, Sarisalltikun, etj.

Besimet e shqiptarit mbesin mbrenda kufijve të kultit të natyrës, siç asht e natyrëshme për shkallën e zhvillimit ekonomik dhe teknik, për shkallën e sundimit mbi natyrën që pat mbërrimë populli ynë. Ideja abstrakte e krijuesit nuk lot ndonji rol në 'to. Për këtë arsye ndër beti ne të popullit të malit ndigjojmë: «për qiell e dhé», «për kët ditë», «mu shkimtë pjesa e diellit», «për kët rreze drite», etj, dhe rrallë, shumë rrallë, vetëm ndër qytete, ndihet «për Zotin». Ashtu edhe ndër rapsodi e kangë të vjetra, me përjashtim të vjershës së parë: «Të lumtë na për të madhin Zot — që s' jem kanë e na ka dhanë» që përmendet Zoti, se ndër rasa të tjera nuk ndiehet. Ndër ngushticat e tija shqiptari i siellet për ndihmë fuqinavet të natyrës së personifikueme, dhe kurrë Zotit. Prandaj për majat e maleve, gurrat e pastërta, landët vigane ai ruen nji farë nderimi dhe i pështjell me nji hije fetare. Kështu p. sh., kemi lisat e fshatit Vrakull, rranzë Tomorrit, për të cilët populli ruen nji nderim të madh e nuk guxon kush me vu spalën në 'ta, pse sjell mbi vedi fatkeqësi. Kësi shembujsh kemi shumë nëpër Shqipni si teprica të kultit të vjetër.

Tue qenë se populli ynë n'origjinë lyrinizoj natyrën, prandaj kulti i tij primitiv asht i lidhun ngushtë me jetën e tij dhe me punën e tij të përditëshme që zhvillohet në rrethin e natyrës.

Edhe kalendari i tij primitiv pra asht kalendari i fenomeneve periodike të natyrës, i festave të saja; kalendari i punës të populit dhe i prodhimit të punës së tij.

BIBLIOTEKA PUBLIKE E SHTETIT "MANIN BARLETI" KORÇË

Kjo paraqitje e shkurtë na jep çelsin e zhvillimit të problemit të marrun në studim, të kalendarit primitiv të popullit tonë.

Ndër popujt e vjetër, si rregullues të datave dhe matës së kohës ishin administratorët e religjoneve ase priftërijt, sikurse edhe në kohë të soçme përpiluest e kalendarve të festave fetare janë t' auktorizuemit e institucjoneve fetare të ndryshme. Tek kalendari primitiv i popullit t' onë, si paraqitet sot, nuk kemi ndoj personë të ngarkueme me këtë detyrë, porse ma të vjetrit e fshatit, ase ma të zgjuetit, që tregojnë ma tepër interesë, lexojnë shejet tradicjonale që kanë vumë në natyrë për rregullimin e kohës. Për ma tepër këto sheje të natyrës, janë në dijeni të marë popullit dhe në njohjen e tyne nuk nevojitet ndonji mpreftësi mendore e madhe.

Prandaj ndamja e kohës, nder male t' ona, nuk ka nji emën të veçantë si ky që përdorim na sot: «kalendar». Fjalën kalendar as nuk e njofin, as nuk kanë ndoj tjetër më e zëvëndsue. Prej fjalës kalendar kemi vetun emnin e mojit të parë të vjetit, dhe traditën e natës së vjetit të rij por vetun nder qytete; në popull nuk e gjejmë as në kuptim të traditës së natës së vjetit të rij as si emën moji.

Ndër qytete ndihet ndër të vjetër, nji emën tjetër për kalendarin: e thrrasin «Lonari», fjalë e marrun prej «lunari» si rrjedhim i ndoj kalendari sinedik. Kjo fjalë e mbetun nder ne ndoshta prej venecjanve, nuk ka të bëjë aspak me ndamjen e vjetër të kohës, e cila nuk pshtetet në sistemimin e kalendari sinodik.

Si tek çdo kalendar, ashtu edhe tek ay i të parve t' anë, baza e matjes së kohës asht dita dhe nata, si fenomene ma të dukshme të natyrës.

Dita ndahet prej natës, në mëngjes me të zbardhun të dritës; dhe në mbrame me t' errun. Brezat e ndryshëm të sfumaturës në mes të dritës e të territ përcaktonen bukur prej shqiptarit me nji shkallzim termash të ndryshme.

Ferk, ase ferku i dritës, asht gradacjoni i parë i dritës. Agim, ase agzhole, thrrasin kuer drita zën e dendsohet. Me lëbardhë ase me zbardhë ngjin kohën në mes t' agimit dhe të lindjes së diellit.

Me të njajtat shkallzime kalojnë në mbrame prej dite në natë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKOLLORE "NAIM BARLETI"

Mbas prendimit të diellit, shkallzimi i parë asht muzgu, kuer drita zen e mbshtiellet. Mbas muzgut, vjen t' errunit, që zgjatë deri sa soset drita.

Kohët e ditës, janë: mëngjezi, cila, dreka, zamra dhe darka.

Dita për populliin t'anë fillon shum shpejt: në të zbardhun të dritës, fillon dita dhe nji heri puna; anasjelltas mbramja vjen në t' errun.

Zakonisht, në mëngjes nuk hanë bukë: bariu ase bujku, edhe në kjoftë udhtàr, marrin bukën në trastë e kafshoren e bukës e e hanë në cila. Prandaj, në shum vise thrrasin cilë bukën e mëngjezit. Ashtu drekë rrallë shtrohet ndër shtëpija shqiptare të fshateve: bariu e han në mal, bujku n'arë, dhe gra e fëmij, pa rregull, kush ma parë kush ma vonë, si t'i lejojnë punët, rrokin kafshoren e bukës, dhe e hanë veçmas. Prandaj, në shum vise drekë thirret vetun buka që shtrohen në rasë vdekjeje, pse në këtë rasë janë të mbledhun të gjith pjestarët e familjes dhe hanë sëbashku. Ashtu zamrën bujku e han kur lëshon qetë prej zgjedhe dhe i lëshon në kullosë; dhe bariu, para se ti këthej berret kah shtëpija; por zakonisht zamra nuk hahet prej burrave dhe ma tepër asht për fëmij. Vetun darka shtrohet në shtëpin e malcorit: për darkë mblidhen të gjith pjestarët e familjes rreth trevezës, dhe hanë nji gjellë të përbashkët. Zakonisht në darkë hahet ma mirë, kaq sa në shum vende ka mbetë fjala darkë për gjellë mishi.

Kohët e ndryshme të ditës I masin me anë të diellit dhe të hijes.

Me anë të diellit e masin kohen më pash: me nji ase dy pash diell. Rruga që ban dielli me kalue prej Lindje në Prendim, dahet me sy në gjasht pjesë, dhe sejcila pjesë thirret «nji pash». Me tre pash diell, asht mjesdita. Me nji pash diell, ka kalue nji e treta e paradrekës; me dy pash diell, kanë kalue dy të treta të paradrekës. Po në këtë mënyrë edhe për mbas-dreken. P. sh. me dy pash diell të mbasdrekës, lëshon bujku qetë prej zgjedhe, pse duen me kullotë. etj. Nji mënyrë analoge asht të matunit me hosten.

Me hijen masin kohët e ditës në nji mënyrë tjetër: kur nji burr në këmbë nuk lëshon hije, asht dreka, pse dielli asht mbi krye; sa kambë lëshon hije nah Lindja, aq orë, thonë, ka kalue dreka dhe sa kambë lëshon kah Prendimi, aq orë thonë, ka dreka.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI"

Zakonisht për me lëshue dhe me këthye berret prej kullosës për me xanë dhe me lëshue qetë etj. punë të përditëshme, venë sheje fikse nder shkamijt ase landët e malit, tue vërojtë kur i merr hieja ase i xen dielli.

Gjatë natës, shqiptari, nuk punon. «Puna e natës, gazi i ditës», thotë.

Fill mbas darke vjen pushimi. Zgjimi bahet shpejt.

Nata nuk ka shenja dalluese kohe. Lajmëtarë të mëngjezit janë hyjt e qjellit. Barijt e Kurveleshit dhe të I eskovikut më folën për nji grup hyjsh të lidhun bashkë të cilët ata i thërrasin «shejzat», që duken në mëngjez. Shejzat, të cilët unë nuk muejta t'i determinoj, lajmojnë se agimi asht afrue, dhe barijt zgjohen me u bamë gati për të dalë në kullotje. Nji shej tjetër asht afërdita, ase hylli mëngjezit, hylli i dritës, hylli i karvaneve që asht ma i njoftun dhe tregon ma tepër avitjen e ditës. Edhe ky përdoret prej barijve, prej udhëtarëve si lajmëtar i mëngjezit.

Emnat e ditëve të javës e kanë burimin në mitologjinë e vjetër: e diele prej diellit, e hanë — dita e hanës. Populli ynë edhe sot i njeh si vëlla e motër diellin me hanën, ashtu si në kohë mitologjike, që mbaheshin për të bijt e Zotit të dritës Hyperion; dita e martë — kushtue Zotit Mart, e merkurja — kushtue Merkurit, zotit të tregëtisë, prandaj ndër qytetet e vjetra të vëndit tonë në këtë ditë kemi tregje dhe panajire; e enjtja pa tjetër do të ketë nji burim mitologjik si ditët e tjera; e premte ase e prende — kushtue zojës Prendë (Venus), zojës së bukurisë, prandaj në vëndin tonë ka ngel tradicjoni mos me u rrue as mos mu qethë në këtë ditë, pse dalin thijat; mos me pré thojt, se dalin qejza; mos me u krehë, pse bijnë flokët, etj. Të gjitha këto punë, që janë ne lidhje me stolin e trupit, nuk duhesh të kryheshin në këtë ditë, pse kjo ditë i kishte kushtue bukurisë, prandaj lypeshin krye nji ditë përpara d. m. th. ditën e enjte. Edhe e shtundja asht në lidhje me Saturnin.

Java e ka origjinën në fazat e ndryshime të hanës. Me gjithë se hana dhe ndryshimet e saja luejzin rrol me randësi në jetën e përditëshme të popullit, dhe kohët e saja janë baza nisjeje të shumë punëve, me gjithë atë si masë kohe me burim origjinal, java në popullin tonë nuk paraqitet. Kështu edhe moji, me burim egiptjan, që e ndanë vjetin në 12 muej me nga 30 ditë seicilin, duket se hyni vonë në popullin tonë kaq sa ay gjithnjit nuk e ka idenë e mojit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shqiptari vjetin duket se e ka njoftë gjithëmonë si një qerthull të fenomeneve të natyrës, që lindin, zhvillohen dhe përfundohen. Edhe gjuha e jonë ruen dy terma të vetat për 'te: vjetë ase vit, dhe mot ase motmot.

Vjeta u njoft që prej popujsh të vjetër dhe si prodhim i qytetnimeve ma të para.

Babilonezët e njoftën në fillim vjeten 360 ditësh, ashtu edhe egjiptjanët. Ma vonë i banë korrektime të reja dhe vjetës i shtuen edhe 5 ditë, tue mrrijtë në 365. Edhe grekët e romakët patën po të njajtën ide me të vjetrit për zgjatjen e vjetës.

Mënyra e kësaj llogarije lidhte me hijet e obliskeve të cilat simbas lëvizjes së diellit shtyheshin djathtas e majtas dhe mbas 365 ditësh këtheheshin po mbi vendin e parë.

Populli ynë tregon një mënyrë tjetër numrimi, ndoshta ma primitive, pse nuk ka nevojë mbështetjeje ndër ndërtesa ase mjete të njeriut. Kreshtat e maleve shqiptare janë sheja të veçanta konvencjonale që fiksojnë lindjen e diellit ndër data në shej që ka vjeti, si do të shofim ma tutje; këthimi i diellit po ndër ato sheje në vjetin tjetër, kryhej mbas 365 ditësh.

Në nën-ndamjet e vjetës, shqiptari i largohet të gjithë kalendarëve primitivë të popujve të tjerë dhe paraqet një mënyrë të vetën.

Gjurmët ma të fuqishme dhe shumë të vjetra të një kalendari primitiv i gjeta në krahinën e Lumës, të cilat më ndihmuen me u thellue në këtë fushë.

Tue u gjetun ndër livadhet e Pikllimës (Koritnik), pyeta një bari të vjetër vendas: «kur i kositni livadhet e bjeshkës?» Ay në thjeshtësin e vet dhe në një mënyrë krejt spontane dhe të natyrshme, më gjegji: «Me datën 100».

Dy djelmoça të rij që më shoqnojshin, të cilët kishin krye një shkollë fillore në vend, qeshen per ket gjegje të plakut, dhe bariu tue e marrë si tëfyeme gazin e tyne, i siellet tue i thanë: «Po kur ra kosa nder livadhe para 10 ditësh mbas mjedisit të verës?»

Djelmt e rij nuk e zgjaten biseden, por më pergjegjen vetë tue më thanë se: «Livadhet e bjeshkës i kosisim nga mjedisi i gushtit».

Por çka ata deshten me e kalue, tue e njehë si një datë tashma të vjetrueme dhe pa kuptim per mue, m'interesoj ma teper dhe e shtrina biseden mbi çka desht plaku me më thanë me ato

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLEJI" SHKODËR

dy data: «Me daten 100» dhe «10 dit mbas mjedisit të verës».

Në mbramje, me fshatarët e katundeve Belej e Zapot. dhe ma vonë me fshatarët e katundeve Pobreg dhe Bardhoc, nder rrethe të Pikllimës, që mbahen me Lumë, hetova se krejtë n'at rreth dhe në Lumë e Has perqjithësisht kishin ngelë ende të gjalla dhe në perdorim të popullit gjurmët e nji kalendarit të vjetër primitiv, që do ta shtjelloj këtu.

Si thamë ma sipër, njisija ma e madhe e matjes së kohës asht vjeta. Shumfish ma të madh se vjeten nuk njef malcori: qindvjetori ase shekulli, që perdoret nder qytete, nuk njifet në malci. Gjatsit ma të mdhaja kohe, maten me faqe nierit ase me brez (generacjone).

Baza e matjes së kohës asht vjeta.

Fillimi i vjetit, si mbas shenimeve të mbledhuna, asht Shen-gjergji ase në shkurtim Shnjergji.

Me gjith se Hahni n'Albanesische studien mendon se vjeti primitiv nder të parët t'anë fillon në Shtatuer, pse si mbas vrojtimeve të tija në Rrezë të Gjirokastrës, në ket ditë kanë zakon të pë.trijnë brumin e rij të bukës me lang rrushi të papjekun, nuk më duket se e ka gjete të verteten. Mu më duket se data e shtatorit, nuk asht data e fillimit të vjetit, por asht data e fillimit të nji pjese të vjetit si do të shofim ma tutje. Kur të marrim në shqyrtim datat e ndryshme dhe caqet e vjetit, në lidhje me punët e popullit, do të shofim kjart se fillimin e vjetit e shenojnë festat e Shëngjergjit.

Për ket arësye në shum vende, si në Lumë dhe ngjeti, Shengjergji thirret edhe kryet e motmotit.

Me Shëngjergj fillon dhe me Shengjergj mbyllet vjeti.

Fillimi dhe mbyllja e vjetit, kremtohet me rite të veçanta dhe të shenueme. Edhe sot ka mbetë i gjall dhe vend vend shum i fuqishëm, riti i vjetër i kremtimev të Shengjergjit. Nuk ka asnji vend në Shqipni që ta ketë humbë krejtësisht traditen e këtyne festimeve.

Në kurrnji rrasë tjetër nuk merr pjesë krejt populli, me grue e me fëmij, me pleq dhe plaka, me të rij e të reja si në festat e Shëngjergjit, të cilat ndihen thellësisht dhe festohen kudo brënda familjes, nji fshati, nji krahine.

Këto festa thirren : festat e verës.Case kreu i motmotit. Sa ma i vështirë të ketë qenë dimni, sa ma e ngushtë vjeta, aq ma me shkëlqim kremtohen. Mërrijtja e Shëngjergjit tregon

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

kapërcimin e një kohës së vështirë ; ndihet shpesh ndër fshatarë të ngushtuem kah ngushllojnë njani tjetrin : « qindro dhe pak, se dolëm në Shëngjergj».

Nji muej përpara fillojnë pregatitjet : bagëtit e shënueme për kurbanin e festës dahen nga tufa dhe mbahen me ushqim të veçantë ; plaku i shtëpisë blenë ruba, qeleshe, opinga e të tjera dhurata për pjesëtarët e familjes ; gratë dhe vajzat presin dhe qepin veshje të reja për vedi dhe për të tjerë të shtëpinë. Nji javë përpara, gratë nxjerrin orenditë e shtëpisë n'oborr dhe e ngjyejnë me gëlqere përmbrenda e përjashta shtëpisë ; lajnë dërrasat dhe dyert, orendit dhe enët ; bajnë pastrim të përgjithëshëm oborreve dhe vathave dhe zhdukin çdo shej të dimnit.

Shëngjergji festohet për tri ditë rrjesht : askush nuk punon, as burr as grue ; puna në këto ditë denohet me gjithëfarë bestytnishë. Në ditën e parë të mëdhej e të vegjël, burra dhe gra, djelm dhe vajza qysh n'orët e para të mëngjezit pa zbardhë drita, dalin ndër fusha dhe mbledhin lule dhe blerime. Stolisin me lule vehten, bagëtinë, dyert dhe dritaret, almiset dhe çdo gja tjetër të shtëpisë : fshati merr nji pamje krejt tjetër.

Mandej theren kurbanet: ku nji, dy, tre e deri në katër në nji shtëpi, si mbas gjendjes dhe numrit të familjarve të sajë. Kerkush s'mbetet pa ba gjak: nji berr n'i pastë mbetë në vathë, nji pulë në kotec, ase kan e kularit pret, dhe pa kurban festa e Shëngjergjit nuk kalohet.

Mandej të veshun me petka ma të mira, tuba tuba dalin per vizita dhe pershndeten me shoqishojnë: përgëzohen që e mrrijten shndosh e mirë ket ditë, dhe i urojnë njani tjetrit Shengjergja të tjerë.

Kush ka pasë vdekje nder pjestarët e familjes mbrenda vjetit që po mbyllet, nuk ban kurbana dhe nuk del per vizita. Shokët dhe ngjitomët i dergojnë mish dhe petulla. I tanë fshati i shkon per vizitë dhe i urojnë që mos ti persritet ma vjeta e kaluemе me shprehjen tipike «mos u raftë me e harrue», dhe familjarët falnderojnë dhe nuk i këthejnë vizita.

Në të nesermen pa lemë dielli pse ke xen dielli në të shtrueme, ratë ka per t'i shkue moti, dalin e ndezin zjarme jasht fshati së bashku, në nji vend të caktuem, tradicjonal, dhe aty presin me bukë e gjellë të shtrueme, lindjen e diellit. Atje kalojnë ditën me kërcime dhe valle, kangë dhe lojna, gara dhe mujtje

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

të ndryshme. Në ket ditë dalin në shesh kámpjonët e katundit në gara të ndryshme, në kercime dhe kangë. Në ditën e tretë, rrethi i festimeve zgjanohet: defrimi shtrihet nder masa ma të gjana. Tre katër katunde, ase nji krahinë e tanë, mblidhen e e kremtojnë së bashku.

Karakteristike e këtyne festimeve janë shtregullat (shilarthat). Në Shkodër u trashiguen nji varg i gjatë kangësh e vallesh me fjalë të pershtatshme dhe ritëm të veçantë per këto lodra, të cilat thirren: «kangë shtregllash», dhe këndohen Shengjergj në Shengjergj. Këtu, festat e Shengjergjit zgjasin me javë, tue kalue prej njanës lagje te tjetra. Me rasën e këtyne festave, zhvillohen edhe perpjekje shoqnore: shit-blemje, fejesa etj. marrdhanje.

Në çdo krahinë ruhen rite të veçanta per kremtimin e festave të verës, dhe këto festime përcielien me nji varg të gjatë beslytnish.

Gjatë këtij gjysëm shekulli që kalojmë, këto kremtime kanë fillue të zhduken. Jeta moderne me vrull shkon tue shlye traditat e vjetra.

Vende vende Shengjergji ka marrë edhe kuptimin e vjetit. Ndihen shpesh tue u perdorë prej popullit shprehje si këta: «I kam kalue pesdhjet Shengjergja» ase «dikur mujshe, por sot nuk më lanë Shengjergjat» etj.

Interesante asht mënyra e njohjes së ditës së Shëngjergjit. Në çdo fshat ose lagje, mbi kreshtat e maleve ase të kodrinave, venë sheje të veçanta ku lind dielli në diten e Shengjergjit, dhe me këto sheje njofin vjetë për vjetë ket ditë.

Shengjergj në Shengjergj, bahet nji vjetë.

Vjeta ka 365 ditë që përfshihen mbrenda dy Shengjergjave.

Lindja ase prendimi i diellit, nji herë i shmanget djathtas shejit të Shengjergjit, mandej këthehet rishtas dhe bje gjithnji mbi shejin e vumë për Shengjergj, per me u shmangë majtas dhe këthehet rishtas, per të dytën herë mbi shejin e Shengjergjit.

Shmangja e diellit djathtas dhe majtas shejit e danë vjetin në dy pjesë: ditës në të cilen dielli lenë shi mbi shejin e Shengjergjit, i thonë Shenmitër.

Kjo asht e para e ndame.

Shenmitri e danë vjetin në dy pjesë ase në dy stinë të mëdha: në dimen dhe në verë.

Sot, prej kalandarit të rij, numrojnë kater stinë të zokonshme

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kalendari i popullit njef etun dy stinë. Per stinë të ndermjeme, nuk e ka kuptimin shqiptari i malit.

«Vera me lule, dhe dimni me crrule» thotë populli dhe vjeshtë e pranverë nuk i zen në gojë. Jo vetun nder rapsodi të vjetra që pranvera dhe vjeshta nuk zihen në gojë të popullit si stinë, (permenden si periudha, si do të shofim ma poshtë) por as sot, që kalendari i rij ka kohë që ka hy nder né, jashtë qyteteve, dhe fshateve afër tyne, dhe jasht mureve të shkollës, nuk njifen stinë të ndermjeme.

Per popullin t'onë, vera fillon me Shengjergj dhe mbaron me Shenmitër; dhe dimni fillon me Shenmiter dhe mbaron me Shengjergj.

Si Shengjergji, edhe Shenmitri thirret kryet e motmotit e njehen kund kund si fillesa të vjetit. Per shembull, Luma, njef dy krena të motmotit, dhe në kalendarin e punës, do të shofim se kanë nji farë analogije këto dy data.

Si Shengjergji, edhe Shenmitri festohet prej popullit t'onë me rite të veçanta. Por festa e Shenmitrit, ka bjerrë shum ma tepër se Shengjergji në ritin e festimit, kaq sa vende vende, u harrue fare. Me gjith até, nuk u zhduk krejtë ky festim.

Si Shengjergji, që thirret festa e verës, ashtu Shenmitri thirret festa e dimnit. Në malcina të Shkodrës, Shenmitri thirret edhe Shmarti ase Shen Marti.

Kjo festë kremtohet per dy dit rrjesht, dhe nder këto dy dit nuk guxon kush të prekë punë me dorë se nji mij fatkeqsi e ndjekin. Në Shqipnin e Veriut ka ngelë ma i ngjall tradicjoni i këtij festimi. Asht ma tepër nji festë familjare dhe kremtohet mbrenda rrethit të Shtëpis me pjestarët e familjes.

Edhe per Shmiter ase Shmart, ase festë të dimnit nuk mungon kurbani. Berri ma i miri pritet per ket festë, me i mbrojtë berret prej bishve t'egra që gjatë stinës së dimnit nga urija janë ma të terbueme. Thotë populli se Shmarti ja mbyllë gojen bishve të malit dhe pa ja çelë ay, bisha nuk mund të baj dam edhe sikur të bij në mes të berreve. Edhe sot ndihet në popull, per ndonjanin, që nuk flet, kur i thonë: a ta ka mbyllë I Shmarti (ase Shmartuku) gojen-a?

Në diten e Dimnit ase të Shmartit a të Shmitrit, dalin per vizita tu njani e tjetri dhe i urojnë shëqishojt per nji kalim të mbarë të stinës së vshtirë.

Me siguri edhe kjo festë, që sot po çduket, duhet të këtë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

pasë në kohë të vjetra nji zhvillim të madh, mbassi kjo ditë në kelendarin populluer ka të ujajten randsi si dita e Shengjergjit, por koha ja zhduku.

Dy stinët e mdha të vjetit, numrojnë nga 180 ditë sejcila: 180 dit verë dhe 180 dit dimën. Nder këto dit nuk numrojmë tri ditët e festimit të Shengjergjit dhe dy ditët e festimit të Shmitrit ase Shmartit.

Shprehun permbledhtas, apin ket llogari:

3	dit festa e verës	(Shengjergji)
180	» vera	
2	» festa e dimnit	(Shmitri, Shmarti)
180	» dimni	

365 ditët e motmotit ase të vjetit.

Prej kësajë pasqyrëze të vogël, na epet mundësija me bamë nji krahasim me vjeten e babilonezve dhe t' egiptianve.

Babilonezët dhe egiptjanët, në kohna faret të para, vjeten e njehen prej 360 ditësh dhe me korrektime të mavonshme shtuen edhe 5 dit të tjera. Por tue qenë se nder ta vjeta dahej në 12 pjesë të barabarta, nga 20 dit. secila, nuk paten ku me i shtue 5 ditët e reja, at-herë i lanë jashtë numrimit dhe i vunë në krye të motmotit në mes të fundit dhe të fillimit të vjetit të ri,

Kte të kujton edhe kalendari i maleve tona, ku 5 ditët nuk i numrojnë, e kjo t' ep me e mendue se nji herë edhe per ta vjeti mund të ketë patë 360 dit, të cilat i ndanë në dy pjesë të barabarta nga 180 dit sejcila. Me korrektimin e ma vonshëm, u shtuen duket, edhe pes ditët e lanuna jashtë, por nuk u shtuen si tek të parët në mes të fillimit dhe të mbarimit të vjetit, por, mbasi vjeti i tyne dahej në dy pjesë, i ndanë edhe ditët e festimit në dy pjesë, tue i lanë tri në mes të dimnit dhe të verës dhe dy në mes të verës dhe të dimnit.

Numrimi i ditëve, bahet në ket mënyrë.

Tue i njehë vazhdimisht ditët mbas Shengjergjit, p. sh. 10,15, 25, 50, 70, 120, 140, 175 ditë etj. mbas Shengjergjit; ase 20, 45, 85, 140, 175 etj. ditë mbas Shmitrit, ase Shmartit.

Në ket mënyrë u spjegue gjegja e plakut të Lumës, që më tha se: «me daten 100 mbas Shengjergjit kosisim livadhet e bjeshkës».

Por, veç kësajë mënyrë, perdoret edhe nji rend tjetër në numrimin e ditve që asht ma praktik dhe ma i perhapun.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATI" SHKODËR

Prej ditës 1, 2, 3, 4 etj. mbas Shengjergjit, vazhdohet deri në 87, 88, 89, 90 dit *mbas* Shengjergjit dhe mandej prej 90 zbritet në teposhte tue numrue 89, 88, 87 dit *para* Shen-Martit ase Mitrit deri në 4, 3, 2, 1 ditë para festës së dimnit.

Po në ket mënyrë edhe per stinen e dimnit, tue fillue me Shenmartin numrohen 1, 2, 3, etj. *mbas* Shmartit dhe vazhdohet deri në 90 e mandej zbritet 89, 88, 87 etj dit *para* Shengjergjit.

Me dhanë nji idé ma të kjartë, po paraqesim nji pasqyrë të shkurtë skematike të kalendarit të pashkruem të populit:

Per 180 ditët e verës :				Per 180 ditët e dimnit:			
1	ditë	mbas	Shengjergjit	1	ditë	mbas	Shmitrit (Martit)
10	»	»	»	10	»	»	»
25	»	»	»	25	»	»	»
40	»	»	»	40	»	»	»
85	»	»	»	85	»	»	»
89	»	»	»	89	»	»	»
90				90			
89	ditë	para	Shenmartit	89	ditë	para	Shengjergjit
85	»	»	»	85	»	»	»
60	»	»	»	60	»	»	»
35	»	»	»	35	»	»	»
10	»	»	»	10	»	»	»
1	»	»	»	1	»	»	»

Ky numrim ditësh, ma i zakonshëm dhe ma praktik, e danë verën në dy pjesë ashtu edhe dimnin në dy pjesë të tjera. E nand-dhjetëta ditë e verës, thirret mjedisi i verës dhe e nand-dhjetëta ditë e dimnit thirret mjedisi i dimnit.

Mjedisi i verës dhe mjedisi i dimnit formojnë dy caqe të reja në kalendarin populluer: dy të nen-dame të stinve të mdha.

Përcaktue mjedisi i verës dhe mjedisi i dimnit, gjejmë edhe nji mënyrë të re të numrimit të ditve të vjetit.

Tue fillue prej I ditë mbas Shengjergjit, vijojnë numrimin deri në të 89 ditë, që vjen mjedisi i verës. Mbas mjedisit të verës, fillojnë rishtas me numrim e parë tue e thirrë I ditë, 2, 3, etj. mbas mjedisit të verës deri në të 89 ditë me i lëshue rend Festave të Dimnit ase të Shmartit. Anasjelltas edhe për stinën e dimnit: Tue fillue me I ditë, 2, 3, etj. mbas Shmartit ase Shmitrit vazhdojnë deri në të 89 ditë me i lëshue vend në të 90 festës së mjedisit të dimnit; dhe mbas mjedisit të dimnit nisin rish-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARINBARLETI" SHKODËR

tas numrimin 1, 2, 3, mbas mjedisit të dimnit deri në Shengjergj ase në festat e Verës.

Karakteristike asht shkathtësija e malcorëve në gjetjen e datave, dhe shndrrimi i shpejtë prej nji mënyre në tjetrën të numrimit.

Në këtë mënyrë, u spjegua gjegje e dytë e plakut lumnjanë, i cili, tue e pamë se unë nuk e kuptova datën në mënyrën e parë, dredhoj në mënyrë tjetër, tue më thanë se: «livadhet i kosisim 10 dit mbas mjedisit të verës», si e përmendëm sipër.

Mjedisi i Verës dhe Mjedisi i Dimnit, u banë dy dit festash të veçanta që kremtohen me ritin e vet sejcila, të cilat kanë mbetë ende të gjalla në popullin t'onë, por që vend vend kanë humbë kuptimin, ndersa vend vend u zevendsuen me kujtime të reja epokash ma të vona.

Kremtimi i këtyne dy festave, të Mjedisit të Verës dhe të Mjedisit të Dimnit ruen rite të vjetra dhe tipike pagane që kanë mbetë deri sot. Këto rite, që kanë ndryshime të vogla prej krahine në krahinë, po i përshkruajmë në formë të përmbledhët.

Mjedisi i verës, me gjithë se vende-vende e ka bjerrë kuptimin, kremtohet pothuej në të gjithë Shqipninë: kremtohet ndër majet e bjeshkve të nalta, ndër malet ma në shej të nji krahine. Nuk festohet në çdo mal ase maje, por ndër vende të caktueme tradicjonale, nga të cilat per çdo krahinë ka nga nji. Disa prej këtyne maleve i shënova ndër faqet e para të këtij studimi.

Kremtimi i Mjedisit të Verës, nuk asht një festë personale ase familjare; por një festë kolektive si asht kolektiv edhe vendi i festimit. Ushqimi dhe pija që përdoren gjatë kësaj, pregatiten në mënyrë të përbashkët.

Për kremtimin e këtij festimi, mblidhet rreth e rrotull i gjithë populli i nji krahine, edhe prej 2-3 ditë rrugë larg. Formohen grupe burrash e grash, pleqsh e të rij, me kuaj të ngarkuem me plaçka të nevojëshme për shtroje dhe mbulojë dhe me berre të caktueme për kurbana.

Çka e shtynë këtë turmë njerëzish me marrë rrugë aqë të largta, të mundëshme dhe të vështira, dhe me u ngjitë zakonisht 2000 m. nalt dhe atje me ther nji kurban? Pikëpamja religjioze, që t'i premtojë për jetën tjetër ndonji meritë, nuk figuron. Por fuqija e tradicjonit asht e madhe dhe turmat tërhiqen edhe sot kur

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

kuptimi i parë, të cilin do ta shofim ma poshtë, ka humbun.

Atje nalt, natën e festës, ndezin zjarmore të mëdhaja dhe të gjithë pranë tyne e kalojnë natën me kangë e valle. Kangatarët ma në za rrethohen prej popullit; kërcimtarët ma të përmendun tërhjekin vallen; urime e përshëndetje shpërthejnë nga njani grup në tjerin.

Ndërkaq fërlikët e kuqun, tue u pjekun në zjarm, lëshojnë nji erë të kandëshme; kanga dhe vallja përcjellë me thirrje e fishkullime dhe të shtime pushkësh ndihet që larg, dhe zjarmoret e ndezuna lajmojnë edhe viset e përtejmë për festimin që po zhvillohet.

Lojna të ndryshme, dramatizime të vërteta episodesh nxjerë nga jeta e përditëshme, defrejnë popullin.

Në mëngjez, posa zbardh drtia, mblidhen pranë kronit tradicjonal dhe lajnë sytë n'ujët e pastër të gurrës. Nji ceremoni e domosdoshme: kush ngelë pa u la n'atë krue, ka lanë nji gja të madhe pa krye, pra, i shkon kot pelegrinazhi. Mandej kthehen pranë zjarmeve dhe pjekin kafe deri sa të lindë djelli. Lindjen e diellit e përshëndesin me pushkë dhe brohori e mandej zbresin ndër stane për rreth majës; qumështi e djathi, nuk i mungon asnjanit. Si hanë bukë për drekë ndër stane, përshëndeten «ndejshi me të shëndoshë», dhe miqt zbresin teposhtë, tuba-tuba, me kangë e valle.

Edhe festimi i Mjedisit të Dimnit asht interesant. Edhe ky festim shkon tue u zhdukë, por me gjithatë, aty-këtu, ka ngelë ende i gjallë sa me pasë mundësinë me formue nji kuadër nga fragmentat e ritit të herëshëm.

Traditën e vjetër të kësaj feste e gjejmë në Shqipninë e Veriut dhe veçanërisht në Dukagjin, Mirditë e Lumë. Gjurmë të vogla të kësaj tradite gjejmë gati në çdo krahinë.

Luma këtë festim e thrret Mjedis i Dimnit; Mirdita Natë këndellja; Shala, Nikaj dhe Merturi Nata e Buzmit.

Si ma karakteristik paraqesin kremtimin që i ban Dukagjini këtij festimi dhe shtojmë si plotsim të kuvendit vendet e tjera, që i krahasojmë në mes tyne.

Buzëm, ase Buzmi bujar, asht nji fjalë e vjetër, kuptimi dhe rrjedhja e të cilit deri në sot nuk u muer në studim, as un nuk mujta me e gjetë ndoj rrjedhë të sajë. Kjo fjalë asht e lidhun ngusht me kremtimin e festës së Mjedisit të Dimnit, dhe vetun në këtë rasë dëgjohet.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Buzëm, ase Buzmi bujar, thrrasin nji trung lande të madhe, të cilën e lanë veç të tjerave, shum kohë para festimit: Në çdo kohë të vjetit, kur u paraqitet nji landë e fortë e madhe dhe e bukur, e cila të jetë trup i lidhun e jo me gema e trishkuj, dhe që të marrë zjarm dhe të mbaj zjarm mirë, e caktojnë për Buzëm. Buzmin nuk e shtijnë në shtëpi, por e lanë jasht sajë, pse po hyni gabimisht në shtëpi para ceremonis, e bjerr vleftjen. Zakonisht e lanë para shtëpije në nji vend të dukshëm. Nder disa vise as nuk e afrojnë shtëpis, por e lanë në pyll në një vend që mos ta shofin kush dhe vetun naten e festës e qasin. Ndërsa në Nikaj e në Mertuer e shtijnë n'aher të bagtijve.

Në natën e festimit, ndërsa janë mbledhë të gjith pjestarët e familjes pranë votre-dhe kërkohet që mos të mungoj asnjani djali ma i shkathtë i shtëpis zbret e merr buzmin në krah. Duhet gjithmonë ta bajnë nji njeri dhe kurr dy vetë.

Në sa presin buzmin, të gjith në kambë dhe me nderim, gratë dhe fëmija, thonë:

«Po vjen buzmi bujar»
«Me bujqsi e shtri».

Ndërsa në Shalë, thonë:

«Po vjen buzmi bujar,
Me gjeth e me bar,
me edha (keca) e shqerra
mbas tyne vjen vera.»

Aj që ban Buzmin, përshëndetë n'men të tij: Mbramja e mirë burra» dhe të gjith nji zani pershndesin «Mirë se vjen Buzmi bujar». Në Fierzë dhe në Kokdodë, i përgjegjin» Mirë se vjen, me dhen e me dhi, me lopë e me mashkuj, me bereqet dhe me të gjith të mirat».

Bashkë me buzëm asht zakon të venë në zjarm edhe nji dorë shermend dhe nji dorë krande, arrë si i përdorë Dukagjini, ndersa bregu i Drinit (Fierzë, Kokdodë etj.) për buzëm, mendojnë tri copa dru bukur të trasha që baren prej tre vetësh (sejcili nga nji) të cilat janë njana prej mandi, tjetra prej arre dhe e treta prej lejthije.

Disa i thonë këtyne karthijave të Dukagjinit Buzëm, ndërsa trungu nuk asht buzmi por me mbajtë zjarmin. Këte e shofim në Kokdodë, ku trungu lehet fare jashtë, dhe karthijat trashen e i zanë vendin trungut.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me këto përshndetje, çelet festimi.

Ulen të gjith ndejë rreth votre, dhe sejcili m'at të veten mundohet me ba që të ndezet sa më mirë zjarmi. Ndezja e marë e e mirë e buzmit asht shej i mirë për shtëpi.

→ Këto ceremoni kryhen me nji bindje dhe serjozitet të madh. Rreth këtyne ceremonive s'durohet gazi ase loja. Si t'a ketë marrë krejtë buzmin flaka dhe zjarmi të jetë në zhvillim të marë, të gjithve i qeshet buza. Ndersa ndezet buzmi, digjen edhe anmiqt: çdo i shtëpis merr nga nji fije dëlli dhe e hudhë në zjarm: dhe ndersa digjet, tue dhanë krismat e zakonshme. thonë: kështu u digjshin edhe anmiqt e ata që nuk na duen të mirën.

Si të jetë sigurue mirë buzmi at-herë shtrojnë pije: raki e meze, dhe urojnë njani tjetrin. Por edhe buzmi nuk lehet pa nderë; si t'ishte nji mik i shtëpis, çdo gotë i mbushet edhe atij dhe i zoti i shtëpis ja qet për sipër. Herë nani herë tjetri, i falen edhe buzmit bujar e me i herë gota e rakis dhe mezja i hidhet mbi të.

Mandej shtrojnë buken me mish ferliku e tjera gjellë. Edhe gjatë bukës, nuk harrohet Buzmi; tash copa buke, tash djathi, tash mishi i hidhen mbi te e digjen me te.

Prej djegjes së rakis bukës dhe djathit, plaku i shtëpisë, mundohet nëpër flakë të tyne me parapa produktet e ardhshme: prej rakie frytet prej buke bereqetin dhe prej djathi bylmetin.

Mbas darke kërset kanga, dhe lojnat e zakonshme.

Në mjesnatë shkojnë në kishë.

Në Mirdifë, ku kësajë feste i thonë dit-kënellja, mbas darke, me gjith se dimën, dalin të mëdhej e të vegjël me pisha të ndezuna në dorë dhe shkojnë te gjaja dhe te bashtina me krye ceremonitë tradicjonale me pak ndryshim prej atyne që Dugagjini i krye në nesre në mëngjes.

Mbushen shpatet e maleve dhe kreshtat me drita të ndezuna që lëvizin prej andej këndej: tuba tuba njerzish me una pishe, enden prej are n'arë, prej buni në bun, tu çdo herë ase kopshtë.

Çdo i shtëpis merr nga nji dru pishe të ndezun dhe ndjek plakun e shtëpis. Ay merr dy dru prej buzmit dhe zbret tu gja ja e gjallë:

Si i avitet dhive, të gjith pjestarët e familjes imitojnë zanin e dhizve dhe plaku nëpër at dritë pishash e tymi; në mes të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

zhurmës së blegrimeve të familjarve që vazhdimisht imitojnë zanin e kafshës, shkrep dy unët e buzmit njanen për tjetren në mënyrë që të dalin sa ma tepër shkëndija, dhe thrret me të madhe: "Sa shkëndija të dalin prej meje, aq dhiz (kuer asht të dhitë, aq qingja tu delet, aq viça tu lopët etj.) dua drej teje".

Në kje se unët qesin shum shkëndija, ash shej i mirë. Mandej po me ket mënyrë, shkon edhe tu kafshët e tjera, gjithnji i ndjekun prej pjestarve të familjes, me pisha të kalluna në dorë, dhe tue imitue zanin e kafshës, fërkon unat dhe ban pyetjen.

Mandej shkon tu secila arë, dhe tue fërkue gjithnji unat njanën për tjetren, i flet: Sa shkëndija dalin prej meje, aq karriqa (emnon bimën që ka mbjellë ase ka ndërmend me mbjellë n'at vjetë); e kështu arë për arë dhe kopshtë për kopshtë; mandej fillon pemët frytëndhanse tue i folë n'at mënyrë setciles.

Në Dukagjin, kjo ceremoni e Mirditës kryhet në nesre, me nji rit tjetër:

Në diten e nëserme, pa zbardhë drita, plaku i shtëpisë, merr spatën me vedi në cep të krahit dhe i ndjekun prej familjarve që marrin me vedi bykun që në darken e Buzmit i kanë shtrue sofrës, dhe hinin e buzmit, që janë mundue me e ruejt veç, dhe dalin n'arë.

Para çdo peme frytdhanse, ndalet plaku, dhe tue ju matë me spatë i kërcnohet: «A do të bajsh fryte sivjet a të preva?» Dhe pjestarët e familjes që e ndjekin, dhe fëmija i përgjegjin n'emen të pemës: «Mos më pre se nuk të le pa gja». At-herë ulë spaten dhe i hjedh pak hi prej Buzmi dhe kashtë byku për shej të mirë.

Mandej të gjith sëbashku, shkojnë në lanë të gruni dhe shtrojnë bukë e djathtë dhe laknuer e hanë nifen. Aty mblidhen edhe shokë që e kanë krye ceromonin në lanë të vet e sbashku hanë buken e mëngjezit.

Si mbarojnë buken, përhapin nëper lanë pak hi prej Buzmit dhe byk të shtruem nën sofrën e darkës së festës, dhe këthehen kah shtëpija.

Në ditën e festës, kalojnë për vizita shtëpi në shtëpi dhe kudo laknorë (karakteristikë në kësajë festë, kaq sa vend vend thirret edhe festa e laknorve) raki e meze shtrue. Urime gjithfarësh bahen me këtë rasë, por të rastit janë urimet e shndetës së familjarve, të shtojës së tyne, të gjas së gjall dhe për bylmete dhe bereqete.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Interesant asht serioziteti nder këto ceremoni të cilat kryhen edhe prej pleqve e të rijve me bindje dhe nderim të vërtetë religjoz.

Si shifet, kristanizmi u dha këtyre festave ngjyrë kristjane dhe krejt riti i vjetër kryhet sot natën e kështnellave, me gjithë se nuk ka të bajë gja me lindjen e Krishtit.

Si mbas shënimeve te deritashme, dalluem kater cage të vjetit: kater data që pjestojnë vjetin në katër pjesë, të cilat i përgjegjin pak a shum katër stinve të vjetit sikur e kemi sot, por si thamë edhe sipër, tek të parët t'anë, katër stinë nuk u njifshin; Stinët ishin dy, dhe pjestohesheshin rishtash për dy: tue u thirrë gjysa e parë dhe gjysa e dytë e dimrit; ashtu dhe gjysa e parë dhe gjysa e dytë e verës, të cilat gjysa kishin ndërmiet festat e Mjedisit të Verës dhe të Mjedisit të Dimnit.

Por kalendari primitiv i popullit t' onë na ep edhe njisi ma të vogla, nën-damje të reja, të cilat burojnë prej të ndames së dytë : Seicila prej katër pjesve të vjetit që folëm ma sipër, me nga 90 ditë, mund të pjestohet rishtas në dy pjesë dhe na falin të ndame të reja me nga 45 dit sejcila.

Edhe për sejcilën nga këto frakcjone ma të vogla, kemi gjithnji nga nji ditë festimi, që kremtohet me ritin e veçantë në vetin.

Në mes të Festave të Verës (Shëngjergjit) dhe të Mjedisit të Verës, kemi Festën e të Korrunave ase të Qethjeve (Shëngjinin). Në mes të festave të Mjedisit të Verës (festat e Bjeshkës) dhe të Shmartit (Shmitrit), kemi festat e të Vjelunave. Në mes të Shmartit dhe të Mjedisit të Dimnit, kemi festat e Karstovit (Luma) Shënkollit (Viset e tjera të Veriut). Në mes të Mjedisit të Dimnit (Dit-kndelles, festës së Buzmit) dhe festave të Verës (Shëngjergjit) kemi ditën e Verës ase ditët e Verave.

Në vija të përgjithta, po rrjeshtojmë ritin e veçantë të këtyne festimeve.

Festa e të korrunave ka dy faza zhvillimi: nji festë e veçantë dhe nji e përbashkët.

Zakonisht nji fshat ka nji lamë të përbashket shimjeje gruni. Kur fshati asht i hapët, dhe lagjet janë të mdhaja, çdo lagje ka lamën e vet.

Mbas korrjes së grunit, i tanë fshati ase çdo lagje, si mbas familjeve, e barin grunin pranë lamës. Mandej fillon shimja.

Në të shime të grunit, bashkëpunojnë të gjith fshafarët, me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

i ndihmue njani tjetrit. Ma pak që punojnë janë pronarët e grunit që shihet, pse ata n'at ditë kanë ma tepër për t'i bamë nderë falanikve (shokve që i ndihmojnë). Si të shihet gruni, bahet gosta që shtrohet prej shtëpisë pronare të grunit, me mish e pije. Kështu me radhë në çdo ditë bahet nga nji gosti, ku merr pjesë i tanë fshati ase lagja, si mbas rastit. Gostat e grunit ngjasin me javë, deri sa të jetë krye krejtë shimja.

Mandej vjen festa e grunit ase e të shimeve e cila thirret «të çuemit e lamës». Mbas kësaj feste nuk shinë kush grunë n'at lamë për at vjetë.

Të çuemit e lamës asht mbyllja e 2-3 javëve festa të katundit; asht nji feste e përbashkët dhe kremtohet me rite tradicjonale solemne.

Në mbrame mbas darke mblidhet marë fshati në lamë të grunit dhe aty ndezin zjarmore të mdhaja me byk; si thohet, ndezet për me ja këthye tokës pjesën e vet. Në këto zjarmore, mundohen me ja kalue naltësin e flakës njani tjetrit. Mandej nisen të shkapërcehen: burra dhe gra, pleq dhe plaka përshkohen nëpër flakë. Me gaz, kangë dhe kërcime, kalojnë natën e festës së korrunave, deri nder orët e vogla të mëngjesit. Me urime që i drejtohen njani tjetrit, shperndahen. Në ditën e nesërme sejcili merr pak asi hini, dhe ja qet arës «me ja kthye tokës bereqetin»; pse, po nuk u ba ashtu, në vjetin e ardhshëm toka nuk prodhon. Shëngjinat (ase flakadajt) tek populli i ynë festohen në fund të qershorit, shi në kohën e të korrunave, dhe jo prej barijve, por prej bujqve, jo me sanë por me byk (dhe në kurrnji rasë me landë të tjera), dhe kjo i ven në lidhje direkte me të korrunat, si festë bujqësore.

Paralel me këtë festë, që asht e bujqësis, vjen festa e bleg toris, të cilat edhe sot asht e gjallë dhe e fortë në çdo skaj t' atdheut t' onë.

Edhe këjo zhvillohet me radhë, për me i lanë shteg me marrë pjesë si njani, tjetri.

Bagtija në ditën e qethjes nuk lëshohen prej vathësh. Deri sa të kryhet e mbramja, rrinë në vathë. Për këtë arsye duhet që të qethen deri në drekë. Të gjith barijt e fshatit marrin pjesë me i ndihmue me qethë delet njani tjetrit.

Vatha dhe deshët zbukurohen me lule. Ma parë pritet kurbani, i cili nuk duhet të mungojë. Mandej dora dorës fillon qethja. Po pa u krye qethja nuk shtrohet buka. Si të jetë qethë

BIBLIOTEKA PUBLIKE MARIN BARLETI SHKODËR

e mbramja dele, lahen deurt dhe gërshanët në nji enë të veçanët, dhe me roje, të mos derdhet asnji pikë asi uji në tokë, pse i shkon bereqeti. Aj ujë, tanë smojë leshi, i dahet çdo deles dhe i hidhet mbi kokë dhe trup, dhe thohet «me ja këthye bereqetin». Urime të veçanta për këtë rasë shndrohen në mes të barijve, dhe mandej shtrohet gosta e të qethunave me kangë e valle. Ndërsa siellen ferlikët, gotë mbas gote përcillet rakija me urime e kangë.

Këtu kemi nji analogji në mes të hinit të lamijeve në festën e të korrunave dhe ujin e deleve në festën e të qethunave, që ja këthejnë bereqetin prodhueses.

Edhe Zoja e të Vjelunave ase festa e të Vjelunave, ka ardhë tue u zhdukë. Porsa ndihet aty këtu. Edhe kjo asht nji tepricë e kalendarit të vjetër. Nga riti i kësaj festë ka ngelë vetun gosta tradicjonale e të vjelunave, e cila përciellet me këngë e valle, me lojna dhe argëtime të ndryshme.

Në festën e të vjelunave nuk merreshin puntorë me pagesë, si merren sot, por shokë e të njoftun, mblidheshin dhe ndihmojshin në të vjelun të vneshtave. Rrushi në këtë dit ishte i shtruem për ke do që sillej andej pari po ashtu dhe dreka.

Paralel me këtë festim ka ngelë edhe festa e blegtoris e lëshimit të fushës. Me festën e të vjelunave fusha lëshohet: gardhijet thyen, livadhet shturen. Ç'me këtë festim çobani mund të kullosë ku të dojë bagtinë dhe nuk mund t' i thotë kush mos hyn këtu ase mos del atje: Mbas Festës të së Vjelunave, gardhijet ngelin si rrënojet e nji kështjelli të bragtisun.

Rrushi asht prodhimi i fundit, me te kryen puna nder fusha e ara, n'anë tjetër, për blegtorin fillon koha e ngushtë e mungesës së kullosës, prandaj të gjitha arat bahen të përbashkëta.

Lëshimi i fushës, që bahet në nji ditë me festën e të vjelunave, asht nji ditë feste edhe për barij të cilët e kremtojnë me kurbana dhe nuk e thrrasin festa e të Vjelunave, por festa e lëshimit të fushës.

Në rrethet e Gjinokastrës, prej ritit të vjetër, ka ngelë përtrimja e brumit të rij të bukës me rasën e festës të së vjelunave: Prej rrushit të vjelun dahen dilet e papjekme dhe langu i tyne mbruhet me miell dhe përtrihet tharmi i rij i bukës.

Me këtë tharmë, tue e rruejtë prej çdo të gatuemes, shkohet nji motmot rrjesht, deri në festën e të Vjelunave të vjetit të tjetër.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Festa në mes të Shmartit (ase Shmitrit) dhe të mjedisit të Dimnit, asht zbe ma tepër se çdo festë tradicjonale tjetër. Luma thrret këtë ditë festimi Kerstov, viset e tjera e thrrasin Shënkolli, dhe e përziejnë me Barbulleshen (Sh. Barbara) ase me «Zonjën», që e thrrasin «E motra é Shënkollit; ndër disa vise e kaluen edhe në Shën Mhillin. Tharmi i kësajë feste u shpërnda ndër festa të tjera, dhe kush e kaloj në njanën e kush në tjetrën, në mënyrë që u errsue.

Me humbjen e gjurmave të kësajë feste i ka humbë edhe riti i vjetër i festimit.

Vetun nji gja ka ngelë, që asht karakteristike e të gjitha festave tradicjonale, kurbani. Nuk asht shtëpi në mal ase në fushë, muhamedane ase kristjane, që nuk ban gjak për Shënkoll ase Kerstov.

Ashtu nuk mungon edhe qiri, më dyll blete, i bam kulaç, në formë të gjarpnit, që ndezet në ket festë. Thohet se motit në vend të qirit digjëshin në zjarm herë mbas here copa dyllit.

Kur shtrohet darka e Shënkollit, dhe kur ndezet qiri, hapen dyer e dritare që të hyjnë edhe shpirtnat e të parve me marrë pjesë në këtë festim.

Në mes të Mjedisit të Dimnit, dhe të Shengjergjit ka ngelë e fortë dhe e gjall sa kurrnji tjetër Dita e Verës.

Riti i kësajë feste ka ngelë i gjall në të gjith Shqipnin, por në nji mënyrë të jashtzakonshme e ka ruejtë Luma.

Kurbani nuk mungon n'asnji shtëpi: prej kaut e në pulë, që flijohen për ket festë, nuk mungon n'kullë ase në kësollë. Me ngelë pa ba gjak në ditën e verës, asht mjerimi ma i madhi për nji zhtëpi malcore.

Në mëngjes, pa zbardhë drita, në kraninë të Lumës ziejn kunguj misiri dhe i pregatisin me i hangër ma vonë. Pa shti gja në gojë, as kafe as bukë, gjithnji pa lindë dielli, mbiidhen tu kroni dhe lahen e mbushin emën me ujë të freskët.

Mandej këthejnë në shtëpi, dhe ulen e hanë kungujt e ziem, pijnë kafe dhe pershndeten me shoqi shoj, gjithnji pa lindë dielli.

Mbas përshëndetjes, burrat therin kurbanat dhe fëmija, pa folë me njeri dalin nder ara me kerkue ndoj shej blerimi ase jete së re që xën të ngjallet. Kërkojnë lule ase bar që ka mungullue, kandrra ase krymba që kanë nisë me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D Ë R

dalë, dhe kur nuk mund t' i gjejnë, kërkojnë edhe nën tokë, shpesh edhe nën dëborë, që zakonisht në malci në këtë kohë mbulon gjithnji dheun, dhe pa i gjetë nuk rrinë. Gjithnji pa folë me njeri, dhe pa çelë gojë, i aviten shtëpis, dhe i lëshojnë za zonjës së shtëpis: «Oj nanë!» dhe nana i përgjegjë nga mbrenda : «çka je tue pru ?» dhe fëmija : «dhizë, shqerra. cull etj.» Nana at-herë del te dera dhe thrret : «Ik buba e zezë, dhe eja buba e bardhë» (buba-fati). At-herë fëmija hyjnë në shtëpi dhe hjedhin në mes t'odës shejet e para të pranverës. Burra dhe gra, pershndeten me shoqishojnë, «na ardht vera me bereqet» dhe fëmijve që sollen shejat e pranverës i falin arra, fiq të that, petulla etj.

Mandej ulen e han drekën.

Mbas-dreke kalojnë në vizita te njani tjetri, dhe me urime të shumta presin e përcjellin shoqi shojnë.

Kah mbramja i tanë populli derdhet nëpër fusha tue këndue valle.

Me kaq mbaron rrethi i festave tradicjonale të popullit t'onë që përmban kalendari populluer.

Po të vërejmë në përgjithsi këtë kalendarin t'onë primitiv shofim se nuk asht tjetër veç kalendari i fazeve të ndryshme të natyrës; i festave të prodhimit.

Kurdo herë dielli asht mbajtë burimi kryesuer i mirsive të natyrës, prandaj ndër të gjith popujt primitiv dielli u hyjnizue dhe njehej nji nder hyjnitë ma të para.

Edhe në popullin t' onë gjejmë shum gjurmë hyjnizimi të diellit, siç janë betimet: «Për at diell», «për at rreze drite», «për at të pashue» etj. Një shembull tjetër: në mëngjez malcori i ynë, sa bije rrezja e diellit mbi te, siellet e ban kryq (përshtat ritin kristjan kultit të vjetër).

Kur vdes njeri, dhe mblidhen me i bamë gjanën, e venë pështetun për nji pemë tradicjonale, gjithherë me fytyrë kah dielli, tue e sjellë kufomën reth e reth rrugës, që të ketë pozicjon kah dielli.

Të gjitha këto provojnë kultin e diellit tek ne.

Edhe kalenderi ynë e ka burimin në këtë kult.

Në kalendarin e sotshëm, të pshtetun në sistemin luni-solarë, vjeta pjestohet nder dymbdhjet muej nga 30 dit, të marrun nga fazet e Hanës prej Egjiptjaneve të vjetër. Nga kalendari ynë primitiv resulton se vjeti pjestohet ndër tetë perjudha, ose muej

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODËR MARIN BARLETI

mund t'i thrrasim (por se populli nuk i njef me ket emen) me nga 45 dit sejcili. Katër prej tyne bajnë pjesë të stinës së dimnit, dhe katër në stinën e verës.

Tetë dyzetepesditshat, ase muejt si mund t'i thrrasim sot, paten edhe emnat e vet sejcili, pesë nga të cilët, mujta me i gjetë në popull, ndërsa tre kanë humbë:

Emnat e muejve të verës kishin me kenë këto:

1) . . . . . .
2) Korriku
3) Djegaguri
4) Vjeshta.

Emnat e muejve të dimnit, kishin me kenë:

1) . . . . . .
2) Brymsi
3) . . . . . .
4) Pranvera.

Emnin e dyzetepesditshit të parë të verës, nuk mujta me e gjetë; ndoshta qe qershor. Ashtu edhe dyzetepesditshit të parë të dimnit i ka humbë emni. Dyzetepesditshi i tretë i dimnit ndoshta thirrej «ngrijsi» mbasi shpesh ndihet në popull: «ende s' ka ardhë ngrijsi» ase «nuk ka ra ngrija» ase «berret hyjnë në grazhd sa të bijnë ngrija» etj. shembuj të tillë.

Me hymjen e kalendarve të ma vonshëm, u moren uhâ disa emna prej kalendarit të vjetër, dhe u përshtaten me tregue ndamjet e reja: me tregue stinët, u muer emni i pranverës dhe i vjeshtës; dhe për me shenue muejt, u muer emni i korrikut dhe ju pshtet nji kohës që nuk ka lidhje me te, dhe me emnin e tij, pse në korrik të korrunat kanë krye dhe festa e tyne ka kalue.

Në kalendarin e sotshëm kemi javën si njisi matieje kohe në mes të mujit dhe të ditës, të uhajtun prej kalendarit të vjetër hebraik. Në kalendarin t'onë populluer me gjith se java u njoft ç'prej kohësh, nuk bani pjesë n' organikun e tij, pse java kishte nji burim sinodik, ndersa në kalendarin t'onë nuk tregohen kerkund gjurmë të sistemit lunàr.

Me nji skicë skematike munt të paraqitesha kështu struktura e kalendarit primitiv

3 ditë Shengjergji
45 ditë —
të korrunat
45 ditë —

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

	Mjedisi i Verës
45 ditë	—
	të vjelunat
45 ditë	—
2 ditë	Shmarti
45 ditë	—
	Kerstov
45 ditë	—
	Mjedisi i Dimnit
45 ditë	—
	Dita e Verës
45 ditë	—
	(prap Shengjergji)
365 ditë	= vjeti.

Detyra jonë asht tash me gjetë datat që i përgjegjën në natyrë festave të këtij kalendari. Prej tetë festave të tija, që zumë në gojë ma sipër, dhe që kanë ndërmjet tyne nji distancë të caktueme, mjafton të përcaktojmë njanën, pse mandej të tjerat në mbështetje të kalkolimit e gjejnë lehtësisht vëndin e vet.

Si të parë dhe ma të lehtë për vendosje marrim Mjedisin e Dimnit o Dit-kndelljen ose Natën e Buzmit. Mjedisi i Dimnit kremtohet pse «dielli siellet prej vere», thonë malëcorët e Shkodrës; pse «dielli kthehet marë», thotë Luma, ndërsa Mirdita e quen Ditë kndellje, pse «dita xen e kndellet (ngjallet)»; «Këshndella e verës», thotë Shkodra, dhe «këshnellash dita zen e rritet sa këcen gjeli tra më tra»; këto thanje popullore e venë Mjedisin e Dimnit shi me solsticin e dimnit.

Ndër vende ku influksi kristjan qe ma i fuqishëm, Mjedisi i Dimnit u zavendesue me Krishtlindjen. Edhe riti i këtyne festimeve tregon diçka t'afërt me solsticin e dimnit.

Dalja në mesnatë, si festohet në Mirëditë, me pisha të ndezuna, si dhe zjarmoret e mdhaja janë sintomatike. Edhe Buzmi s'asht tjetër veç shëmbllesa e diellit, Urimet që i bahen Dimve dhe kafshve, lama e grunit, parashikimet për prodhimet e reja, nuk kanë lidhje me Krishtlindjen por me fenomenin e natyrës që zhvillohet me solsticin.

Edhe antiteza e tij, Mjedisi i Verës, që në Dukagjin thirret edhe festa e Bjeshkve, nuk asht tjetër veç se solstici i Verës.

Thanja popullore «hangre fikun, pregatit leshnikun» tregon se me pjekjen e fiqve Shngjinsa (24 Qershor), kaluem gjysen e stinës dhe drejtohemi nga dimni. Edhe thanja: «Këshndella e Verë e Shëngjin e Dimen».

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S.H.K.O D.E.P.

Përcaktue dy data prej tet caqeve të kalendarit të vjetër, përcaktohen lehtë edhe datat e tjera tue u vumë në vendin që i përket.

Si pamë sipër, dy mjedisat e stinve, i përgjegjin dy solsticave të vjetit. Por tue qenë se si mbas llogaris së pame sipër, 90 dit para njanës dhe 90 dit mbas, ashtu 90 ditë para tjetrës dhe 90 dit mbas, kemi krenat e motmotit ase filiimin e stinës, gjindet lehtë se Shengjergji ase Festat e Verës dhe Shmarti ase Festa e Dimnit, nuk janë tjeter jasht dy ekuinoceve të vjetit: i pari ay i pranverës dhe i dyti ay i vjeshtës.

Kalendari primitiv, i popullit t' onë nuk pat qëllim të masi kohën, sa pat qëllim të rregullojë punët e përditshme të popullit si mbas kohës, prandaj ky kalendar pikësëpari asht kalendari i punve të popullit, asht kalendari i jetës së tij. Datat e tija janë caqe pune; caqe marrveshjeje dhe mardhanjeje me njani tjetrin; dhe nji heri janë pika defrimi e shplodhjeje.

Po të këputej studimi me kaq, tue lanë jashtë pjesën e tij praktike, aplikimin e tij në jetë, nuk e kemi skjarue krejt kuadrin e tij.

Kryet e mot-motit; festat e Verës; Shëngjergji:

Në këtë ditë vendohen shtëpijat me qira;
ndrrohen rrogtarët dhe shegertat;
merren çobajt (për nji vjetë ase gjasht muej)
epen dhe merren bagtija me pagesë;
dahen qingjat ase dhizt prej berreve;
fillon mjelja e bagtive;
fillon qethja e berreve;
fillojnë pregatitjet për bjeshkim;
fillon mbjellja e misrrit.

Festat e të korrunave; Shëngjini:

Bjen kosa ndër livadhe;
dhe drapni ndër grunaje.

Mjedisi i Verës; festa e Bjeshkës e Tomorit etj.

Fillohet me vu dushk për bagti;
nisë korrja e misrit.

Festa e të vjelunave:

Fillojnë vjeljet ndër vneshta;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

fillon pregatitja e tokës për të lashta;
ulen bagtija prej bjeshke;
fillon mbarsja e tyna;
bahet qethja e dytë;
lehet mjelja;
lëshohet fusha.

Festa e dimnit; kryet e motmotit; Shmarti; Shmitri:

Ne ket ditë vendohen rrogtarët;
epen bagtija me pagesë;
kryen mbledhja e të lashtave;
aviten drutë për dimën.

Kerstovi ase Shenkolli:

Në këtë ditë të gjitha punët duhet të jenë perfundue.
Priten bagtija e shënueme për ushqim dimni (pasterm).
Punët mbarojnë.
Populli thotë për ditët që ndjekin:
digj e piq;
bluej dhe rruej.

Mjedisi i Dimnit; ditë-këndellja; buzmi:

Bagtija lëshohen në grazhd;
nisin berret pjelljen;
bujku pregatit almiset;
nisë krasitja e pemve.

Dita e Verës: e Verave etj.

Fillon puna ndër ara;
mbiellen farishtet;
pertrihet shqila (tharmi i djathit) e re.
Kjo perjudhë kohe që ndjek, asht ma e ngushta për malcorin, prandaj e thrret: moti i shlinës, pse të gjitha pregatitjet e dimnit janë në të sosun: bylmeti i rij ende s' ka fillue.

Ky asht plani i punës, i trashigueme me qindra e qindra vjetësh, që ka mrrijtë i gjall mje ke breznitë t' ona.

Sa besnikë i rrinë këtij plani shnetarët t' onë, asht për tu çuditë: kur ndo njani nuk mrrinë me e plotsue punën e nji perjudhës deri në kryet e saj, d.m.th. në festën e sajë ankohet prej të gjith shokve, pse perjudha e re siell punët e veta me vedi, dhe ay ngelë mbrapa. Por zakonisht, shokët e fshatit nuk

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

e lanë kurr nji bashk-fshatarë mbrapa, por ndër ditët e fundit, mblidhet katundi e i ndihmon me falanikë, si i thonë puntorve ndihmësa.

Vjetrimi i Kalendarit e shtyni tepër kohën, dhe datat e tija sot nuk janë tue ramë shi me fenomenet e natyrës, ku e patën origjinën, dhe mi kohët e punës që ato patëm caktue në fillim.

Prandaj shofim se herë mbas herë krijohen data të reja, të marruna uha prej kalendarëve ma të rij, me ngjyrë fetare, si caqe të kohës dhe të punës.

RR. ZOJZI

RÉSUMÉ

L'auteur étudie la division du temps, l'année et ses subdivisions, en commençant tout d'abord par le calendrier usité chez les tribus montagnardes de l'Albanie du Nord. D'aprés ce calendrier, l'année commence aux fêtes d'été (Saint Georges), en Avril-mai, et a deux saisons principales: la première commence à la date susindiquée et finit en october-novembre (Saint Démétre), date qui marque à la fois le début de la deuxième. Le calcule du temps s'effectue en comptant de un à 180 à partir des fêtes d'été ou bien en comptant de là 90 après ces fêtes, et et en recommençant jusqu'à 90 avant Saint Démétre. On agit de façon analogue pour l'hiver. Par des fêtes traditionnelles de moindre importance, on établit des unités de temps qui ressemblent aux mois du nouveau calendrier. De cette façon on établit une division schématique de l'année en huit étapes de 45 jours chacune; en ajoutant à ces étapes les trois journées de fête de Saint Georges et les deux journées de Saint Démétre, on obtient le total de 365 jours. Les quatre saisons, les mois et la semaine qu'on calcule d'après le nouveau calendrier, sont inconnus.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Keq, i keq

K CIPO

Fjalorët tonë shënojnë vetëm një kuptim për ato dy fjalë, kuptimin që dimë të gjithë dhe që është'i përkundërti i së mirës: njeri i keq – njeri i lik; foli keq – foli liksht, tjetër s'kanë. Pse nuk regjistrojnë edhe domethënën tjetër që është'e gjallë në gojë të popullit dhe e përhapur në literaturën popullore të shqipes në proz'e në vjershë, ne nuk e dimë. Ky kuptim i dytë, për të cilën duam këtu të thomi dy fjalë, është, për adverbin: «keq» = *fort, shum, tepër,* dhe për adiektivin: i keq = *trim,* i *fortë, që s'i trëmbet syri,* që *të merr gjak në vetull,* etj. Pikërisht këtë domethënë të dytë kanë shprehjet popullore: *trim i keq, hajdut i keq* dhe shumë tjera. Nuk vetëm në folklorin tonë është i gjallë ky kuptim, po edhe në veprat e Naimit, në shkrimet e vjershëtorëvet arbreshë e kudo gjëtkë. Tani duam të mësojmë si e muarnë ato dy fjalë domëthënën e dytë, atë të «terribilis», «fortis», «horrendus». Nuk jemi lark së vërtetës në thënçim që ideja e së keqes nuk çkoqet dot lehtë nga ajo e *dhunës,* e *tmerrit,* dhe nga ajo e *të matht,* sepse ideja e tmerrit është' afër me atë të të matht, dhe këtë të vërtetë do ta dëshmojnë shprehjet që do të marrim hua nga folklori, nga veprat arbreshe dhe nga prodhimi letrar i Naimit, nga Josif Bageri dhe nga tjerë.

Një shembull në prozë:

«E si nëmëroi mizat kaçi, zuri dhe haj buk; atje nekë haj, u sillois e tha me mende të tij që u ç'rri e bij kaçllëkun, që u jam kaqë *trim* i *keq* sa vrava mëndëdhjet' e nëndë trima edhe një kapetan një qind.»

(Alb. Texte mit glossar)
H. Pedersen

Shembulla nga poezia popullore:

Unej Kolen nuk e due
Unej Kolen *keq* e drue (= fort).
Kam nji gjak pa pajtue
(K. Popi)

«Hajn buk si di vellezer
di ushtërtorë *të keq* (= të tmerrshëm)
(Skanderbeku e Miloshini)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

Porsa *keq* nd'at Anapull (= fort)
të njoma ndë limonti
dihen vashazit e ngrisen
(Kushqim i Skanderbekut)
Menatet kur na u nis
Skanderbeu *keq* i sbet (= tepër)
keq i sbet e i smundëm.
(Skanderbeku e Vdekja)
Nga Istor. e Skënd. e Naimit
Një zi e *keqe* kish rënë (e tmershme)
(f. 49)
Me kordhatë *të këqija* (= të tmershme)
(f. 38)
luft' *e keqe* (= e madhe, e tmeruar)
(f. 165)
Nga Josif Bageri
gjith korpi zu të thahet e të zbehet *keq* (= fort)
Ilaga keq zu të madhohet
gjaja *keq* u ka dobsuet (= për së tepri)
keq u çkurazhuen dhe u dëshperuen
(kopësht Malësori)
Nga Mitko-ja
jam rarë *keq* (= ngushtë)
kur e pa të goditurë djalin
aqë *keq* mbë vajzën (= fort)

Nga këto shembullà që suallmë, dhe nga dy tjera që do të shtrojmë këtu, do të mundim të zëmë mbë flur atë që duam të gjurmojmë.

Në faqet (46) të Istorisë së Skënderbeut lexojmë këtë varg: «me një tmerr të keq u mblodhë» dhe në faqet (285) të së njëjtës vepër gjejmë vargun: «q'ish i keq e i përdhunë» Nga ïërë këto shembulla nxjerrim si rezultat se adjektivi *i keq* dhe adverbi *keq* u shoqëruakan, sikundër thash' edhe më sipër, fort kollaj me iden' e *tmerrit* dhe të *dhunës*, dhe se vargu «me një *tmerr të keq*» do të thotë me një *tmerr të math*.

Ky interpretim munt të dalë edhe m'i qartë nga një shembull që kemi gjetur në Iliarin e parë të Iliades, të shqipëruar nga Naimi, ku formyla homerike: «deine dè klagge» është përkthyer: «vringëllim i keq» vringëllim i tmerrshëm, i math. Edhe këtu, sikundër shihet, ideja e së keqes nuk ësht shqepur

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

nga ajo e tmerrit. Naimi e kish kuptuar se, duke shqipëruar fjalën «deine», që do të thotë «terribilis, horrendus, me fjalën «i keq», kish gjetur adiektivin më të përshtatur dhe kjo gjë ka rëndësin' e saj në rasën tonë konkrete, sepse Naimi, të cilit i burojnë adiektivat si rruaza nga penda, munt të kish përdorur një tjetër në vent të fjalës «i keq». Edhe fjala latine «scaevus» gjen një paralelizmë me shqipen tonë *i keq*, një paralelizmë historikisht të pavarur, natyrisht. Scaevus, që do të thotë *i egër, i bushtërt*, në latinishten e lashtë kish marrë kuptimin *i math*, sikundër e vërteton edhe gramatikani Servius, i cili thotë: «Scaevam dicebant veteres magnam». Tani vjen një pik' e dytë për të zgidhur: si ndodhi që adiektivi *i keq* ose adverbi *keq* të përdoret në fraza si këto që po shtrojmë: është *keq* njeri i mirë (= fort)

(Qerbela 132)

Sulltan Murati e donte *keq* Skënderbenë (= fort)

(Ist. e Skend. 39)

i cili *keq* u këndell (= bukur, fort)

(I. Bageri)

ta doni *keq* Perëndinë (= shumë)
po bashkë me Shqipërinë

(Parraisa 89)

helminë vetëm ka grera
vetëm gjembatë ka ferra
nuk' është si trendafili
q'e do aqë *keq* bilbili (fort, shum)

(Qerb. 345)

Si rrodhi, pyesim, që adverbi *keq* të përdoret njitas me adiektivin *i mirë! keq njeri i mirë* me kuptimin: *fort njeri i mirë*.

Ne jemi të mendjes që dotë jetë përdorur fjala *keq*, e shoqëruar më parë me fjalë që përmbyllin idenë' e tmerrit si: *keq i helmuar, keq i sëmurë, keq i vrarë, keq i llavosur*, «janë keq më shum tharëtirat. . . .» (Santori) etj. dhe pastaj dal-ngadal, filloi të përdoret e shoqëruar me fjalë që janë lark fort nga ideja *e tmerrit*, e të të matht si: «keq jebutt e ambëlore» (Santori), keq i mirë; ato rrobe i ndejkan keq = i ndejkan bukur.

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

Të njëjtin proces do të ketë bërë edhe verbi greqisht πάσγω. Pa u thënë εὖπασχω, do të jetë thënë më parë κακῶς πάσχω gjersa një ditë u gjet me vend të perdoret εὖ πάσχω pa formuar aspak ὀξύμ ϱον.

RÉSUMÉ

Au sujet d'une innovation sémantique des mots *mal* et *mauvais* et de leur évolution.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

FJALË TE PAMBLEDHURA

DH. S SHUTERIQI

G

Gardhë-a = vegël qi hyn në punë për të gërrye nji vijë pak a shum të fellë reth e përqark anëve të bucelave ose fundeve të kadeve, përmbrenda, për të futë aty ballet e bucelës ose fundin e kades. Tho het dhe *gardhëna* (P). Edhe vëndi i gërryem quhet po *gardhë*.

Gardhëna-ja = gardha (P).

Gaxhë-a = lloj bari. Thohet edhe *ferrë gomari* (B).

Gaxhë-a = v. *cergë-a* (B).

Gëllushtër-a = trumë lulje, si buqetë. Thohet vetëm për nji lule të madhe. «Lulja e *linit* asht gëllushtër, lulja e *lajthatës* asht e hollë e e gjatë» (P).

Gërbuc = njeri që ecën i thyem, po qi s'i ka dalë kurrizi (B).

Gërriaçkë-a = bimët ose bitmet e reja qi, sapo dalin, u hanë gjaja majën dhe nuk rriten fort. Thohet edhe për nji dru qi hapet mbas dheut ose për nji dhi me brij të shtrimë nga pas (P).

Gërresë-a = v. *kizë-a* (E).

Gësterrë-a = v. *sohije-a* (P).

Gëthomë-a = kufomë, stërvinë. Thohet edhe për nji kafshë fort të ligët (P).

Gidhët (i, e) = i lirë që len të kalojë ujët (fr: *përméable*). «Druja e vgjenit nuk ban për bucela, se asht e gidhët e rrjeth ujët. Ajo e artirit, po.» (Sh.) Druja e gidhët çahet letë nga fija e saj. E kundërta asht: *i, e lidhët*, (Sh).

Gobitë (me u) = me ba çudi të madhe (P).

Gogës-i = *gramsina* ose *grafsina* (Sh).

Gogësij = nxjerr gramsina (Sh).

Gojëmarraq-i = njeri të cilit i merret, i mbahet gjoja (P).

Gojëprishë-i = njeri qi prish, qi ndyen gojën (E).

Gorgë-a = hurdhë e fellë në lum a në liqe (E).

Gorgë-a = xixë, shkëndi e zjarrit(P)

Gorxhë-a = hurdhë me uj të pakë qi buron në vend dhe qi përdoret për të pi në malsina ku mungon ujët (P).

Gorrik-u = saç për të pjekë bukë, po prej balti dhe jo prej hekuri. Ka formën e saçit prej hekuri dhe ka vegjë si ky. Përdorej së lashti në Sh. Përdoret tepër rrallë edhe sot në Fushëbull të P. (P. Sh).

Grafë (me i) = me i britë ndokujt me të keq (E)

Grafme (të) = të britme me të keq. «Seç më priti me nji të grafme qi!» (E)

Grafëm-a = erë e keqe e gojës (E). Gojë e keqe, qi bërtet e shan: «ku i qëndrohet grafmës së filanit!» (E)

Grafsinë-a = v. *gogës-i.*

Gramsinë-a = v. *gogës-i.*

Grell-i = tokë e vorfën, me pak tul dhe me gurishtë për fundi. Shumësi ban: *greje-t* (P)

Grasht-di = bar i thatë që mbetet nër toka të papunueme si ikën vera (livadhe, pyje) dhe qi e hanë gjaja vjeshtës e dimnit. «Pylli s' pat grasht sivjet» (P)

Gri-a guri katërqoshesh për të prefë (P, Sh)

Gruç-i = kallami i çkoçun i misrit, pa kokrra (S). Thohet edhe *kacarrum* (E), *rrum* (P), *macurr* (D).

Gruall-i = gurtelë me nji grep në majë, qi formon me të nji kand të ngushtë, për të mbajtë nji barrë dëllinje ose drize mi kurris (P).

Gropue (me) = me futë në gropët, me vorrosë nji njeri (P).

GJ

Gjakbamë-i = vrasës, gjakatar. «Ishte gjakbamë Shefqet beu; popo ç'ishte ai!» (E).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

Gjamë-a = gjëmimi (P). Thohet edhe me tjetër kuptim : «ajo gjamë fushe» gjithë ajo fushë, ajo alamet fushe, «ajo gjamë ushtrie», ajo ushtri aqë e madhe (Sh).

Gjedhje-a = model «Më ban ti mue gjedhjen dhe unë kam borxhë të ta baj dollapin si ta duesh» (Sh). Thohet edhe *zgjedhje* (Sh)

Gjep-i = v. *cifu-ni* (E).

Gjethanik-u = laknuer me gjethe prasi ose të ndonji tjetër bime (E).

Gjindshëm (i, e) = njeri që u gjindet fort të tjerëve, u vjen ndihmë në të keq (E).

Gjinish-i = kur shtihen dy buza dërrasash njana te tjetra, thohet se bajnë gjinish (fr : *enclave*) «Dyshemeja bahet nën gjinish, nën *vezhë* e me *të pjek*». Bahet nën vezhë, kur njana dërrasë hahet nga njana anë dhe tjetra nga ana e kundërt dhe superpozohen në vendin ku janë ngranë ; bahet me të pjek, tue i ngjitë të dyja dërrasat për anësh, pa i ngranë fare (P)

Gjurmashka-t = përdoret vetëm shumës. Çorapë të shkrutëna ose le pitka çorapi ose stofi me të cilat ecet nëpër shtëpi (E).

Gjylmitër-i = lidhse e opingës (B).

Gjymës pendje = v. *hasër-a* (E).

H

Hajeuk-u = njeri i prapë, i keq — thohet sidomos për fëmijt (E)

Hajdehujdi = andej — këndej — me kuptim përçmues. «Mos i bjer hajdehujdi pazarit, po ktheu shpejt mos u sill kotekot (E).

Harrok-u = cap i pa tredhun, qi përdoret për të *marrë* dhitë (P). Thohet edhe *butuk* (P).

Hasër-a = rrogoz. Ka disa lloj hasrash të dorës së parë, qi quhen *pendje* dhe të dobëta qi quhen *fytje*. Të parat i bën Myzeqeja, me zhugë të mirë dhe të dytat jevgjit e vëudit, me zhugë të dobët. Këto quhen edhe *hasra jevgjish*. Hasrat pendje janë dy lloj : *pendje të mira* dhe *gjymës pendje*, simbas të thurunit të shpeshë ose të rallë të tyne. Hasrat e jevgjëve janë thurë me kashtë të trashë dhe rallë (E).

Hekës-za = vijat qi u shkruhen çorapeve horizontalisht. Në mes të hekëzave shkruhen ose qëndisen lulet e çorapeve; kur janë «çorape me lule» (P). Thohet edhe hjekëza (P).

Hirrzë-a = sëmundje qi u bie sidomos dhive dhe ua ban qumështin të hollë si uj, si hirrë (P).

Hjekës-za = v. *hekës-za* (P).

Hoft-i = nji copë herë, nji çast. «Prit nji hoft, se erdha» : prit pak se ia mrrina (E).

Hosi-a = era e mirë, parfumi, shija, lezeti. Thohet : «hosia e djathit»t «hosia e duhanit» etj. «Duhani i, fushës e ka hosinë ma të mirë se duhani i malit» (P).

Hundaç-i = njeri të cilit ia ka ngrënë hundën franjuza (E).

Hundue (me) = *me butue, me tonitë* (P).

Hudhërue (me u) = me u rëmbye në punë, në jetë etj (E).

Hudhëruem (të) ose *e hudhërueme*. Të nxituem, nxitim; «Puna me të hudhëruem s' bahet e mirë». «E hudhëruemja në punë nuk bën» (E).

Hudhërueshëm (i, e) = njeri qi nxitotohet, qi rëmbehet (E).

Hundon shif *butuk*.

Hutë-a = dele ose dash pa veshë fare (P, Sh).

Hudhërim-i = të hudhëruemit, nxitimi, të rëmbyemit në punë (E).

I

Idërshuh-u = nji lule, së cilës gjethja i mban erë fort të mirë dhe që mbahet në saksi. Lulen e ban të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

kuqe, gjethen e ka të gjanë dhe me push (E). Idërshahu ose diçka si ai, gjindet edhe i egër në Mal të Shpatit dhe quhet *maravë* (Sh).

Ikë-a = vdekja. «Ç' pat ai qengj qi ngordhi? Ai ishte pikë. — Pikë, po ishte ba për ikë.» (P).

Ilk-u = Dru e rallë fort në Mal të Shpatit. I përngjet pak druve si dëllinja, pisha etj (P. Sh.) Thohet edhe: *larë-a* (P. Sh).

Imshtë-a = pyll me aha të vegjël (P Sh.) Në nji kuptim ma të gjanë: pyll me druj të vegjël (fr: *maquis*).

K

Kacarrum-i = v. *gruç-i* (E).

Kaçe-ja = lulja e parë qi mbin malit me t'ikun bora. E ka rrajën në formë bulbi, t'ambël dhe i hahet (P, Sh).

Kaçiar-i = lulja e lajthisë dhe çdo lule tjetër e asaj forme (P). Thohet edhe *lëvarë* (Sh).

Kadishtë-a = kade e vogël (P).

Kajë-a = toka që nuk ze plugu kur punohet ara, tokë e patundun (P).

Kaj-i = zok mishngranës, ma i madh se sqifteri, qi, kur ban lamë në qiell, lëshon një britëm si të qame: kaj kaj (Sh).

Kalash-i — mamëliga ose mëmëliga (E)

Kalidha-ni = kashta e misrit qi mbetet n'arë si të jetë pre misri. Shumës: kalidhej-t (P) Thohet edhe: *kashtronjë* (Sh).

Kalistri-a = nji si sqepar për të punue baçet. E ka njanën anë të çame dyshë dhe anën tjetër si shata (P).

Kandi-a = mbushamendje, besim; kandisje. «S'kam kandi te filani për këtë punë»: nuk ma mbush mendjen, nuk më kandis, nuk më besohet, (P).

Kanik-u = kasolle e vogël arash, për të rujtë misrin etj (V).

Kapikorr = dëgjue vetëm në shprehjen: «m'u ba kapikorr»: më mbeti pas, më ngjiti, nuk më ndahet, m'u ba *bigorr* (B).

Kapinos = dëgjue vetëm në shprehjen «u ba kapinos». Thohet për dhitë kur plaken për së tepërmi (P. Sh).

Kashtronjë-a = v. *kalidha-ni* (Sh).

Kauk-u = skufa e gunës, gaxhupi (P)

Kep-i = barrë e randë, prej 7-8 kilesh për të thye gurët ma të mëdhej (P)

Keqmeni-a = të keq, hall, kasavet «Më len n'atë keqmeninë teme»: më len në të keqin tem, në hallin tem (S G).

Këllye (me u) = v *marrë* (P).

Kërçop-i = kërcuni i një druje qi, edhe mbasi pritet kjo, mbetet në tokë (P).

Kërr-i = kalë i bardhë me pika të zeza ose të murrme (P).

Kërrute-ja = dhi me brij të vegjël (Sh).

Kërrile-ja = plakë fort e rrëgjueme — tallse (P).

Kizë-a — vegël e prefët, në formë luge, për me gërrye përmbrenda nji enë druni, degët (copat) e ndryshme qi e formojnë atë enë, sidomos vendin ku puthiten degët. Bishtin e ka të gjatë (Sh). Thohet edhe *gërresë* (E).

Klilashë-a = gunë e baiue prej leshi dhie të përziem me lesh të gjatë dhensh, e thjeshtë, me pak *spiç* të zi përreth. Asht guna e vorfënisë (P).

Kobeshë-a = dhi me brij të gjatë, të kthyem shum pas, e zezë fare (P).

Koçe-ja = dele e bardhë me sy të kuq (P).

Koçale-je = Kotsha, koftari i mishit — mish berri pa pule. Përdoret edhe për kofshët e njeriut, më të tallun, kur janë të holla, ose për ato të fëmijve — përkëdhelëse (P).

Koi = verbi duhet të ketë qenë me *kue* ose *kojtë*. Sot dëgjohet vetëm si impersonale, me këte kuptim: qëlloi rastisi. «Koi e e tha»: qëlloi e e tha; «koi e erth»: qëlloi e erth (E.P.SH). Fjalë qi po zhduket.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kokësit = dëgjue vetëm shumës. Krenët, parja e vendit. «Kokësit na i kanë të gjitha fajet ne këtu në Sulovë, ata na e suall Abazin e Ballin» (S)

Kopaçitë (më) = me punue nji vend mirë e mirë (sidomos nji kopësht), me i qërue rrajët e gurët, pastaj me çelë në te braza ose *evlekë* — me i ba të tria këto operacione (P)

Koprra-ni = lopata ose lapa e bishtit, të hostenit për të gërrye baltën e parmendës (P).

Korbull-i = kade (Sh).

Kostrevë-a = bar i naltë qi mbin nër arat e njomuna, me kërcyell të trashë dhe të fortë E hanë gjaja (P).

Kotorr-i = i vogli i bullicës (E).

Kozmanaqe-ja = manushaqeja (Sh).

Kran-i = *humat*, sythët e drujve qi fillojnë të çelin gjethin; sythët e njomë të drujve në dimën (P).

Krathë-i = lulja e ullinit (E).

Kreko = i veshun mirë, «luks», «ishte veshë kreko, me nji palë rrobe cekë» : ishte veshë «luks», me nji palë rrobe filli të reja. «Filanin po cekë e po kreko e shef» (E)

Krekosë (me u) = me u krenua, me u mbajtë me të math (E)

Krenajë-a = maja e nji bregu, e nji mali, e nji druje — majë e naltë (Z).

Krisë-a = bar rrëshqanës, grami (P).

Kristë-a = shkop hekuri, me majën si grep dhe petullicë, apo si nji lugë trikandëshe, për të gërrye magjen (P). Thohet edhe *ksistër* (Sh)

Kromë-a = sëmundje lëkure, qi u bi gjave, sidomos dhive. Lëkura mbushet me *fufëla* ose puçërra dhe ha shum (P). Mallkim grash : «të dhashtë Krishti kromën!» (E)

Kryezezë-a = dele fjesht e bardhë e me kryet fjesht të zi (P).

Krypanec-i = laknuer me hisila (E)

Kukatë-a = lëkura e vgjenit. E grime mirë dhe e bame si pluhën, përdoret për të zanë anët dhe fundet e enëve prej druni qi përdoren për langjëna — djathë, gjizë, shalcë, turshi etj (P.Sh). Thohet, për të dy kuptimet, edhe : *pakselë* (P.Sh).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Vrejtje mbi fjalët e pambledhura

A. XHUVANI

Gerbuc, thuhet edhe gërmuc, gërmuq, i gerbutë
Gorgë, shif gorrlë-a Gaz. f. 153
Grell-i, shif gërlë-a Gaz. f. 147
Gri-a, shif grihë-a e grihënë-a Krist. f. 72
Gjamë-a, thuhet edhe gjamni-a: nji gjamni rrobesh, enësh etj.
(1) gjindshëm, thuhet edhe i përgjindshëm për fr. *serviable*
Gjylmitër-i, duket nji plural i singularizuem nga gjalm-i sh. gjëlmitër-it dhe gjalma-t
Hajdehujdi, pjesa e dytë âsht nji shndërrim trajte i pjesës së parë hajde, që asht turqisht
Harrok-u, asht edhe fjala *harrç-i* që lidhet me këtë.
Hoft-i, thuhet edhe *hop-i*
Hundac-i shif Fjal. e Kordinjanos f. 293 dhe Gazullit f. 178
Idërshah asht turqisht
Imshtë-a, shif "Bashkimin" f. 170
Kalidhâ-ni, krhs. *gëdhan-i* te Gaz. f. 145
Kërcop-i, krhs. *kërçep* te Gaz. f. 200
Kokësit, krhs. *krenësit* te Gaz. f. 217
Kristë-a, thuhet edhe *kristër-a* nga greq. *ksyo* q'u kruej
Kukatë-a, thuhet edhe *kukoj*, Krist. f. 167.

RÉSUMÉ :

Dans ces pages sont publiés les mots rares de la règion d'Elbasan, recueillis, par Dhimitri Shuteriqi et commentés par A. Xhuvani.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

NGA JETA E INSTITUTIT

Letër pershendetje Komitetit Qendror te P. P. SH.

Me datë 20 Prill 1949, në Institutin e Shkencavet, në një mbledhje të posaçme, me rasttn e vendimit të Komitetit Qendror të P.P.SH. në lidhje me trajtimin e njerëzve të Kulturës, të Arteve, të Shkencave dhe Sgorteve, anëtarët dhe bashkëpuntorët e Institutit i drejtuan Komitetit Qëndror një leter përshëndetje, duke shprehur enthusiazmin e tyre për vendimin e marrë.

Lidhje me botën e jashtëme.

Qysh prej fillimit të këtij viti Instituti i Shkencavet ka krijuar lidhje të rregullta me botën e jashtëme, për shkëmbim botimesh dhe eksperience dhe për kontakte me njerës të shkencës. Në lidhje me këtë u janë dërguar botime, të dala në vendin tonë para dhe pas çlirimit, Bibliotekës «Lenin» në Moskë dhe bibliotekës Fondamentale të Shkencave Sociale pranë Akademisë së Shkencave në Moskë. Akademive të Shkencave në Sofje, në Bukuresht dhe në Krakovi. Janë bërë çkëmbime reciproke me Institutin Rumun të kulturës Universale, me Institutin Polonez për çështje Internacjonale. I janë drejtuar Instttutit, për të krijuar lidhje, Instituti Shkencor i Librave, qendër nacjonale dokumentacioni dhe informatash bibliografike ne Lotz (Poloni). Instituti i Marinës dhe i medicinës tropikale në Gdansk (Poloni). I janë bërë ftesa për të marrë pjesë në mbledhje shkencore. Janë bërë shkëmbime urimesh me Akademi shkencash, etj.

K o n f e r e n c a

— Me 17 Janar të kitij viti me rastin e aniversarit të 481 të vdekjes së Skanderbeut, në sallen e Theatrit Populllor u mbajt një konferencë prej Prof. Aleks Budës, anëtar' i këtij Instituti, me themë "Figura e Gjergj Kastriotit në historinë e popullit shqiptar".

— Me 14 Mars të këtij viti me rastin e 66 vjetorit të vdekjes

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"NAIM BARLETI"
S H K O D E R

së Karl Marksit, Instituti i Shkencave organizoi një konferencë akademike në sallën e Lidhjes Kulturale në mes të Shqipërisë dhe B. Sovjetik. Konferenca me themë: "Mbi jetën dhe veprën e Karl Marksit" u mbajt prej Z. Bilbil Klosi, bashkëpuntor të Institutit të Shkencave.

— Mbi propozimin e anëtarëve të Institutit të Shkencave ZZ. Aleksandër Xhuvani, Kostaq Çipo, Shefqet Musaraj, Andrea Nathanaili dhe Dhimitër Shuteriqi me dt. 19 mars të k.v. në sallën e Bibliotekës Kombëtare u mblodhën anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Institutit të Shkencave për të shqyrtuar thirrjen e "Komitetit Internacjonal të Ndërlidhjes së Intelektualëve" dhe "Federatës Ndërkombëtare të Grave Demokratike" për konvokimin e një Kongresi Ndërkombëtar të Paqës.

Pas diskutimesh u adoptua një rezolutë, ku midis të tjerave thuhet: "Jemi thellësisht solidarë me gjithë punëtorët progresistë të shkencës në botë, në krye të të cilëve qëndrojnë shkencëtarët sovjetikë dhe protestojmë me tërë forcat tona kundër nxitësve të një lufte të re, kundër urrejtjes së njeriut dhe do të vëmë tërë forcat tona gjer në funt për një paqë të qëndrueshme dhe demokratike.

B o t i m e

Gjatë tremujorit janar-mars 1949 u dhanë për botim nga ana e Institutit të Shkencave këto vepra: «Për Historinë e Lidhjes së Komunistëve», «Iperializmi faza m'e lartë e Kapitalizmit», «Shteti dhe Revolucjoni», «Origjina e Familjes e pronës private dhe e Shtetit».

Krijimi i Drejtorisë së Shërbimit Hidrometeorologjik

Në bazë të urdhëresës së Kryeministrisë Nr. 5 datë 24-II-49 u krijua Drejtorija e Shërbimit Hidrometeorologjik pranë Institutit të Shkencave. Drejtorija në fjalë do të organizojë rrjetin e stacioneve meteorologjike dhe hidrometrike në të gjithë teritotorin e Republikës Popullore të Shqipërisë; do të mbledhë të gjithë vërejtjet, që do të kryhen nga këto stacione dhe ato që që janë kryer gjer më sot nga stacionet që ekzistojnë; do të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

mbledhë të gjitha vëreitjet hidrometeorologjike, të kryera në të kaluarën në vëndin tonë dhe që gjenden në zyrat meteorologjike të shteteve të tjerë; do të përpunojë gjithë elementët hidrometeorologjike që ka mbledhur dhe do t'i publikojë në buletin të posaçëm; do të kujdeset për pregatitjen e kuadrove të nevojëshme për këtë shërbim, me anën e kurseve të posaçëm dhe duke dërguar elementa të nevojëshëm për studim jashtë Shtetit.

Gjer më sot Shqipëria ka qenë i vetëmi vend në Europë pa një shërbim meteorologjik dhe hidrometrik, të organizuar si duhet. Në të kaluarën as e kanë ndjerë, as e kanë kupëtuar rëndësinë që kanë për ekonominë e vendit dhe shëndetin e popullit varjacionet klimatike dhe konsekuencat e tyre. Me ngritjen e Shërbimit Hidrometeorologjik do të plotësohet një nevojë e madhe e ekonomisë sonë të planifikuar. Një pjesë e madhe e sektorëve të Shtetit do të përfitojë nga aktiviteti i këtij Sherbimi: bujqësia, shëndetësia, punët botore, lundrimi dhe peshkimi në radhë të parë.

Biblioteka Kombëtare :

Në Bibliotekën Kombëtare gjatë tremujorit të parë është punuar vazhdimisht për realizimin e planit në punën e brëndëshme të atij Institucioni dhe sistemimin më të mirë atje.

Gjatë tremujorit të parë kanë qenë si lexonjës 8652 vetë, kanë marrë libra 2296 veta, kanë studjuar me libra të tyre 3107 veta.

Gjith'ashtu, gjat atij tremujorit kanë hyrë në bibliotekë 1591 libra dhe 538 gazeta e revista dhe u pregatit një listë për 1462 vepra, që do të porositen në Bashkimin Sovjetik.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R